Ilir VELO    Anila QEHAJA

# HISTORIA 7

## Udhëzues për mësuesin

**Miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit**

Botues: IRISOFT EDUCATION
Esmeralda TASHO

Konsulent shkencor: Prof. As. Eva HYSKAJ

Redaktore letrare: Ortensa MARINI

Arti grafik: Enea XHENGO

© IRISOFT EDUCATION

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Riprodhimi i librit, qoftë edhe në formë të pjesëshme është i ndaluar.

Shtypur në shtypshkronjën: CLASSICPRINT

Viti i botimit 2016

ISBN: 978-9928-4362-3-8

---

Shtëpia botuese: IRISOFT EDUCATION

Adresa: Rruga "Him Kolli; V. 23/1

Tel: 00355 2242 107;
Mob: 069 40 970 40
e-mail: info@irisoft.al
www.irisoft.edu.al

# PËRMBAJTJA

1. HYRJE ........ 5
2. KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT ........ 6
2. 1 Qëllimet e programit të historisë ........ 8
2. 2 Lidhja e kompetencave kyç me kompetencat e lëndës ........ 9
2. 3 Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyç që realizohen nëpërmjet lëndës së historisë ........ 10
2. 4 Lidhja e lëndës së historisë me temat ndërkurikulare ........ 12
2. 5 Lidhja e historisë me fushat/lëndët e tjera kurikulare ........ 13
3. Rezultatet e të nxënit për konceptet dhe kompetencat historike ........ 15
4. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN ........ 17
5. MATERIALET DHE BURIMET MËSIMORE ........ 21
6. Rekomandime për hartimin e një plani mësimor ditor ........ 22
7. PROGRAMI ANALITIK ........ 23
8. OBJEKTIVAT MËSIMORE SIPAS TAKSONOMISË SË BLUMIT ........ 24
9. PLANIFIKIMI I KURIKULËS ........ 25
9. 1 PLANI MËSIMOR VJETOR, KLASA VII ........ 25
9. 2 PLANIFIKIMI 3 – MUJOR ........ 38
10. ORË MËSIMI MODEL ........ 56

4

## 1. HYRJE

Historia, si një shkencë humane, është thelbësore në zhvillimin e qytetarëve, të cilët i kuptojnë çështjet aktuale me zgjuarsi, nëpërmjet kuptimit, analizës dhe përfundimeve të nxjerra nga përvojat e së shkuarës.
Studimi i lëndës së historisë i ndihmon nxënësit: të zhvillojnë një ndjenjë humanizmi të gjerë, të kuptojnë zhvillimin e personalitetit të tyre, mënyrën si ata ngjasojnë dhe diferencohen nga të tjerët në raport me kohën dhe me hapësirën, të dallojnë diferencën midis supozimit dhe faktit, të kuptojnë kompleksitetin e çështjes historike, të mos besojnë në përgjigjen e paargumentuar dhe të respektojnë vërtetësinë e burimeve historike, duke dalluar analogjinë false, të njohin abuzimet nga "mësimet" historike, të peshojnë pasojat që vijnë prej tyre, si dhe të marrin parasysh se padija për të shkuarën na bën "të burgosurit" e saj.
Ndryshimi është aspekti thelbësor i historisë dhe, për këtë arsye, është një ndër konceptet bazë të studimit në programin e historisë. Ndërsa lëndë të tjera studiojnë aspekte të ndryshme të jetës së njerëzimit, si: institucionet, traditat kulturore, ekonominë, ligjet etj., lënda e historisë, kryesisht, synon të merret me shpjegimin e mënyrës se si janë zhvilluartë gjitha këto aspekte dhe si kanë ndryshuar gjatë historisë së tyre. Në këtë mënyrë, nxënësit do të mësojnë rëndësinë që ka ndryshimi për të gjitha përvojat njerëzore, për kompleksitetin dhe mënyrat e ndryshme në të cilat bashkëveprojnë të gjitha këto përvoja.
Detyra e programit të historisë është të drejtojë nxënësit për t'u bërë pjesëtarë të përgjegjshëm të shoqërisë, të cilët dinë se si të trajtojnë në mënyrë kritike një fenomen të epokës së tyre dhe të së shkuarës. Nëpërmjet programit të historisë, nxënësit kuptojnë se kultura e tyre dhe kulturat e tjera përbëjnë rezultatin e një procesi historik.
Programi i historisë në arsimin bazë, shkalla e dytë, e tretë dhe e katërt e kurikulës, ka në fokusin e tij të studimit:historinë personale dhe familjare, historinë lokale, historinë e vendit, historinë e shqiptarëve, parahistorinë, historinë antike, moderne dhe bashkëkohore të qytetërimeve botërore.
Programi trajton ngjarjet historike në një kornizë kronologjike e tematike. Vazhdimësia kronologjike mundëson lidhjen e brendshme e të jashtme midis ngjarjeve, periudhave dhe shoqërive të ndryshme, si dhe lidhjet e qytetërimit të popullit shqiptar me qytetërimetbotërore. Programi synon që të krijojë te nxënësit bindjen se qytetërimet e sotme janë një vazhdimësi progresive e qytetërimeve të hershme, pra e sotmja e ka burimin te e kaluara dhe është e lidhur me të. Ky këndvështrim i ndihmon nxënësit të ndërtojnë perspektivat e një ngjarjeje apo procesi historik, ose të parashikojnë trendin e përgjithshëm të këtyre proceseve.
Ruajtja e kronologjisë zbaton kriterin shkencor të zhvillimit të ngjarjeve mbi lidhjen shkakT pasojë dhe vazhdimësinë progresive të rrjedhës historike. Trajtesa tematike shpreh natyrën përzgjedhëse të programit, i cili nuk ka si qëllim të mbulojë të gjitha ngjarjet e historisë, gjë që do të sillte një ngarkesë të panevojshme për nxënësit, por të trajtojë problemet thelbësore, modelet historike që përbëjnë rrënjët e qytetërimeve të sotme. Trajtesa tematike ka pasur parasysh edhe vendosjen e një baraspeshe historike mes kontributeve të krijuara në periudha të ndryshme në lindjen dhe zhvillimin e qytetërimeve pasardhëse, duke shprehur vlerat e tyre në një këndvështrim të barabartë.

Programi i historisë i ndihmon nxënësit që të bëhen të ditur, të logjikshëm, kureshtarë, të balancuar, të ndjeshëm dhe individë të aftë për të dhënë argumente dhe vendime të arsyetuara mirë.
Këto cilësi mbështesin nxënësit në zhvillimin e qëllimeve, kompetencave kyç dhe rezultateve të dëshiruara të arsimit parauniversitar, në mënyrë që ata të jenë individë të mirëpërgatitur, të aftë për të kontribuuar ndaj kombit dhe të aftë për t'iu përgjigjur zhvillimeve globale.

## 2. KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT

Hartimi i programit lëndor rrjedh nga korniza kurikulare e arsimit parauniversitar, kurikulat bërthamë, plani mësimor i arsimit bazë dhe rekomandimet e Komitetit të Ministrave të shteteve anëtare lidhur me mësimin e historisë në Europë në shekullin XXI.

*Si i tillë, ky dokument i shërben:*

- **Nxënësit** për zhvillimin e kompetencave kyç të të nxënit gjatë gjithë jetës dhe të kompetencave të lëndës së historisë, në mënyrë që ai të përballojë sfidat e jetës dhe të integrohet në shoqëri.
- **Mësuesit** për planifikimin, realizimin, vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe arritjet e nxënësit në klasë dhe jashtë saj.
- **Prindit** për njohjen e rezultateve të pritshme të fëmijëve dhe kriteret e vlerësimit në periudha të caktuara.
- **Hartuesit** të teksteve mësimore dhe të materialeve ndihmëse për mësuesit dhe nxënësit, të cilët, përmes përmbushjes së qëllimeve të programit në tekstet e tyre, bëhen një faktor i rëndësishëm progresi në mësimdhënien e lëndës së historisë dhe në ndërtimin e kompetencave të lëndës dhe kompetencave kyç të të nxënit gjatë gjithë jetës.

Programi i historisë në qendër të tij vendos krijimin e kushteve për ndërtimin e kompetencave të lëndës dhe të kompetencave kyç që lidhen me to, për të gjithë nxënësit e arsimit bazë.

Programi paraqet temat ndërkurikulare, ku realizimi i tyre nëpërmjet lëndës së historisë është një komponent i rëndësishëm i programit për kontributin e historisë në shoqëri dhe në jetën e përditshme. Programi përshkruan lidhjen e historisë me fushat e tjera kurikulare, në mënyrë që kurikula e arsimit bazë të shihet si një e tërë për formimin e nxënësit, për realizimin e qëllimeve kryesore të shkollës dhe të shoqërisë në fushën e arsimit. Në program paraqitet edhe koha mësimore për secilën tematikë dhe klasë.

Programi i historisë tregon se si ndërtohen, zbatohen kompetencat e lëndës dhe kompetencat kyç nëpërmjet tematikave të përcaktuara, situatave, veprimtarive, detyrave, projekteve të sugjeruara, të paraqitura në këtë program. Tematikat e programit krijojnë mundësi që nxënësi të ndërtojë dhe të zbatojë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat në funksion të koncepteve, kompetencave të lëndës dhe kompetencave kyç. Situatat, veprimtaritë, detyrat, projektet e aftësojnë nxënësin në përvetësimin e dijeve,në demonstrimin e kompetencave të lëndës dhe kompetencave kyç për të nxënit gjatë gjithë jetës.

Situatat, veprimtaritë, detyrat, projektet e sugjeruara të dhëna në program zhvillojnë te nxënësi aftësinë e kërkimit, duke i zgjeruar dhe thelluar më tej dijet, konceptet historike të tij në situata të zbatueshme. Nëpërmjet kërkimit historik, nxënësi ndërton pyetje, mëson për të shkuarën, tregon lidhjet ndërmjet të shkuarës e të tashmes. Njëkohësisht, evidenton lidhjet ndërmjet historisë së shqiptarëve dhe historisë së qytetërimeve europiane dhe botërore.

Programi prezanton metodologjitë e mësimdhënies së historisë dhe vlerësimin e nxënësit në këtë lëndë. Përdorimi i metodologjive të larmishme dhe efikase në mësimdhënien e historisë është kusht parësor për zbatimin e programit, për arritjen e kompetencave nga ana e nxënësit, duke i dhënë secilit mundësi të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin që zotëron brenda vetes. Vlerësimi i nxënësit është komponent thelbësor për përmirësimin e arritjeve të tij dhe përmirësimin e procesit të të nxënit.



## QËLLIMET E PROGRAMIT TË HISTORISË

Arsimi parauniversitar krijon kushte dhe mundësi që nxënësit: të ndërtojnë dhe të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike; të zhvillohen në mënyrë të pavarur e të gjithanshme; të kontribuojnë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake e të shoqërisë shqiptare, të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.

*Në arsimin parauniversitar, nxënësit:*

x kultivojnë identitetin vetjak, kombëtar dhe përkatësinë kulturore;
x përvetësojnë vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare;
x zhvillohen në aspektet: intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike;
x zhvillojnë përgjegjësi: ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;
x aftësohen për jetë dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
x aftësohen për të nxënë gjatë gjithë jetës;
x zhvillojnë shpirtin e sipërmarrjes;
x përdorin teknologjitë e reja.

Programi i historisë në arsimin bazë ka për qëllim: të pajisë nxënësit me aftësi, cilësi intelektuale nëpërmjet zhvillimit, ndërtimit të një sërë konceptesh dhe kompetencash lëndore, të cilat u krijojnë atyre mundësi të analizojnë në mënyrë kritike informacionin, lidhjet shkakT pasojë; të interpretojnë burimet, të ndërtojnë shpjegime të arsyetuara dhe të argumentuara, si dhe të vlerësojnë interpretimet e ndryshme për të shkuarën.

Programi i historisë lidh vlerat e të mësuarit të historisë me qëllimet e arsimit parauniversitar, me kompetencat kyç për të nxënit gjatë gjithë jetës dhe rekomandimet e Komitetit të Ministrave të shteteve anëtare, për mësimdhënien e historisë në shekullin XXI, duke ndërtuar te nxënësi konceptet, kompetencat dhe cilësitë historike nëpërmjet:

- angazhimit në mënyrë aktive në kërkimin historik, me qëllim që të zhvillojë vetëbesimin, reflektimin dhe mendimin kritik;
- nxitjes së kureshtjes, zhvillimit të aftësive/shkathtësive për të bërë pyetje të rëndësishme në lidhje me të shkuarën, për të shqyrtuar në mënyrë kritike një sërë burimesh në kontekstin e tyre historik dhe për të dhënë përgjigje për të shkuarën, mbështetur në argumente;
- ndërtimit të aftësive për të kuptuar, organizuar dhe komunikuar dijet e tyre historike përmes mënyrave të ndryshme dhe përdorimit të mediave të ndryshme;
- zhvillimit të aftësive/shkathtësive të kërkimit historik, duke u bazuar në burime historike, për studimin e ngjarjeve të ndryshme të historisë;
- interpretimit të historisë së shoqërisë njerëzore në të kaluarën, në mënyrë që nxënësit të kuptojnë të sotmen dhe ndikimin e saj në zhvillimet historike të së ardhmes;
- interpretimit të efektit të kohës, të vazhdimësisë dhe të ndryshimit në marrëdhëniet historike, dhe rolin e tyre në perspektivat e së ardhmes;
- krijimit të mundësive për të ndërtuar dije, shkathtësi, qëndrime dhe vlera për historinë personale e familjare, historinë e shkollës, zonës, rajonit si dhe historinë e vendit të tyre;
- krijimit të mundësive për të ndërtuar dije, shkathtësi, qëndrime dhe vlera, për zhvillimin e

qytetërimeve antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore;

- kuptimit se si dhe pse ngjarje e çështje të veçanta historike janë interpretuar në mënyra të ndryshme;
- pajisjes me dijet dhe kompetencat e nevojshme historike për të kuptuar të tashmen, për të kontribuar në mënyrë aktive dhe me përgjegjësi si qytetarë lokalë dhe globalë në ndërtimin e perspektivës;
- mundësimit të ndërtimit të identitetit individual dhe kolektiv përmes njohjes e krahasimit të trashëgimisë së tyre historike të përbashkët;
- ndërveprimit me individë dhe grupe individësh të kulturave të ndryshme për të njohur të kaluarën dhe për të kuptuar ndërveprimin e saj me të sotmen, duke nxënë, analizuar dhe menduar në mënyrë kritike;
- zhvillimit të aftësive për të analizuar dhe për të interpretuar informacionin historik në mënyrë kritike e të përgjegjshme, nëpërmjet dialogut, kërkimit të së vërtetës, si dhe përmes debatit të hapur, sidomos për çështje të ndjeshme historike;
- vlerësimit të pozitës së qytetërimit shqiptar në raport me qytetërimet botërore;
- argumentimit të vlerave të trashëgimisë historike, duke e vlerësuar këtë trashëgimi si pjesë të përcaktimit të identitetit të një populli;
- forcimit të ndjenjës së identitetit kombëtar dhe të respektit për historinë kombëtare, me qëllim zgjerimin e përmasave europiane në studimin e historisë;
- zhvillimit të aftësive qytetare, të cilat kontribuojnë në rritjen e tyre personale si individë, në përgatitjen e tyre në jetë, në punë dhe shoqëri.

## LIDHJA E KOMPETENCAVE KYÇ ME KOMPETENCAT E LËNDËS

Ndërtimi dhe zbatimi i kompetencave kyç nga nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies kërkon që mësuesi të mbajë parasysh lidhjen e kompetencave kyç me kompetencat e lëndës për secilën shkallë të kurikulës. Për ta realizuar këtë lidhje në praktikë, mësuesi duhet të përzgjedhë situatat, veprimtaritë, metodat dhe mjetet e përshtatshme të procesit të të nxënit. Kompetenca përcaktohet si integrim i njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve që një nxënës duhet t'i fitojë gjatë procesit të nxënies.

Organizimi i mësimit të historisë,me bazë kompetencat, përqendrohet në atë që nxënësi duhet të dijë, të bëjë saktë dhe të shpjegojë pse e bën. Nëpërmjet studimit të historisë, nxënësit mësojnë se si të paraqesin një problem që ata e kanë realizuar nëpërmjet përvetësimit, ndërtimit të dijeve dhe kompetencave historike për një temë të caktuar.
Kur nxënësi zbaton kompetencat historike, ai njëkohësisht është duke zbatuar edhe kompetencat kyç. P.sh., kompetenca historike "**Kërkimi historik**" përfshin shumë nga strategjitë e zgjidhjes së situatave të ndryshme problemore në shoqëri dhe në jetën e përditshme. Për të zgjidhur problemin, ata duhet: të kërkojnë, të mbledhin, të gjejnë dhe të sintetizojnë informacione nga burimet primare, sekondare, si dhe informacionet me gojë, me shkrim e ato vizuale.
Ata duhet të dinë: ku të kërkojnë informacion, cilat informacione do t`i ndihmojnë ata për të ndërtuar një argument, si të interpretojnë informacionin e gjetur, si të strukturojnë marrëdhëniet komplekse shkakore, si të vlerësojnë saktësinë e burimit dhe si të krahasojnë

gjetjet e tyre me faktet historike. Ata mësojnë të komunikojnë gjetjet e tyre dhe i komunikojnë ato për audienca të ndryshme. Pra, gjatë zhvillimit të kompetencave historike, nxënësi zhvillon gjithashtu kompetencat kyç në lidhje me zgjidhjen e problemit, krijimtarinë, inovacionin, përpunimin e informacionit, prezantimin e detyrave, punën në grup, komunikimin efektiv etj.

*Për të realizuar lidhjen e kompetencave kyç me kompetencat e lëndës, mësuesi ndjek këta hapa:*

- përzgjedh përmbajtjen mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënit të kompetencave të historisë në një vit mësimor, si dhe rezultatet e të nxënit për kompetencat kyç në një vit mësimor;
- planifikon mësimdhënien, duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do të arrijë rezultatet e të nxënit, për kompetencat kyç brenda vitit shkollor;
- kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënit për vit mësimor dhe shkallë, për lëndën e historisë.

## REZULTATET KRYESORE TË TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE KYÇ QË REALIZOHEN NËPËRMJET LËNDËS SË HISTORISË

*1.* **Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit** (*Nxënësi komunikon në mënyrë efektive)*

- Shpreh mendimin e tij për një temë të caktuar, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit.
- Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime.
- Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të rinj, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.
- Veçon informacionin kryesor nga një libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi ose detyrë me shkrim.

***2.*** **Kompetenca e të menduarit** (*Nxënësi mendon në mënyrë krijuese)*

- Parashtron argumente pro ose kundër për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose publikimi në media.
- Zgjidh një problem dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.
- Përzgjedh dhe demonstron strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (shkencor, shoqëror) duke paraqitur rezultat të njëjtë.
- Interpreton mënyra të zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë.
- Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces, dukuri shoqërore, natyrore.
- Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy a më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore.

***3.*** **Kompetenca e të nxënit** *(Nxënësi mëson për të nxënë)*

- Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
- Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca shoqërore, duke i sqaruar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.
- Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, media) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
- Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjejelogjike.
- Parashtron pyetje ("Pse?", "Çfarë?", "Si?", "Kur?") dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën/problemin e dhënë, dhe vlerëson përparimin e vet deri në zgjidhjen e duhur.
- Menaxhonemocionet,ndjenjat,kohën, shfrytëzimin e materialeve dhe mjetevegjatëkryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo në terren).

**4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin** (*Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive)*

- Zhvillon një projekt individual ose në grup për kryerjen e një aktiviteti mjedisor, shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin.
- Diskuton në grup për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, pasojat që sjell dëmtimi i tij për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhen ndërmarrë për evitimin e tyre.
- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

***5.*** **Kompetenca personale** (*Nxënësi bën jetë të shëndetshme)*

- Vlerëson shkaqet e një situate të mundshme konflikti midis moshatarëve, anëtarëve të grupit dhe propozon alternativa për parandalimin dhe zgjidhjen, duke ndarë përvojat e mendimet në grup.

***6.*****Kompetenca qytetare***(Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)*

- Tregon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr pa dëmtuar interesat e të tjerëve, tëcilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/komunitetit.
- Merr pjesë në aktivitetet që promovojnë tolerancë dhe diversitet kulturor, etnik, fetar, gjinor etj., në shkollë apo në komunitet, ku përfshihen moshatarë të të gjitha përkatësive të përmendura, që jetojnë në bashkësinë e gjerë.

***7.*****Kompetenca digjitale** (*Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)*

- Përdor mediat digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive.
- Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (për shembull, hedhin disa informacione të marra nga interneti duke i përmbledhur në një tabelë ose grafik).

## LIDHJA E LËNDËS SË HISTORISË ME TEMAT NDËRKURIKULARE

Kurikulat bërthamë të arsimit bazë përcaktojnë një sërë temash ndërkurikulare, të cilat integrojnë fushat kurikulare të të nxënit. Ato janë tema madhore me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Zhvillimi i tyre ndihmon nxënësit të interpretojnë botën dhe të rrisin lidhjen e arsimit me jetën dhe me interesat e saj.
Trajtimi i këtyre temave në lëndën e historisë synon ndërtimin e disa njohurive specifike, zbatimin e disa aftësive, vlerave e qëndrimeve të caktuara te nxënësit për zhvillimin e tyre si qytetarë të së ardhmes, të cilët do të jenë të aftë për të bashkëvepruar në paqe me kultura të ndryshme, të aftë për të kontribuar në ndërtimin e një shoqërie demokratike dhe të aftë për të funksionuar në një botë të ndërvarur, duke nxitur zhvillimin e qëndrueshëm të saj.
Kurikula e historisë është projektuar për të plotësuar nevojat e nxënësve, duke paraqitur një program bashkëkohor. Temat ndërkurikulare: *Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave; Të drejtat e njeriut; Vendimmarrja morale; Zhvillimi i qëndrueshëm; Mjedisi; Ndërvarësia; Bashkëjetesa paqësore;* ofrojnë dimensione të cilat pasurojnë programin mësimor nëpërmjet zhvillimit të përmbajtjes së fokusuar që përshtatet natyrshëm brenda tematikave të historisë.

*Integrimi i këtyre temave gjatë zhvillimit të koncepteve dhe kompetencave historike aftëson nxënësit:*

- për t’u bërë qytetarë aktivë dhe të përgjegjshëm në dimensioned: lokale, kombëtare, rajonale, evropiane e globale, duke u mundësuar atyre të ndërtojnë identitetin individual dhe kolektiv përmes njohjes së trashëgimisë së tyre historike të përbashkët;
- për të ndërvepruar me individë dhe grupe individësh të kulturave të ndryshme, për të njohur të kaluarën dhe për të kuptuar ndërveprimin e saj me të sotmen, duke nxënë, analizuar dhe menduar në mënyrë kritike;
- për t`u edukuar me ndjenjën e mirëkuptimit dhe të besimit të ndërsjellë midis popujve, nëpërmjet studimit të kulturës, të shkëmbimeve të shumanshme dhe të trashëgimisë;
- për të ndihmuar në formimin e një të ardhmeje më të mirë përmes kuptimit të asaj se si e shkuara ka lidhje me të tashmen dhe për të marrë vendime për një zhvillim të qëndrueshëm të perspektivave historike;
- për të zhvilluar aftësitë qytetare, të cilat kontribuojnë në rritjen e tyre personale si individë në përgatitjen e tyre në jetë, në punë dhe në shoqëri.

Gjatë realizimit të temave ndërkurikulare, nxënësi duhet:të zgjidhë situata, të përdorë aftësitë e mendimit kritik, krijues, të përdorë kompetencat historike, si: kërkimin, përdorimin e burimeve, interpretimin dhe komunikimin për të shpjeguar, argumentuar dhe parashikuar perspektivat për çështje të ndryshme që lidhen me këto tema ndërkurikulare.

## Lidhja e historisë me fushat/lëndët e tjera kurikulare

Lënda e historisë është një nga lëndët kryesore të fushës "**Shoqëria dhe mjedisi**". Njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat në lëndët e fushës "**Shoqëria dhe mjedisi**" dhe në lëndët e tjera të fushave të të nxënit, si: të atyre të shkencave natyrore, arteve, gjuhës dhe komunikimit, matematikës, teknologjisë, TIKTut etj., integrohen mjaft mirë me ato të historisë. Integrimi i tyre mund të shikohet në nivelin e tematikave, të koncepteve dhe të kompetencave.

Lënda e historisë dhe lëndët e tjera duhet të integrohen në mënyrë të ndërsjellë me njëraT tjetrën. Vetëm në këtë mënyrë do të mundtë realizohen siç duhen kompetencat kyç të të nxënit, qëllimet e shkollës dhe të shoqërisë në fushën earsimit.

*Çfarë do të thotë kjo?*

- Së pari, historia mund të përdorë njohuritë, konceptet dhe aftësitë që trajtohen në lëndët e tjera për të ndërtuar, për të konkretizuar dhe për të argumentuar më mirë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat esaj.
- Së dyti, lëndët e tjera duhet të përdorin dijet dhe kompetencat historike për të aktualizuar dhe për të kuptuar më mirë çështjet e tyre në diskutim, si dhe për të nxitur përgjegjësinë, motivimin qytetar të nxënësve në shkollë dhe në bashkësinë ku jetojnë.

Programi nëpërmjet të gjitha tematikave të tij zhvillon dhe ndërton një numër kompetencash dhe konceptesh, të cilat mbështesin studimin e historisë. Kompetencat historike janë procese dhe aftësi thelbësore që përfshihen në të gjithë programin e historisë nëpërmjet tematikave dhe veprimtarive të sugjeruara. Nxënësit duhet të kuptojnë, të zhvillojnë, të ndërtojnë kompetencat, konceptet historike, si dhe të aftësohen për t`i përdorur ato në mënyrë që të thellojnë, të zgjerojnë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat e tyre në lëndën e historisë, duke arritur progres.

| **Kompetencathistorike janë:** | **Konceptet kyç historike janë:** |
|---|---|
| Kërkimi historik | Kuptimi kronologjik |
| Përdorimi i burimeve | Ndryshimi dhe vazhdimësia |
| Analiza shkakTpasojë | Shumëllojshmëria kulturore, etnike dhe fetare |
| Interpretimi historik | Rëndësia |
| Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën | |


Kompetenca personale
Kompetenca qytetare
Kompetenca e tënxënit
Kuptimi kronologjik
Kuptimi kronologjik
Kërkimi historik
Ndryshimi dhe vazhdimësia
Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën
HISTORI
Përdorimi i burimeve
Kompetenca digjitale
Shumëllojshmëria kulturore, etnike dhe fetare
Rëndësia
Interpretimi historik
Analiza shkak-pasojë
Kompetenca e të menduarit
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit
Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

## 3. REZULTATET E TË NXËNIT PËR KONCEPTET DHE KOMPETENCAT HISTORIKE

Përgjatë gjithë programit të historisë zhvillohen njohuritë, aftësitë/shkathtësitë, qëndrimet e vlerat që duhet të zotërojë nxënësi për ndërtimin e koncepteve historike*: Kuptimi kronologjik; Ndryshimi dhe vazhdimësia; Shumëllojshmëria kulturore, etnike dhe fetare;*realizimin e kompetencave historike: *Kërkimi historik; Përdorimi i burimeve; Analiza shkakΤpasojë; Interpretimi; Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën.*

| SHKALLA E TRETË | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **REZULTATET E TË NXËNIT PËR KOMPETENCAT HISTORIKE** | | | | |
| **Kërkimi historik** | **Përdorimi i burimeve** | **Interpretimi historik** | **Shkaku dhe pasoja** | **Shpjegimi dhe komunikimi** |
| • Identifikon dhe shqyrton, individualisht dhe si pjesë e një grupi pyetje specifike historike ose çështje, duke bërë testimin e hipotezave;<br>• reflekton në mënyrë kritike për pyetje ose çështje historike. | x Shpjegon tipat e burimeve historike, si një domosdoshmëri në punën e historianit;<br>x kërkon, duke vlerësuar burimet alternative, për ndërtimin e ngjarjes historike;<br>x identifikon, zgjedh dhe përdor një sërë burimesh historike, duke përfshirë: burimet tekstuale, vizuale, objektet dhe mjedisin historik;<br>x vlerëson burimet e përdorura për të arritur përfundime të arsyetuara dhe logjike;<br>x vlerëson historinë gojore, me anë të së cilës dëshmitë gojore për ngjarjet e fundit historike mund ta bëjnë historinë më të gjallë në sytë e nxënësve, si dhe mund t'u lënë vend pikëpamjeve e | x Kupton pse historianët dhe të tjerët i kanë interpretuar ngjarjet, njerëzit dhe situatat në mënyra të ndryshme nëpërmjet një sërë mediash;<br>x shpjegon se si dhe pse ngjarjet historike janë interpretuar në mënyra të ndryshme;<br>x shqyrton një sërë interpretimesh të së kaluarës për të vlerësuar vlefshmërinë e tyre. | x Analizon ngjarjet historike në lidhjet e tyre shkak pasojë;<br>x shpjegon pasojat në përfundimin e ngjarjeve, të situatave dhe të ndryshimeve historike. | x Paraqetshpjegime rreth së kaluarës që janë koherente, të strukturuara dhe të arsyetuara,<br>x komunikon njohuritë historike në mënyra të ndryshme, duke përdorur kronologjinë dhe fjalorin e duhur historik. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | perspektivave të atyre që nuk kanë marrë pjesë në “historinë e shkruar”. | | | |

| **REZULTATET E TË NXËNIT PËR KONCEPTET HISTORIKE** | | | |
|---|---|---|---|
| **Kuptimi kronologjik** | **Ndryshimi dhe vazhdimësia** | **Shumëllojshmëria kulturore, etnike dhe fetare** | **Rëndësia** |
| x Përdor saktë datat dhe fjalorin për periudha të ndryshme historike, duke përfshirë periudhën parahistorike, antike, mesjetare, moderne;<br>x kupton organizimin kronologjik të historisë dhe të vendosë njerëzit dhe ngjarjet në periudhën e saktë historike, duke kuptuar dhe duke shpjeguar marrëdhëniet historike;<br>x ndërton linjën e kohës, duke vendosur në të periudhat historike dhe ngjarjet e rëndësishme historike;<br>x kryen veprime për llogaritjen e kohës;<br>x krijon një tabelë kronologjike të periudhave historike, duke e pasuruar atë në vazhdimësi me informacionin e ri. | x Shpjegon ndryshimin dhe vazhdimësinë e ngjarjeve historike brenda dhe përtej periudhave historike;<br>x analizon shkallën dhe ritmin e ndryshimit, nëse ndryshimi arriti në progres dhe, nëse po, për kë; analizon arsyet dhe rezultatet e ngjarjeve, të situatave dhe të ndryshimeve historike;<br>x kupton dhe ndërgjegjësohet për veçoritë e prirjeve historike sipas periudhave, të cilat sollën progresin e shoqërisë në shkallë kombëtare, europiane dhe botërore. | x Kupton se njerëzit dhe shoqëritë e përfshira në të njëjtën ngjarje historike mund të kenë përvoja dhe pikëpamje të ndryshme për të njëjtën ngjarje historike. | x Vlerëson rëndësinë e ngjarjeve, të njerëzve dhe të zhvillimeve në kontekstin e tyre historik dhe në ditët e sotme. |

## 4. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

Vlerësimi është një aspekt i rëndësishëm i lëndës së historisë. Në përputhje me parimet e qasjes së të nxënit bazuar në kompetenca, vlerësimi konsiderohet si element i mësimdhënies, i cili përqendrohet: në nivelin e arritjes së kompetencave, në matjen e njohurive dhe të aftësive, në arritjen e rezultateve të të nxënit dhe në nivelin e përmbushjes së kompetencave. Informacioni i siguruar nga vlerësimi e ndihmon mësuesin: të evidentojë përparimin e nxënësve, të vlerësojë se sa të përshtatshme e të dobishme janë metodat e mësimdhënies që ai përdor, të përmirësojë mësimdhënien dhe të pajisë nxënësit me informacionin përkatës për progresin e tyre. Vlerësimi është një informacion i rëndësishëm që u shërben nxënësve për të ndjekur vetë ecurinë e tyre në këtë lëndë, për të njohur anët e tyre të forta dhe vështirësitë që hasin në zotërimin e njohurive dhe kompetencave, në mënyrë që të punojnë përkatësisht për përforcimin dhe kapërcimin e tyre. Vlerësimi është një informacion i rëndësishëm edhe për prindërit, të cilët përmes tij mund të ndihmojnë më mirë në edukimin e fëmijëve të tyre.
I domosdoshëm është vlerësimi i përmbajtjes së lëndës lidhur me zotërimin e njohurive dhe demonstrimin e aftësive historike nëpërmjet treguesve të besueshëm për progresin e tyre (*p.sh.: vetëvlerësimi, intervistë me një listë treguesish, testi objektiv, vëzhgimi i kërkimit historik me një listë të saktë treguesish, portofoli, prezantimi me gojë ose me shkrim, projekti kurikular etj.).*

Në përzgjedhjen e praktikave të vlerësimit, në përcaktimin e kohës së përshtatshme, në përzgjedhjen e materialeve për vlerësim, mësuesi duhet të ketë parasysh:

- përcaktimin e qëllimit dhe strategjisë së vlerësimit;
- përzgjedhjen e veprimtarive që mundësojnë demonstrimin e arritjes së kompetencave;
- përdorimin e vlerësimit për të verifikuar çfarë dinë aktualisht nxënësit;
- dallimin qartë të qëllimit të detyrës së zgjedhur për vlerësim.

Vlerësimi i nxënësve duhet të nxjerrë në pah arritjet e tyre, në mënyrë që ata të inkurajohen të mësojnë me më shumë dëshirë. Ai duhet të konsiderohet si një mjet në ndihmë të nxënësve, i cili i ndihmon ata të njohin më mirë aftësitë e tyre në të nxënë, të zhvillojnë e të përdorin talentet dhe aftësitë në mënyra sa më të dobishme. Nxënësit duhet të jenë vetë pjesë e procesit të vlerësimit të arritjeve të tyre.

Me anë të vlerësimit, mësuesi informohet rreth çfarë dhe si po mësojnë nxënësit, çka e ndihmon atë të planifikojë mësimdhënien në vijim dhe të përgatisë materiale, të rishikojë metodologjinë e mësimdhënies për t'iu përshtatur nevojave të nxënësve. Vlerësimi nga ana e mësuesit duhet të marrë në konsideratë edhe aftësinë e nxënësve për të përcaktuar dhe arritur objektiva për veten.

*Vlerësimi zhvillohet në nivele të ndryshme dhe për qëllime të ndryshme, duke përfshirë:*

- vlerësimin formativ brenda klase për qëllime të monitorimit të të mësuarit dhe dhënien e mendimit, të mësuesve për të informuar mësimdhënien e tyre dhe për nxënësit për të informuar të mësuarit e tyre;

- vlerësimin shumativ (përmbledhës) për qëllime të raportimit dy herë në vit nga shkolla për prindërit dhe kujdestarët për përparimin dhe arritjen e nxënësve;
- testimin periodik me kampione të fushave të veçanta të të nxënit në kuadër të vlerësimit të kurikulës, si pjesë e programit të vlerësimit kombëtar.

Duke qenë se në këtë lëndë përparësi i jepet vlerësimit joformal të nxënësve, teknikat joformale në vijim sugjerohet të shoqërohen, kur është e domosdoshme dhe e mundur, edhe me teknika formale, si testimet me shkrim ose me gojë, sidomos në shkallën e tretë të kurikulës së arsimit bazë, klasa e gjashtë dhe e shtatë.

***a. Vëzhgimi***

Mësuesi vlerëson ecurinë e nxënësve, duke i vëzhguar ata gjatë punës individuale ose në grup, si dhe ndërveprimin e tyre gjatë veprimtarive të ndryshme në klasë dhe në shkollë. *Mësuesi vëzhgon aspekte, të tilla si:*

- aftësinë e nxënësve për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për të bashkëpunuar në grup;
- ndërveprimet e nxënësve me njëri-tjetrin dhe me të rriturit;
- cilësinë e prezantimit të punimeve;
- interesat, aftësitë ose talentet e veçanta të nxënësve;
- pjesëmarrjen dhe interesin që shprehin nxënësit në veprimtari e aktivitete të ndryshme;
- përgjegjësinë vetjake dhe shoqërore që shfaqin nxënësit;
- përkushtimin dhe këmbënguljen e nxënësve në kryerjen e detyrave të ndryshme;
- nivelin e ndërgjegjësimit të nxënësve për vështirësitë që mund të kenë të tjerët dhe gatishmërinë për t'i ndihmuar ata;
- pyetjet që shtrojnë nxënësit, përgjigjet dhe sugjerimet që nxënësit u japin pyetjeve të mësuesit dhe nxënësve të tjerë;
- sjellje të caktuara, si: aftësitë drejtuese, niveli i vetëbesimit, të shprehurit në mënyrë të drejtpërdrejtë e të hapur, gatishmëria për të përballuar rreziqe, sfida e vështirësi;
- pjekurinë fizike dhe emocionale;
- aftësinë për të vetëvlerësuar ecurinë në shkollë.

Mësuesi i vëzhgon nxënësit jo vetëm në klasë, por edhe jashtë saj, në veprimtari të ndryshme shkollore, për shembull: gjatë lojës, në festime, në ekskursione etj. Mësuesi mund t'i mbajë shënim vëzhgimet për secilin nxënës, në mënyrë që të mund të krijojë një pamje të përgjithshme të ecurisë së zhvillimit të tyre. Kjo i shërben mësuesit edhe për t'ua komunikuar ecurinë e nxënësve prindërve të tyre.Në rastet kur nxënësi ndryshon shkollë, ky lloj vlerësimi mund të ndahet me mësuesin e ri ose me mësuesit pasues të ciklit në vijim. Vëzhgimi ndihmon sidomos vetë mësuesin, i cili, pasi ka kuptuar nevojat e veçanta të secilit nxënës, duhet të rishikojë metodologjitë e mësimdhënies, në mënyrë që ato të lehtësojnë të nxënit e gjithsecilit. Nëse mësuesi vëren nevoja të veçanta në sjelljen e nxënësve, karakteristike për nxënësit në shkollën e tij, në bashkëpunim me mësuesit e tjerë dhe drejtuesin e shkollës, mund të vendosë të përqendrohet më gjatë në atë aspekt të programit, i cili ndihmon në përmbushjen e këtyre nevojave.

***b. Detyrat dhe testet***

Me anë të detyrave të ndryshme që mësuesi u jep nxënësve në klasë, ai arrin të vlerësojë si procesin e punës, ashtu edhe nivelin e të kuptuarit të njohurive të reja nga ana e nxënësve. Me anë të detyrave, mësuesi mund të vlerësojë edhe aftësinë e nxënësve për t'i përdorur dijet e marra në situata nga më të ndryshmet. Detyrat në klasë mund të jenë projekte në grup ose punë individuale.

Një shembull i detyrës në klasë mund të jetë dhënia e një situate, e cila kërkon zgjidhje, ku nxënësit duhet të marrin një vendim së bashku dhe ta mbrojnë atë. Gjatë punës në grup të nxënësve, mësuesi vlerëson demonstrimin e kompetencave dhe aftësinë egjithsecilit për të punuar në grup.

Testet, si teknikë vlerësimi, rekomandohet të përdoren duke filluar nga klasa e gjashtë e më tej, pasi nxënësit të jenë zhdërvjelltësuar në të shkruar dhe të kenë nisur të marrin njohuri të mirëfillta, të cilat mund të testohen me shkrim. Mësuesi mund t'i përdorë testet me shkrim në fund të një tematike si një teknikë vetëvlerësimi nga ana e nxënësve, pra t'i lejojë ata t'i korrigjojnë vetë testet për të reflektuar e për t'u ndërgjegjësuar mbi aftësitë dhe kufizimet e tyre.

***c. Dosja e nxënësit***

Duke qenë se lënda e historisë synon aftësimin praktik të nxënësve, ***gjatë shkallës së dytë*** të kurikulës sugjerohet që nxënësit të mbajnë një dosje vetjake me punimet që kryejnë gjatë veprimtarive në klasë. Nxënësit mund të mbledhin në të anketat e përdorura gjatë një vrojtimi, burimet historike të përdorura për të kuptuar ndryshimin dhe vazhdimësinë, të tilla si: fotografi, pamje ose skica, vizatimet e kryera në klasë, listën e objektivave në fillim të vitit,poezi ose tregime mbi tema të caktuara historike.

Dosja është një mjet i rëndësishëm për vetëvlerësimin e nxënësve, si dhe për vlerësimin e ecurisë së tyre nga ana e prindërve. Kjo dosje mund të përdoret edhe si informacion për ecurinë e nxënësve për mësuesit e rinj kur ata ndryshojnë shkollë ose për mësuesit e ciklit pasues.

***d. Projektet***

Projektet i ndihmojnë nxënësit të përqendrohen në një temë të caktuar të programit, për shembull, në njohjen e komunitetit ku ata jetojnë dhe studimin e tij me hollësi. Me anë të projektit, mësuesi vlerëson aftësinë e nxënësve për të mbledhur informacion, për ta përpunuar dhe për ta prezantuar atë. Puna me projekte mundëson edhe vlerësimin e bashkëpunimit të nxënësve me njëriTtjetrin gjatë punës në grup. Realizimi i një projekti është tregues edhe i përgjegjësisë vetjake e të grupit, si dhe i përkushtimit e interesit të secilit nxënës.

***e. Paraqitja e punimeve***

Shpjegimi dhe paraqitja e punimeve të ndryshme që realizojnë nxënësit gjatë lëndës së historisë, është për mësuesin tregues i aftësive të tyre për të mbledhur informacion, për ta përpunuar dhe për ta paraqitur atë. Gjatë paraqitjes së punimeve, nxënësit vlerësohen edhe për shtjellimin e këndvështrimeve të tyre, mbrojtjen e këtyre këndvështrimeve dhe mbajtjen e

qëndrimit vetjak ose në grup ndaj një çështjeje të caktuar. Me anë të kësaj teknike vlerësohen kompetencat historike dhe kompetencat kyç, si ajo e komunikimit dhe e të menduarit. Pavarësisht zgjedhjes nga ana e mësuesit të teknikave të vlerësimit, qofshin këto formale ose joformale, vlerësimi duhet domosdoshmërisht të synojë përmirësimin e përvojave të të nxënit të nxënësve.

Vlerësimi i nxënësit përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënësit nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në njohuritë e programit lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato njohuri që nuk përshkruhen në program.Objektiv i vlerësimit nuk janë vetëm kompetencat, njohuritë dhe shprehitë, por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etike‐sociale, në përgjithësi, edhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, nëveçanti.



## 5. MATERIALET DHE BURIMET MËSIMORE

Përdorimi i mjeteve mësimore në mësimdhënien dhe procesin e të nxënit në fushën "**Shoqëria dhe mjedisi**" ndihmon në konkretizimin e ideve dhe dukurive, në aplikimin e metodave dhe strategjive të mësimdhënies, si dhe e bën mësimin më interesant dhe më argëtues për nxënësin. Përdorimi i suksesshëm i metodave dhe i teknikave të lartpërmendura nuk mund të realizohet pa mjetet e nevojshme didaktike, të cilat mund të jenë të llojeve të ndryshme, si: harta tematike, atlase, albume, foto, skica, filma mësimorë, videokaseta, kompjutera, aparat projektimi, CD, DVD etj.

Ndërsa mësuesi është përgjegjës për krijimin e një mjedisi stimulues, ai duhet të sigurojë që nxënësi të ketë mundësi të shfrytëzojë burimet e ndryshme të të nxënit. Lista e burimeve të vlefshme për zhvillimin e kompetencave në histori është e larmishme: muzeume, objekte të trashëgimisë kulturore, harta, piktura, dokumente historike, dokumente audiovizive, libra historikë etj. Gjithashtu, burimet përfshijnë teknologjitë e informacionit dhe komunikimit që nxënësit i përdorin si mjete kërkimi edhe për përgatitjen e projekteve dhe detyrave të ndryshme.

**Sugjerime për përdorimin e TIK-ut**

-Përdorimi i postës elektronike për shkëmbim informacioni.

-Përdorimi i internetit për të shfrytëzuar faqet web për historinë.

- Përdorimi i CD-ROM-it për mbledhjen e informacionit mbi temat që ai/ajo studion.

- Organizimi dhe prezantimi i të dhënave, duke përdorur tipa të ndryshëm software-i.

-Përdorimi i simulimeve software.

-Përdorimi i grafikëve software.

-Paraqitja grafike e të dhënave.

## 6. REKOMANDIME PËR HARTIMIN E NJË PLANI MËSIMOR DITOR

**Elementet përbërës të çdo ditari mësimor janë**:

***- Tema***

***- Kompetencat***

***- Fjalë kyç***

***- Struktura e mësimit***

***- Metoda dhe veprimtaritë e nxënësit***

***- Vlerësimi i nxënësit***

***- Orientimi për temën e ardhshme***

***- Detyra e shtëpisë***

## 7. PROGRAMI ANALITIK

**Viti shkollor 35 javë x 2 orë = 70 orë**

| | |
|---|---|
| **Tema të reja** | **42 orë** |
| **Veprimtaripraktike** | **15 orë** |
| **Projekte** | **5 orë** |
| **Përsëritje** | **5 orë** |
| **Teste** | **3orë** |

## 8. OBJEKTIVAT MËSIMORE SIPAS TAKSONOMISË SË BLUMIT

| | |
|---|---|
| **NJOHJA** | Përkujtimi i asaj që është mësuar më herët (nga fakte të ndara deri në teori të plota) |
| **KUPTIMI** | Kuptimi i domethënies së materialit (shpjegim i ideve dhe i koncepteve) |
| **ZBATIMI** | Shfrytëzimi i të mësuarit në situata të reja konkrete |
| **ANALIZA** | Zbërthimi i të gjitha pjesëve përbërëse dhe përcaktimi i marrëdhënieve të ndërsjella |
| **SINTEZA** | Bashkimi i pjesëve për të krijuar një tërësi të re dhe për të nxjerrë përfundime logjike |
| **VLERËSIMI** | Vlerësimi ose arsyetimi i vendimit ose veprimit në bazë të kritereve |

**Foljet që përdoren për ndërtimin e objektivave mësimore sipas niveleve:**

| Të njohurit | Të kuptuarit | Zbatimi | Analiza | Sinteza | Vlerësimi |
|---|---|---|---|---|---|
| Përshkruaj<br>Përcakto<br>Identifiko<br>Etiketo<br>Rendit<br>Përkufizo<br>Bashko<br>Emërto<br>Përmblidh | Dallo<br>Transformo<br>Ilustro<br>Shpjego<br>Zgjero<br>Përgjithëso<br>Përcakto<br>Rendit<br>Perifrazo | Llogarit<br>Demonstro<br>Zhvillo<br>Përgatit<br>Provo<br>Vepro<br>Organizo<br>Lidh<br>Ndërto<br>Përdor | Copëto<br>Nxirr përfundime<br>Bëj grafikun<br>Bëj dallimin<br>Ndaj<br>Shquaj<br>Ilustro<br>Kombino<br>Përvijo<br>Kategorizo | Kategorizo<br>Përpilo<br>Kompozo<br>Veço<br>Krijo<br>Harto<br>Përgjithëso<br>Formulo<br>Parashiko<br>Prodho | Vlerëso<br>Krahaso<br>Bëj dallimin<br>Përcakto<br>Kritiko<br>Gjyko<br>Zgjidh<br>Justifiko<br>Mbështet<br>Argumento |

## 9. PLANIFIKIMI I KURIKULËS

## PLANI MËSIMOR VJETOR, KLASA VII

**FUSHA: SHOQËRIADHE MJEDISI**
**LËNDA: HISTORI**

**Tematika 1. Qytetërimet në fillimet e historisë moderne Ͳ 22 orë gjithsej**

Tema të reja: 10 orë
Veprimtari: 7 orë
Projekte: 2 orë
Përsëritje: 2 orë
Test: 1 orë

**Tematika 2. Koha e ndryshimeve thelbësore – 48 orë gjithsej**

Tema të reja: 32 orë
Veprimtari: 8 orë
Projekte: 3 orë
Përseritje: 3 orë
Test: 2 orë

**KLASA 7**

**Tematika 1. Qytetërimet në fillimet e historisë moderne T22 orë**

**gjithsej Tema të reja: 10 orë**
**Veprimtari: 7 orë**
**Projekte: 2 orë**
**Përsëritje: 2 orë**
**Test: 1 orë**

| | |
|---|---|
| Përmes kësaj tematike, nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi/shkathtësi, qëndrime dhe vlera mbi ndryshimet në qytetërimet botërore në fillimet e historisë moderne. Ajo përshkruan: humanizmin dhe thelbin e tij; Rilindjen, frymën e saj në art, kulturë, shkencë e në shoqëri; Italinë, si qendrën e Rilindjes Europiane; Europa drejt njohjes së "Botës së Re"; rrethanat historike që nxitën zbulimet gjeografike; në kërkim të rrugëve të reja: zbulimet e mëdha gjeografike; kultura dhe shoqëria vendase (acteke, inke); krijimi i kolonive të para dhe fillimi i sundimit të skllavërisë moderne; pasojat e zbulimeve gjeografike; ndryshimet fetare në Europë; rrënjët e Reformacionit, doktrina protestante, përfaqësuesit kryesorë; reforma katolike dhe karakteri relativ i saj; Perandoria Osmane dhe Europa; zgjerimi i Perandorisë Osmane në territoret europiane dhe ndërprerja e ekspansionit osman në Europë; ndikimi i qytetërimit osman në Europë; shoqëria, arti dhe kultura në shek. XVITXVII; shoqëria, mënyra e jetesës në përputhje me shtresat, pozita e gruas në shoqëri; kultura, arti, shkenca dhe arsimi.<br>Kjo tematikë sugjerohet të zhvillohet në 22 orë mësimore. Për tematikën e dhënë më poshtë janë parashikuar dhe veprimtari/projekte, të cilat jepen në rubrikën "**Situata të sugjeruara**". Këto orë veprimtarish/projektesh, mësuesi dhe autori i tekstit i integron brenda orëve të tematikës. Tematika së bashku me veprimtaritë/projektet realizojnë kompetencat lëndore dhe kompetencat kyç për të nxënit gjatë gjithë jetës. | |
| **Klasa 7**<br>**Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës** | **Klasa 7**<br>**Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të lëndës** |
| **1.1 Humanizmi**<br>a. Kushtet historike që çuan në lindjen e Humanizmit<br>b. Tiparet e Humanizmit<br>c. Përfaqësuesit kryesorë të Humanizmit | ▸ përcaktonkushtet historike që çuan në lindjen e Humanizmit;<br>▸ rendit tiparet e Humanizmit;<br>▸ identifikon përfqësuesit kryesorë të Humanizmit. |
| **1.2 Rilindja europiane**<br>a. Kushtet historike që kushtëzuan fillimin e Rilindjes Europiane<br>b. Qytetet italiane – djepi i qytetërimit modern europian<br>c. Roli i shtypshkronjës në zhvillimin e Rilindjes | ▸ përshkruan kushtet historike qëkushtëzuan fillimin e Rilindjes Europiane;<br>▸ evidenton arsyet e shndërrimeve të qyteteve në djepin e qytetërimit modern europian;<br>▸ përcakton rolin e shtypshkronjës në zhvillimin e Rilindjes. |
| **1.3 Humanistët shqiptarë**<br>a. Kushtet historike të Humanizmit shqiptar<br>b. Veprimtaria e humanistëve shqiptarë<br>c. Humanizmi shqiptar dhe ai europian | ▸ përcakton tematikën e veprave që krijuan humanistët shqiptarë;<br>▸ gjykon mbi motivet që i shtynë humanistët shqiptarë të vinin në qendër të veprave të tyre figurënlegjendare të Gjergj Kastriotit Skënderbeut;<br>▸ identifikon elementet e përbashkëta mes |

| | |
|---|---|
| | humanizmit shqiptar dhe atij europian. |
| **1.4 Veprimtari praktike: Vizitë në muze "Kontributi i humanistëve shqiptarë në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare"** | ▸ identifikon figurat më të rëndësishme të humanizmitshqiptar;<br>▸ përcaktonkontributin e tyre në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare. |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 27 | | 2.5. Rrjedhojat e Revolucionit të Parë Industrial | Shtëpitë, që nga bodrumet deri në çati janë të mbushura plot e përplot me qiraxhinj dhe janë aq të pista nga jashtë e nga brenda saqë askush, nuk do të pranonte të banonte në to. | Punë në dyshe, pyetje–përgjigje, harta e të pyeturit. | Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në përgjigje, debate, diskutime, krijimin e hartës së të pyeturit. | Teksti Historia 7, materiale nga Interneti, You tube, dokumenta historikë etj. |
| 28 | IIKOHA E NDRYSHIMEVE THELBËSORE | 2.6. Revolucioni anglez i shekullit XVII | Mbret Karli I Stjuart, në vitin 1649, pas gjyqit, nën akuzën e tradhëtisë, u dënua me vdekje. Mbretit iu pre koka. Deri në këtë kohë mbretërit ishin rrëzuar nga froni, ishin vrarë në beteja, por asnjëherë nuk kishte patur ekzekutim në publik. | Lojë me role, diskutim. | Nxënësit vlerësohen për lojën me role, plotësimin e ngjarjeve dhe diskutimet në klasë. | teksti Historia 7, Karl Grimberg, “Historia Botërore dhe Qytetërimi”, materiale nga Interneti, You tube, dokumenta historikë. |
| 29 | | 2.7. Monarkia Parlamentare në Angli | Pas thyerjes së flotës spanjolle Anglia u bë forca kryesore tregtare në botë. Vilhelm Oranxhi me ndihmën e parlamentit u bë mbret i Anglisë. Në Angli u vendos monarkia parlamentare. | Parashikim me terma paraprakë, punë në dyshe, diskutim. | Nxënësit vlerësohen për përgjigjet e dhëna si dhe pjesëmarrjen në diskutim. | teksti Historia 7, Karl Grimberg, “Historia Botërore dhe Qytetërimi”, materiale nga Interneti, You tube, dokumenta historikë etj. |
| 30 | | 2.8. Revolucioni amerikan i shekullit të XVIII | “Ne konsiderojmë të rëndësishme të vërtetat e mëposhtme: të gjithë njerëzit janë krijuar të barabartë dhe krijuesi i tyre u ka dhënë disa të drejta të patjetërsueshme: jeta, liria dhe dëshira për lumturi. Për sigurimin e këtyre të drejtave është krijuar qeveria, e cila nëse nuk i përmbush këto qëllime, atëherë populli ka të drejtë ta ndryshojë ose ta | Stuhi mendimesh, parashikim me terma paraprakë. | Nxënësit vlerësohen për përgjigjet e dhëna gjatë orës së mësimit. | Teksti Historia 7, Karl Grimberg, “Historia Botërore dhe Qytetërimi”, materiale nga Interneti, You tube, dokumenta historikë etj. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | përmbysë, dhe të krijojë një qeveri të re që mund t'i sigurojë atij jetën dhe lumturinë." | | | |
| 31 | IIKOHA E NDRYSHIMEVE THELBËSORE | 2.9. Projekt: "Risitë e Kushtetutës amerikane në qytetërimin botëror". | A e dini se Kushtetuta amerikane ekziston dhe sot me pak ndryshime? Ajo u mbështet në idetë e iluminizmit evropian. Ajo shpalli shtetin republikan dhe presidenti i parë ishte Xhorxh Uashingtoni. | Punë individuale, diskutim | Nxënësit vlerësohen për punën individuale dhe diskutimet në klasë. | Teksti Historia 7, Karl Grimberg, "Historia Botërore dhe Qytetërimi", materiale nga Interneti, You tube, dokumenta historikë etj. |
| 32 | | 2.10. Lufta civile në SHBA | Abraham Linkoln: "Një shtëpi, ku dy pjesët janë kundër njëra tjetrës, nuk mund të mbijetojë. Unë nuk besoj se ky popull dëshiron të qëndrojë i ndarë, në shtete të lira dhe shtete që i përkasin skllavërisë." | Parashikim me terma paraprakë, punë në dyshe, diskutim. | Nxënësit vlerësohen për përgjigjet e dhëna si dhe pjesëmarrjen në diskutim. | teksti Historia 7, Karl Grimberg, "Historia Botërore dhe Qytetërimi", materiale nga interneti, You tube, dokumenta historikë etj, |
| 33 | | 2.11.Veprimtari praktike: "Respektimi i të drejtave të njeriut. Roli i Abraham Linkoln në mbrojtje të të drejtave të njeriut | Nxënësit rikujtojnë njohuritë e marra për Revolucionin Amerikan, luftën civile por edhe për respektimin e të drejtave të njeriut dhe rëndësinë që iu dha Abraham Linkolnit. | Punë me grupe, punë me gjithë klasën | Nxënësit vlerësohen për gjetjen dhe përzgjedhjen e materialit (përdorimin e teknologjisë), punën në grup, përgjigjet individuale. | Teksti i historisë, materiale nga Interneti, fotografi, enciklopedi. |
| 34 | | 2.12. Fillimi i Revolucioni Francez të shekullit XVIII | ... Populli u armatos me shkopinj, thika dhe heshta dhe i frymëzuar nga qëllime të ndryshme, sulmoi çdo gjë që gjente përpara. Turma mori topat e gardës franceze dhe flamurët e qytetit. Çdo qytetar e shpalli veten ushtar të atdheut. Qelitë e burgjeve u hapën dhe të gjithë të dënuarit, me përjashtim të kriminelëve, u liruan. | Punë me grupe, Di/Dua të di /Mësova. | Vrojtimet e mësuesit,lista e kontrollit. | teksti Historia 7, Karl Grimberg, "Historia Botërore dhe Qytetërimi", materiale nga Interneti, You tube, dokumenta historikë etj. |
| 35 | IIKOHA E NDRYSHIMEVE | 2.13. Revolucioni francez. Shpallja e Republikës | Më 26 gusht 1789, në Francë u miratua Deklarata e të Drejtave të Njeriut dhe Qytetarit. Deklarata shpalli se pushteti buron nga populli dhe i takon popullit. Kjo tregon se monarkisë | Të nxënët në bashkëpunim, fjalë të njëpasnjëshme. | Nxënësit vlerësohen për përgjigjet e dhëna si dhe për plotësimet e shokëve. | teksti Historia 7, Karl Grimberg. "Historia Botërore dhe Qytetërimi", materiale nga |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | absolute po i vinte fundi. | | | Interneti, You tube, dokumenta historikë etj. |
| 36 | | 2.14. Periudha e sundimit të Napoleon Bonapartit | A keni dëgjuar ndonjëherë për Napoleon Bonapartin? Ai sundoi në Francë dhe dominoi historinë Europiane nga viti 1799 – 1815. Motoja e tij ishte: Fjala "e pamundur" nuk ekziston në fjalorin tim. | Diskutim, stuhi mendimesh, pyetje-përgjigje. | Nxënësit vlerësohen për diskutimet dhe përgjigjet e pyetjeve nga mësuesi. | Teksti Historia 7, Karl Grimberg, "Historia Botërore dhe Qytetërimi", materiale nga Interneti, You tube, dokumenta historikë etj. |
| 37 | | 2.15. Krijimi i Perandorisë Franceze të Napoleonit dhe rënia e saj | Në shekullin XX filloi zbatimi i ideve të Napoleonit. Mbetën profetike shprehjet e tij: "Do të vijë një ditë që fitoret do të korren pa topa dhe bajoneta. Kush turbullon paqen e Europës, kërkon luftë civile". | Të nxënët në bashkëpunim, fjalë të njëpasnjëshme. | Nxënësit vlerësohen për përgjigjet e dhëna si dhe për plotësimet e shokëve. | Teksti Historia 7, Karl Grimberg, "Historia Botërore dhe Qytetërimi", materiale nga Interneti, You tube, dokumenta historikë etj. |
| 38 | | 2.16. Përsëritje | Nxënësi përsërit temat 2.1-2.15. Fisha dhe kuize. Nxënësit japin përgjigje pyetjeve dhe dikutojnë rreth tyre. | Punë individuale, zgjidhja e problemit. | Vrojtimet e mësuesit, lista e kontrollit. | Përdoren hartat e Francës, SHBA, Perandorisë së Napoleon Bonapartit etj. |
| 39 | IIKOHA E NDRYSHIMEVE THELBËSORE | 2.17. Kongresi i Vjenës | Madhëritë e tyre perandori austriak, mbreti i Prusisë dhe perandori i gjithë Rusisë shpallin solemnisht Neni 1 ... tre monarkët pjesëmarrës në traktat do të jenë të bashkuar me lidhje vëllazërore me të vërtetë të sinqerta dhe të pazgjidhura dhe duke e konsideruar veten si banorë të një toke, ata do t'i japin njëri-tjetrit në çdo rast e në çdo vend çdo ndihmë dhe përkrahje ... | Pyetje-përgjigje, diskutim i hapur | Nxënësit vlerësohen për përgjigjet e dhëna si dhe në diskutimet e ndryshme. | Teksti Historia 7, Karl Grimberg, "Historia Botërore dhe Qytetërimi", materiale nga Interneti, You tube, dokumenta historikë etj. |
| 40 | | 2.18. Jeta dhe Nacionalizmi në Europën e shekullit XIX | Po të pyesësh një njeri se çfarë është, ai përmend kombësinë e tij dhe përgjigjet: jam shqiptar, | Parashikim me terma paraprake, leximi i orientuar, punë dyshe, harta e | Nxënësit vlerësohen për mendimet që japin, për përgjigjet e pyetjeve të dhëna | Teksti, materiale nga Interneti |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | grek, turk, amerikan etj. Kombi është një popull që ka origjinë, gjuhë dhe tradita të njëjta. Kombi organizohet dhe krijon shtetin kombëtar. | koncepteve. | nga mësuesi/ja, bashkëpunimin dhe ndarjen e ideve me njëriƬtjetrin dhe plotësimin e hartës së koncepteve. | |
| 41 | | 2.19. Perandoria Austriake në vitet ’50 – ’60 të shekullit XIX | Perandoria Habsburgse ishte një perandori shumëkombëshe. Në të bënin pjesë austriakët, hungarezët, italianët, gjermanët, çekët, polakët etj. | Të nxënët në bashkëpunim, fjalë të njëpasnjëshme. | Nxënësit vlerësohen për përgjigjet e dhëna si dhe për plotësimet e shokëve. | Teksti Historia 7, Karl Grimberg, “Historia Botërore dhe Qytetërimi”, materiale nga Interneti, You tube, dokumenta historikë etj. |
| 42 | | 2.20.Bashkimi i Gjermanisë | Oto von Bismark ishte i mendimit se bashkimi i vërtetë i shteteve gjermane mund të realizohej vetëm nën udhëheqjen e Prusisë. Ai mendonte se ky bashkim do të realizohej me çfarëdo mjeti, duke përdorur edhe forcën ushtarake. | Lexim i orjentuar, metoda e akuariumit, bashkëbisedim pyetjeƬpërgjigje. | Vrojtimet e mësuesit, lista e kontrollit. | Teksti Historia 7, Karl Grimberg, “Historia Botërore dhe Qytetërimi”, materiale nga Interneti, You tube, dokumenta historikë etj. |
| 43 | IIKOHA E NDRYSHIMEVE THELBËSORE | 2.21. Lëvizjet nacionale në Itali | Garibaldi për betejën e Kalatafimit në Siçili, maj 1860 shprehet: “… Si mund ta harroj trimërinë e të rinjve, të cilët i vunë përpara ushtarët napolitanë. Duke patur frikë se mos plagosesha me rrethuan mua, u afruan ngushtë pranë njëriƬtjetrit dhe formuan një gardh të padepërtueshëm .... më në fund, ne kaluam në sulmin e fundit. U mbushën me frymë dhe si luanë u hodhën përpara, të bindur në fitoren e çështjes së madhe për të cilën luftonin.” | Leximi i orientuar, ditari dypjesësh, Diagrami i Venit | Nxënësit vlerësohen për rindërtimin e njohurive duke analizuar njohuritë e dhëna, përzgjedhjen dhe klasifikimin e materialeve të marra nga interneti. | Teksti, material nga Interneti |
| 44 | | 2.22. Perandoria Osmane dhe tkurrja e saj | Në fund të shekullit XIX Perandoria Osmane ishte dobësuar aq shumë sa thirrej “i sëmuri i Bosforit”. | Stuhi mendimesh, leximi i orientuar, harta e koncepteve | Nxënësit vlerësohen për: aktivizimin gjatë orës së mësimit, mënyrën e demostrimit të të dhënave në hartën konceptuale, | Teksti i Historisë, Materiale nga Interneti |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | analizimin e informacionit historik duke u bazuar në argumenta. | |
| 45 | | 2.23. Test | Punë e parpërgatitur nga mësuesi | Test megrupe. | Vlerësim me shkrim | Teksti |
| 46 | | 2.24. Revolucioni i Dytë Industrial | Sot, në jetën e përditshme, lëvizja me makina, përdorimi i telefonit, bërja e fotografive, ndriçimi elektrik etj., na duken gjëra shumë normale. Madje nuk mund ta imagjinojmë dot jetën pa to. Por, para shekullit XIX ato nuk ekzistonin. U shpikën në fund të shekullit, dhe kanë qënë shpikjet më të mëdha tëkohës. | Parashikim me terma paraprakë. TDitari dy pjesësh, përpunim i njohurive | Nxënësit vlerësohen për rindërtimin e njohurive, mënyrën se si përpunojnëdhe analizojnë informacionin historik. | Teksti i historisë, materiale nga Interneti, fotografi, enciklopedi. |
| 47 | IIKOHA E NDRYSHIMEVE THELBËSORE | 2.25. Industrializimi dhe qytetërimi botëror | Forca e re energjetike lëvizëse ishte përdorimi i motorit me djegie të brendshme (diesel) si dhe përdorimi i energjisë elektrike. | Lexim i orjentuar, interpretim grafik, punë në grupe, turi i galerisë | Nxënësit vlerësohen për përvetësimin e njohurive, të menduarit dhe të shprehurit, mënyrën e të argumentuarit rreth pyetjeve. | Teksti i historisë, materiale nga Interneti, fotografi, enciklopedi. |
| 48 | | 2.26.Veprimtari praktike: Arritjet e Revolucionit të Dytë Industrial | Nxënësit rikujtojnë njohuritë e marra për Revolucionin e Dytë Industrial. Zhvillimet e industrive kryesore, shpikjet në shkencë, mjekësi, emrat e shkencëtarëve të mëdhenj. | Punë me grupe, punë me gjithë klasën | Nxënësit vlerësohen për gjetjen dhe përzgjedhjen e materialit (përdorimin e teknologjisë), punën në grup, përgjigjet individuale. | Teksti i historisë, materiale nga interneti, fotografi, enciklopedi |
| 49 | | 2.27. Fillesat e demokracisë liberale në Britaninë e Madhe | Një historian për Epokën Viktoriane shprehet: "Qetësia mbretëronte në skenën politike. Pranimi i ndërmarrjeve të lira ishte fakt, ekonomia ishte më e lulëzuar se kurrë. Tensionet midis klasave të ndryshme dhe kontradiktat ishin zbutur". | Stuhi mendimesh, leximi i orientuar, metoda e akuariumit, bashkëbsedim: pyetje – përgjigje | Nxënësit vlerësohen për mënyrën se si analizojnë dhe komunikojnë informacionin historik, përqëndrimin dhe pjesëmarrjen në orën e mësimit. | Teksti i historisë, materiale nga Interneti, fotografi, enciklopedi. |
| 50 | | 2.28.Fillesat e demokracisë liberale në Francë | Nxënësve u kërkohet të rikujtojnë luftën FrankoT Prusiane të viteve 1870 – 1871. Përse u zhvillua? | Parashikim me terma paraprakë, punë në dyshe, harta e koncepteve. | Nxënësit vlerësohen për përpunimin dhe paraqitjen e informacionit, bashkëpunimin me njëri – tjetrin | Teksti i historisë, materiale nga Interneti, fotografi, enciklopedi. |

## Planifikimi tre mujor (prill Ŧ qershor)

| Nr | Tematika | Temat mësimore | Situata e parashikuar e të nxënit | Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve | Vlerësimi | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 51 | IIKOHA E NDRYSHIMEVE THELBËSORE | 2.29.Fillesat e demokracisë liberale në Gjermani | Jepet fotografi ku tregohet ceremonia e bashkimit të Gjermanisë. Nxënësit komentojnë fotografinë. | Di, Dua të di, Mësova, Rishikim në dyshe | Nxënësit vlerësohen për përvetësimin e njohurive, të menduarit dhe të shprehurit, mënyrën e të argumentuarit rreth pyetjeve. | Teksti i historisë, materiale nga Interneti, fotografi, enciklopedi. |
| 52 | | 2.30. Fillesat e demokracisë liberale në SHBA | Amerika u bë vendi i një populli me energji të mëdha, tek i cili shpirti i iniciativës nuk njihtemasë. Amerikanët patën për hyjni Biblën, Kushtetutën amerikane dhe dollarin. “ËndrraAmerikane” kishte si hero njeriun që e kishte filluar nga asgjëja, por që arrinte të bëhej milioner. | Bisedë e lirë, Leximi kuiz, Harta e koncepteve | Nxënësit vlerësohen për mënyrën se si analizojnë dhe komunikojnë informacionin historik, përqëndrimin dhe pjesëmarrjen në orën e mësimit. | Teksti i historisë, materiale nga Interneti, fotografi, enciklopedi. |
| 53. | | 2.31.Përsëritje (4)Temat 2.24Ŧ 2.30 | Nxënësi përsërit temat 2.24Ŧ 2.30.<br>Fisha dhe kuice. Nxënësit japin përgjigje pyetjeve dhe dikutojnë rreth tyre. | Punë individuale, zgjidhja e problemit. | Vrojtimet e mësuesit, lista e kontrollit. | Teksti Historia 7, materiale nga interneti |
| 54. | | 2.32. Veprimtari praktike: “ Monarkët e ndriçuar . Roli i Pjetrit të Madh në europianizimin e Rusisë”. | Në internet gjenden informacione të shumta për Pjetrin e Madh të Rusisë. A munden nxënësit ti gjejnë ato? A mund të bashkëpunojnë në grup? | Punë individuale, punë në dyshe, punë në grup. | Nxënësit vlerësohen për punën individuale dhe në grup | Interneti, katalogje, fotografi të ndryshme, udhëzues, libra historikë etj. |
| 55. | | 2.33. Veprimtari praktike: Demokracia liberale në mjedisin tonë shkollor”. | Në internet gjenden informacione të shumta për demokracinë liberale. A funksionon ajo në shkollën tonë? Si? A është e dukshme? Mund ta paraqesim atë me anë të një fotomontazhi apo videoje? | Punë individuale, punë në dyshe, punë në grup. | Nxënësit vlerësohen për punën individuale dhe në grup | Interneti, katalogje, fotografi të ndryshme, udhëzues, libra historikë etj. |
| 56. | | 2.34. Imperializmi dhe nacionalizmi i skajshëm në | Që nga Kongresi i Berlinit 1878 deri në vitin 1900, më shumë se 100 milion njerëz në mbarë botën janë "kolonizuar". Kolonializmi | Stuhi mendimesh, harta e mendimeve, punë individuale. | Nxënësit vlerësohen për punën individuale në plotësimin e hartës së të | Karl Grimberg, “Historia Botërore dhe Qytetërimi”, materiale nga |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | fund të shekullit XIX | ishte dukuria kryesore e shek XIX. Nga një përvojë tregtare kthehet në një pushtim ushtarak, territorial, skllavërim dhe shfrytëzim. | | pyeturit, aktivizimin gjatë orës së mësimit. | Interneti, You tube, dokumenta historikë etj. |
| 57 | | 2.35.Veprimtar i praktike: Marrëdhëniet e Evropës me botën koloniale | Holanda krijoi "Indinë Holandeze", sot Indonezinë, Franca pushtoi një pjesë të Indokinës, Anglia zotëronte Indinë, Singaporin dhe Hong־Kongun.Afrika ishte tërësisht e kolonizuar nga anglezët, francezët, belgët, gjermanët. | Punë në grup, hulumtim. | Vlerësim për detyrën individuale hulumtuese. | Historia 7, Historia e Popullit Shqiptar, materiale nga Interneti. |
| 58. | | 2.36.Pashallëq et shqiptare dhe zgjimi i ndërgjegjes kombëtare në Shqipëri gjatë shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX | Fuqizimi i lëvizjes çlirimtare gjatë shekullit XIX, përgatiti kushtet për krijimin e shtetit të pavarur shqiptar. Rritja e ndjenjës kombëtare i ndihmoi shqiptarët të kapërcenin përçarjet e brendshme dhe të bashkoheshin për një qëllim të përbashkët; mbrojten e kombit dhe atdheut. | Stuhi mendimi, tabela e koncepteve | Vlerësim për detyrat individuale. | Historia 7, Historia e Popullit Shqiptar, materiale nga Interneti, fotografi të pashallëqeve, Rilindësve, Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. |
| 59 | | 2.37. Veprimtari praktike: Ese argumentuese: "Kontributi i Rilindjes Kombëtare në mbrojtje të çështjes shqiptare". | Rilindësit ishin energjia e brendshme e çdo patrioti shqiptar në mbrojtje të çështjes shqiptare. | Punë individuale, hulumtim. | Vlerësim për detyrën individuale. | Historia 7, Historia e Popullit Shqiptar, materiale nga Interneti, fotografi të Rilindësve, Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. |
| 60. | | 2.38. Shpërbërja e Perandorisë Osmane. Krijimi i shtetit të pavarur grek | Në luftën e popullit grek kundër pushtimit osman, kanë luftuar edhe shqiptarët. Si e shpjegoni ju këtë? Grekët u ndihmuan nga europianët dhe rusët, dy armiqtë më të mëdhenj të Perandorisë Osmane. | Punë në grupe, stuhi mendimesh, diskutim i lirë. | Vlerësim nga diskutimi, i punës në grupe dhe hartës së të pyeturit. | Karl Grimberg, "Historia Botërore dhe Qytetërimi", materiale nga Interneti, You tube, dokumenta historikë etj. |
| 61. | | 2.39. Shpërbërja e Perandorisë Osmane. Krijimi i shtetit serb | Millosh Obrenoviç ishte një ndër figurat kryesore që kontribuoi në shpalljen e pavarësisë së shtetit serb. Periudha e sundimit të tij | Diskutim, Di/Dua të di/Mësova, shkrim i lirë. | Vlerësim nga diskutimi, lista e kontrollit. | Karl Grimberg, "Historia Botërore dhe Qytetërimi", materiale nga Interneti, You |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | karakterizohet nga më të suksesshmet në të gjitha drejtimet. | | | tube, dokumenta historikë etj. |
| 62. | | 2.40. Shpërbërja e Perandorisë Osmane. Krijimi i shtetit të pavarur në Bullgari | Vasil Leski dhe Kristo Botev: Dy figurat kryesore në shpalljen e pavarësisë së Bullgarisë. Ata hodhën idenë se vetëm nëpërmjet luftës së armatosur, do të mundësohej çlirimi i vendit. Si e komentoni ju idenë e tyre? | Diskutim, Di/Dua të di/Mësova | Vlerësim nga diskutimi, vlerësim i detyrave të dhëna. | Karl Grimberg, "Historia Botërore dhe Qytetërimi", materiale nga Interneti, You tube, dokumenta historikë etj. |
| 63. | | 2.41. Shpërbërja e Perandorisë Osmane.Krijim i i shtetit të pavarur rumun. | Tudor Vladimiresku Aleksandër Ipsilanti udhëhoqën luftën e popullit rumun për pavarësi. Tudor Vladimiresku udhëhoqi kryengritjen në principatën e Vllahisë, ndërsa Aleksandër Ipsilanti udhëhoqi kryengritjen në Moldavi. Të dy udhëheqësit nuk i kordinuan veprimet e tyre dhe të bashkoheshin. Kjo i ndihmoi turqit që t'i shtypnin kryengritjet dhe të vendosnin kontrollin në të dy krahinat. | Stuhi mendimesh,diskutim, Di/Dua të di/Mësova | Vlerësim nga diskutimi, loja me role dhe lista e kontrollit. | Karl Grimberg, "Historia Botërore dhe Qytetërimi", materiale nga Interneti, You tube, dokumenta historikë etj. |
| 64. | | 2.42. Shpërbërja e Perandorisë Osmane. Krijimi i shteteve nacionale në Maqedoni, BosnjëT Hercegovine, Malin e Zi | Maqedonia, BosnjëT Hercegovina dhe Mali Zi, ishin territore të prapambetura. Për rrjedhojë dhe procesi i formimit të shteteve kombëtare do të ishte i mëvonshëm dhe i vështirë. Maqedonia nuk arriti ta krijonte shtetin e pavarur. BosnjëTHercegovina u vu nën kontrollin e perandorisë Habsburgase. Malit të Zi iu njoh pavarësia nga Kongresi i Berlinit. | Punë në grupe, Diagrami i Venit | Vlerësim nga puna në grupe dhe plotësimi i Diagramit të Venit. | Karl Grimberg,"Historia Botërore dhe Qytetërimi", materiale nga Interneti, You tube, dokumenta historikë etj. |
| 65. | | 2.43.Projekt. "Kërkime mbi historikun e shkollave të para shqipe" ( 2 orë) | Shkolla e parë shqipe në Korçë u hap më 7 mars 1887. Ajo u pasua edhe nga shkolla të tjera. Qeveria e Vlorës e 28 nëntor 1912 mori vendim për hapjen e shkollave shqipe në të gjithë Shqipërinë. | Prezantim, punë në grupe, diskutimi që zgjidh problemin. | Vlerësim individual i nxënësve, vlerësim nga diskutimet. | Historia 7, Historia e Popullit Shqiptar, materiale nga Interneti, fotografi të shkollave shqipe, të mësuesve të |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | parë. |
| 66. | | 2.44.Projekt. “Kërkime mbi historikun e shkollave të para shqipe” | Shkolla e parë shqipe në Korçë u hap më 7 mars 1887. Ajo u pasua edhe nga shkolla të tjera. Qeveria e Vlorës e 28 nëntor 1912 mori vendim për hapjen e shkollave shqipe në të gjithë Shqipërinë. | Prezantim, punë në grupe, diskutimi që zgjidh problemin. | Vlerësim individual i nxënësve, vlerësim nga diskutimet. | Historia 7, Historia e Popullit Shqiptar, materiale nga Interneti, fotografi të shkollave shqipe, të mësuesve të parë. |
| 67. | | 2.45. Veprimtari praktike:Ese argumentuese: Shqipëria në vitet 1912Ͳ 1913. | “Në Vlonë më 15/28 të Vjeshtës së Tretë: Pas fjalëve që tha z. Kryetar Ismail Kemal beu me të cilat tregoi rrezikun e math në të cilin ndodhet sot Shqipëria, të gjithë delegatët me një za venduan që Shqipëria më sot të bahet në vehte, e lirë e e mosvarme. | Punë me grupe, grupet e ekspertëve, diskutim | Vlerësim i drejtpërdrejtë, vlerësim individual. | Historia 7, Historia e Popullit Shqiptar, materiale nga Interneti, fotografi të shpalljes së pavarësisë, Konferencës së Ambasadorëve në Londër. |
| 68. | | 2.46 Veprimtari praktike: Përpjekjet e figurave dhe e patriotëve shqiptarë për shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë. | Shqiptarët u përgatitën për kryengritjen e vitit 1912 dhe përhapjen e saj në të gjitha vilajetet shqiptare. Marrëveshja e Prishtinës dhe Kuvendi i Vlorës bashkoi shqiptarët kundër Perandorisë Osmane, shteteve ballkanike dhe herë herë dhe Fuqive të Mëdha. | Punë me grupe, grupet e ekspertëve, diskutim | Vlerësim i drejtpërdrejtë, vlerësim individual. | Historia 7, Historia e Popullit Shqiptar, materiale nga Interneti, fotografi të shpalljes së pavarësisë, Konferencës së Ambasadorëve në Londër. |
| 69. | | 2.47. Përsëritje(5) Temat 2.32Ͳ 2.46 | Nxënësi përsërit temat 2.32Ͳ2.46. Fisha dhe kuize. Nxënësit japin përgjigje pyetjeve dhe dikutojnë rreth tyre. | Punë individuale, zgjidhja e problemit. | Vrojtimet e mësuesit, lista e kontrollit. | Teksti Historia 7, materiale nga Interneti |
| 70. | | 2.48. Test (3) mbi temat 2.24Ͳ2.46 | Punë e parapërgatitur nga mësuesi | Test me grupe. | Vlerësim me shkrim | Teksti |

## 10 ORË MËSIMI MODEL

**Planifikimi ditor**

**Fusha: Histori**

**Lënda: Histori**

**Shkalla:3**

**Klasa:7**

**Tematika 1: Qytetërimet në fillimet e Historisë Moderne**

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi.** | **Lënda: Histori** | **Shkalla: III** | **Klasa: VII** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore 1.1** Humanizmi | **Situata e të nxënit:** Periudha mesjetare fetare, mbizotërimi i botkuptimit fetar në të gjitha fushat. Vlerësim i botës qiellore dhe mënjanim i asaj tokësore. |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>x përcakton kushtet historike që çuan në lindjen e Humanizmit;<br>x rendit tiparet e Humanizmit;<br>x Identifikon përfqësuesit kryesorë të humanizmit. | **Fjalët kyç**: humanizëm, liria e ndërgjegjes. |
| **Burimet:** Interneti, teksti, fjalor, humanistë të shek: XIIITXVI | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare:** Letërsia, Artet, Shkencat shoqërore. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** stuhi mendimesh, punë në grup, diskutim, të nxënët në bashkëpunim.

**Organizimi i orës së mësimit:**

- Nxënësit punojnë në grupe duke vëzhguar dhe diskutuar për fotografitë e periudhës mesjetare.
- Cili botëkuptim mbizotëronte?
- Po fotografitë e tjera të periudhës së Humanizmit nga ndryshojnë nga ato mesjetare fetare?
- Përse në qendër të studimeve u vu njeriu dhe bota e tij shpirtërore?
- Përse kjo periudhë u quajt Humanizëm? Ç'tipare kishte Humanizmi?
- Cilët ishin Humanistët e parë?







*Kompetencat që përfitojnë: kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, digjitale si dhe komptenca e të nxënit*.

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen nga krahasimet që i bëjnë periudhës mesjetare fetare me atë humaniste, diskutimeve dhe argumentave që sjellin gjatë vlerësimit të dy periudhave historike dhe dallimet midis botkuptimit mesjetar fetar dhe humanist.

**Detyrat dhe puna e pavarur:** Lundroni në faqen e internetit për të njohur Humanizmin dhe humanistët e parë.

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori</td><td>Shkalla: III</td><td>Klasa: VII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore 1.2 Rilindja europiane</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:<br>Në klasë: Qytetet italiane të shek. XVTXVI . Zhvillimin ekonomik dhe artistik të shek XV. Lidhje me kulturën e lashtë grekoTromake. Njohje me Rilindësit e parë dhe ndryshimet socialTkulturore që solli ajo.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:<br>x përshkruan kushtet historike që kushtëzuan fillimin e Rilindjes europiane;<br>x evidenton arsyet e shndërrimeve të qyteteve në djepin e qytetërimit modern europian;<br>x përcakton rolin e shtypshkronjës në zhvillimin e Rilindjes.</td><td colspan="2">Fjalët kyç: Rilindja, qytetet italiane, kultura grekoT romake.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: fotografi nga Interneti, teksti, fjalor.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare:<br>Letërsia, Artet, Shkencat shoqërore.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: brainstorming , diskutim, krahasim, kllaster.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit:<br>• Punoni në grupe duke vëzhguar dhe diskutuar për fotografitë e qyteteve italiane të shek. XV.<br>• Përse qytetet italiane arritën të zhvilloheshin shumë ekonomikisht?<br>• A ndikoi ky zhvillim në ndryshimin e mënyrës së tyre të jetesës dhe në zhvillimin e artit dhe kulturës? Si?<br>• Përse në qendër të studimeve u vu njeriu , natyra dhe kultura e lashtë grekoTromake?<br>• Përse kjo periudhë u quajt Rilindje? Ç’tipare kishte Rilindja Europiane?<br>• A ka lidhje me Humanizmin? Cilët ishin Rilindësit e parë?<br>Kompetencat që përfitojnë: kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, e të nxënit, digjitale si dhe kompetenca personale.<br><br>Shtypshkronja e Johan Gutenberg</td></tr>
<tr><td colspan="4">Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për diskutimet dhe krahasimet midis periudhave, lidhjeve shkakTpasojë.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Detyrat dhe puna e pavarur: Lundroni në faqen e internetit për të njohur Rilindjen dhe Rilindësit e parë.</td></tr>
</table>

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkalla: III** | **Klasa: VII** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore 1.3** Humanistët shqiptarë | **Situata e të nxënit:**<br>Libri parë i shkruar në gjuhën shqipe është "Meshari" i Gjon Buzukut. Origjinali këtij libri është ruajtur për 500 vjet në bibliotekën e Vatikanit dhe vazhdon të ruhet edhe sot. |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>x përcakton tematikën e veprave që krijuan humanistët shqiptarë;<br>x gjykon mbi motivet që i shtynë humanistët shqiptarë të vinin në qendër të veprave të tyre figurën legjendare të Gjergj Kastriot Skënderbeut;<br>x Identifikon elementët e përbashkëta mes humanizmit shqiptar dhe atij europian. | **Fjalët kyç**:<br>Humanistë shqiptarë, Marin Barleti, Dhimitër Frëngu, Pal Egjëlli, Gjon Buzuku |
| **Burimet:** teksti Historia 7, Historia e Shqipërisë, fotografi nga internet për humanistët shqiptarë. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare:**<br>Shkencat shoqërore, Shkencat Natyrore, Letërsia, Gjeografia, Filozofia. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Mësimdhënie e drejtpërdrejtë, lojë me role, diskutim.

**Organizimi i orës së mësimit.**

- Mësuesi, pasi nxënësit kanë lexuar tekstin, e vë gjithësecilin në rolin e një humanisti shqiptar. Nxënësi rilexon materialin që ka teksti si dhe përdor informacione që ka marë në të shkuarën për ta nga letërsia, interneti etj.
- A kanë qenë të njohur këta humanistë në Europë? A kanë patur lidhje me humanistët Europianë?
- Cila ka qenë koha kur vepruan ata? Po Humanistët në Europë në ç'kohë vepruan?
- Cila është rëndësia e tyre në historinë e popullit shqiptar?
- Cila është tematika e veprave të humanistëve shqiptarë? Përse është kjo tematikë?
- Ç'zgjidhje sugjeronin humanistët shqiptarë për të dalë nga kjo situatë që ata trajtonin?
- Cila është gjuha që përdorën ata në veprat e tyre? (çdo humanist – një rol)





Portreti i Marin Barletit

*Komptencat që përfitojnë: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit, komptenca e të menduarit si dhe ajo personale.*

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për lojën në rolin e një humanisti shqiptar, diskutimet për pyetjet dhe mendimet që shprehte mësuesi.

**Detyrat dhe puna e pavarur:** Ese: Heroi ynë kombëtar "Skënderbeu" dhe humanistët shqiptarë.

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** Dt.___/____/__

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi.</td><td>Lënda: Histori.</td><td>Shkalla: III</td><td>Klasa: VII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore 1.4 Veprimtari praktike (1)<br><br>Kontributi i humanisteve shqiptare në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare<br><br>Vizitë në muze</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:<br>Humanizmi në Shqipëri eci paralelisht me humanizmin në Evropë.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:<br><br>x identifikon figurat më të rëndësishme të humanizmit shqiptar;<br><br>x përcakton kontributin e tyre në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare.</td><td colspan="2">Fjalët kyç:<br>Humanistë shqiptarë, Marin Barleti, Dhimitër Frëngu, Pal Egjëlli, Gjon Buzuku</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:<br>Historia e Popullit Shqiptar, materiale nga Interneti.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare:<br>Shkencat shoqërore, TIK, Letërsi, Gjeografi.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve. Punë në grupe, punë me të gjithë klasën.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit:<br><u>Hapi i parë: </u>(përgatitore) Me rekomandimin e mësuesit/es, nxënësit përsëritin disa çështje të materialit mësimor si p.sh.:<br>– Ç'është Humanizmi. Cilët janë disa nga humanistët më të shquar shqiptarë? Cili është kontributi i tyre ne shkallë kombëtare? Cili është kontributi në shkallë ndërkombëtare?<br><u>Hapi i dytë:</u> Ndarja e klasës në grupe për zhvillimin e veprimtarisë. Grupi I – Organizon udhëtimin dhe bën prenotimin në muze (me ndihmën e mësuesit/es). Grupi IIͲ Mbledh të dhëna për kontributin e humanistëve shqiptarë në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare.<br>Grupi IIIͲ Me fotografi të humanistëve të nxjerra nga interneti, ose vizatime, portrete të bërë nga vetë nxënësit bëjnë postera, fletëpalosje etj.<br>Grupi IV – Fotografët e vegjël. Gjatë vizitës në muze bëjnë fotografi dhe i vendosin në një ekspozitë në klasë.<br><u>Hapi i tretë: </u>Sistemimi i materialeve të nxjerra nga Internet në postera, fletëpalosje, PowerPoint.<br><u>Hapi i katërt: </u>Diskutim mësuesͲnxënës për rezultatet e veprimtarisë. Kompetencat që përfitojnë: kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, e të menduarit si dhe komptenca e të nxënit.<br><br></td></tr>
<tr><td colspan="4">Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për punën individuale dhe në grup për përgatitjen e projektit.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Detyrat dhe puna e pavarur: Ese: Vepra e Marin Barletit, jehonë dhe realitet në histori.</td></tr>
</table>

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori | Shkalla: III | Klasa: VII |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore 1.5** Europa drejt njohjes së "Botës së Re" | | **Situata e të nxënit:** *A e dini se, deri në shek. XV, kontinentet, si: Amerika Veriore, Amerika Jugore, Oqeania dhe pjesa më e madhe e Afrikës nuk njiheshin nga europianët.* | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>x përshkruan rrethanat që ndikuan në zbulimet e mëdha gjeografike;<br>x tregon në hartë rrugën që ndoqën lundërtarët evropianë në kërkim të Botës së Re;<br>x gjykon mbi rolin që luajtën perfeksionimet teknike në fushën e lundrimit detar në realizimin e zbulimevetë mëdha gjeografike. | | **Fjalët kyç**: "Bota e Re", ekspeditë, karavela, astrolab, busull | |
| **Burimet:** fotografi nga interneti, teksti, hartë e Perandorisë Osmane, CDTUSB | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare:** Gjeografia, Shkencat shoqërore. | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** punë në grup, brainstorming, tabela e koncepteve, diskutim. | | | |
| Organizimi i orës së mësimit.<br>- Nxënësve u jepet një fakt: Perandoria Osmane kishte bllokuar rrugët tregtare për në Indi të tregtarëve evropianë.<br>- Më pas vjen pyetja: Ju si do të vepronit për të furnizuar Evropën me mallra nga India?<br>- Fakt: Portugalia dhe Spanja kishin dalje te gjerë në Oqeanin Atlantik. A do ndikonte kjo dalje në zbulimin e rrugëve të reja tregtare detare?<br>- Nxënësit punojnë në grupe me 5T6 veta. Lundërtarët e parë. Rrugë që përshkuan ata. Vendet që zbuluan. Pajisjet që ndihmuan lundrimin e tyre.<br>- Cili lundërtar zbuloi kontinentin Amerikan? Cili vërtetoi që Toka është e rrumbullakët?<br>- Plotësohet tabela e koncepteve "Bota e Re"<br><br>*Kompetencat që përfitojnë: kompetenca digjitale, e komunikimit dhe të shprehurit, si dhe kompetenca personale.* | | | |
| **Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për punën në grupe, mendimet që japin si dhe për përgjigjet e pyetjeve nga ana e mësuesit, plotësimi i tabelës së koncepteve. | | | |
| **Detyrat dhe puna e pavarur:** Skiconi në hartën e botës rrugët detare të lundëtarëve të mëdhenj. | | | |

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori | Shkalla: III | Klasa: VII |
|---|---|---|---|

**Tema mësimore 1.6** Ndikimi i zbulimeve gjeografike në kulturën dhe shkencën e kohës

**Situata e të nxënit:** Nëpërmjet tabelës së mëposhtme u kërkohet nxënësve të identifikojnë prodhimet që erdhën nga Amerika në Evropë dhe anasjelltas.

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**

- x përcakton rrethanat e krijimit të kolonive;
- x dallon ndryshimet e mëdha që ndodhën në Europë si rrjedhojë e zbulimeve gjeografike;
- x gjykon mbi ndikimin e "revolucionit të çmimeve" në ndryshimin e strukturës së shoqërisë europiane.

**Fjalët kyç**: Koloni, Shtete koloniale, "Revolucioni i çmimeve", "Bota e Re"




**Burimet:** fotografi nga Interneti, teksti, fjalor, hartë e pushtimeve koloniale, hartë e qytetërimeve Maja, Acteke, Inkase, CDTUSB

**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare:** Gjeografia, Shkencat shoqërore.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Punë në dyshe, harta e mendjes, diskutim.

**Organizimi i orës së mësimit:**



- Nxënësve u jepet një fakt: Në Kontinentin Amerikan kishte popuj dhe qytetërime vendase. Majat, Actekët dhe Inkasit. A e pranuan ata kolonizimin evropian?
- Më pas vjen pyetja: Ju si do të vepronit për të furnizuar Evropën me mallra nga vendet e zbuluara? Si do silleshit me banorët vendas?
- Nxënësit punojnë në dyshe për vendet e kolonizuara nga Portugalia, të tjerë nga Spanja, e në vijim nga Anglia, Franca, Holanda etj
- Çfarë morën dhe çfarë eksportuan në Amerikë, Afrikë, Australi etj ?
- Plotësojnë hartën e mendjes.
- Rrjedhojat ekonomike të zbulimeve të mëdha gjeografike ishin: Qendrat tregtare u zhvendosën nga Mesdheu në Atlantik, "Revolucioni i çmimeve", Shkëmbimi i kulturave bujqësore.
- Rrjedhojat sociale: U krijuan shtresat e reja, u shkatërruan qytetërimet vendase amerikane, u morën skllevër zezakë nga Afrika.






*Kompetencat që përfitojnë: kompetenca digjitale, e komunikimit dhe të shprehurit, e të menduarit si dhe kompetenca personale.*

**Vlerësimi:** Vlerësim i punës në çift, plotësimi i tabelës së koncepteve.

**Detyrat dhe puna e pavarur:** Skiconi hartën koloniale të krijuar nga zbulimet e mëdha gjeografike.

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori | Shkalla: III | Klasa: VII |
|---|---|---|---|
| **1.9 – 1.10 Projekt (Film e diskutim) (1, 2):**<br>"Marko Polo – Roli i Marko Polos në lidhjen e Evropës me Kinën".<br>*Shikimi i organizuar i një filmi/dokumentari Shoqërohet dhe me CD.* | | **Situata e të nxënit:**<br>Eksploruesit e guximshëm si Marko Polo ishin frymëzuesit e zbulimeve të mëdha gjeografike, krijimit të kolonive, hovit të zhvillimit ekonomik të vendeve të Evropës Perëndimore. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>x vlerëson rolin e Marko Polos në shkëmbimin e kulturave midis Evropës dhe Kinës;<br>x përshkruan kontributin e tij si frymëzues i zbulimeve të "Botës së Re". | | **Fjalët kyç**:<br>Kina, Marko Polo, Europa, zbulimet e mëdha gjeografike. | |
| **Burimet:**<br>Internet, katalogje, fotografi të ndryshme, CDTUSB. | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare:**<br>Gjeografia, Letërsia. | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Prezantim, punë në grupe, diskutimi që zgjidh problemin. | | | |
| **Organizimi i orës së mësimit:**<br>- Me rekomandimin e mesuesit/es, nxënësit lexojnë pjesën "Lexim i orientuar" për të krijuarnjë ide se kush ishte Marko Polo<br>- Shikimi i organizuar i filmit<br>- Ndarja e klasës në grupe me 4T5 persona. Secili grup pasi ka parë materialet filmike iu përgjigjet pyetjeve:<br>- *Kush ishte Marko Polo?*<br>- *Cilat ishin vendet që ai vizitoi?*<br>- *Çfarë roli pati Marko Polo në shkëmbimin e kulturave midis Kinës dhe Europës?*<br>- *Cili ishte roli i tij si frymëzues i zbulimeve të mëdha gjeografike?*<br>- Diskutim mësuesTnxënës për ndikimin e Marko Polos në zbulimet e mëdha gjeografike.<br><br>*Kompetencat që përfitojnë: kompetenca digjitale, e komunikimit dhe të shprehurit, e të menduarit si dhe kompetenca e të nxënit.* | | | |
| **Vlerësimi:** Vlerësim individual i nxënësve, vlerësim nga diskutimet. | | | |
| **Detyrat dhe puna e pavarur:** Eksplorues si Marko Polo jam edhe unë– detyrë kërkimore individuale. | | | |

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori | Shkalla: III | Klasa: VII |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore 1.11** Përsëritje Mësimi 1T10 | **Situata e të nxënit:**<br>Fisha dhe kuize. Nxënësit japin përgjigje pyetjeve dhe dikutojnë rreth tyre. |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>x kuptojnë, zhvillojnë dhe ndërtojnë kompetencat dhe konceptet historike mbi temat 1T10;<br>x aftësohen për t`i përdorur ato në mënyrë që të thellojnë; zgjerojnë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat e tyre në lëndën e historisë, duke arritur progres. | **Fjalët kyç**:<br>Humanizëm, Rilindje, Zbulime gjeografike, “Bota e Re”, Koloni, Revolucioni i çmimeve, Marko Polo, India, Kina. |
| **Burimet:**<br>teksti Historia 7, Karl Grimberg, “Historia Botërore dhe Qytetërimi”, materiale nga Interneti, fotografi dhe harta të përdorur në temat 1T8 | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare:**<br>Gjuhët dhe komunikimi, Gjeografia, Shkencat shoqërore. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** punë individuale

**Organizimi i orës së mësimit:**

- Nxënësve iu shpërndahen fisha të përgatitura nga mësuesi/ja dhe ata punojnë për përgjigjet e sakta dhe më pas diskutojnë në klasë përgjigjet e tyre.
- Në fisha mësuesi duhet të ketë kujdes që të jenë të përfaqësuara të gjitha fjalët kyç, temat mësimore, përmbushja e kompetencave të fushës sipas temës.
- Humanizmi, Rilindja, Humanistët shqiptarë, Kontributi i Humanistëve shqiptarë në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare, Europa drejt njohjes së “Botës së Re”; Ndikimi i zbulimeve gjeografike në kulturën dhe shkencën e kohës, Marko Polo, Zbulimi i kontinentit Afrikan, Zbulimi i Australisë.

*Kompetencat që përfitojnë*: kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, kompetenca e të nxënit, kompetenca personale dhe kompetenca e të menduarit.

**Vlerësimi:** vetvlerësim, vlerësim i portofolit.

**Detyrat dhe puna e pavarur:** Hulumtim në internet për zbulimin e Afrikës dhe Australisë.

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori | Shkalla: III | Klasa: VII |
|---|---|---|---|

**Tema mësimore** 1.12 Ndryshimet fetare në Evropë

**Situata e të nxënit:** Në mesjetë Kisha u shiste besimtarëve disa letra me vulën e Papës që quheshin *indulgjenca.* Ata u thoshin besimtarëve se sapo monedha të tingëllojë në arkë, mëkatet shlyhen, shpirti pastrohet dhe shkon në qiell. Por a kishte mendime që e kundërshtonin këtë veprim?

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**

- x rendit shkaqet e rënies së autoritetit të Kishës;
- x përshkruan jetën dhe veprimtarinë reformatore të Martin Luterit;
- x përcakton shkaqet dhe rrjedhojat e luftës së ashpër midis katolikëve dhe protestantëve në Gjermani.

**Fjalët kyç**: Indulgjencë, Reformacion, Martin Luteri, Protestant, Kisha Luteriane



**Burimet:** teksti Historia 7, Karl Grimberg, "Historia Botërore dhe Qytetërimi", materiale nga interneti, fotografi të Martin Luterit, të indulgjencave, inkuizicioneve.

**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare:** Shkencat shoqërore

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Shpjegimi, shkakTpasojë, diskutim, kllaster

**Organizimi i orës së mësimit:**

- Mësuesi shpjegon termin indulgjencë, reformë, reformë fetare dhe pyet nxënësit nëse janë dakort me to. Ku i përdorte Kisha katolike paratë e indulgjencave? A duhej reformuar kjo mendësi fetare?
- Shkaku = indulgjencat, persekutimet fetare. Pasojat = reforma fetare, thyerja e unitetit fetar në Europën katolike – protestantizëm (luteranizëm)
- Cilat ishin parimet e Martin Luterit? Nxënësit kanë lexuar tekstin dhe përgjigjen për disa nga 95 tezat e Luterit.
- Nxënësit plotësojnë së bashku me mësuesin kllasterin: Kisha katolike, Martin Luteri.
- A do e pranonte kisha katolike reformimin? Patjetër që jo.
- Në Gjermani ekzistonin dy grupime mbështetësish: Perandori Karli V që mbështeste Papën e Romës (kalorësit) dhe princat gjermanë që mbështetnin Martin Luterin (fshatarësia). Fitorja e princave gjermanë bëri që në Gjermani të përhapej besimi luteran.




*– Kompetencat që përfitojnë: kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, kompetenca e të nxënit, kompetenca personale, kompetenca e të menduarit, kompetenca për jetën.*

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për lidhjen shkakTpasojë, plotësimin e kllasterit dhe për mendimet e tyre gjatë diskutimit.

**Detyrat dhe puna e pavarur:** Krahasoni idetë e Luterit me ato të kishës katolike

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** Dt.___/____/__

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori | Shkalla: III | Klasa: VII |
|---|---|---|---|

**Tema mësimore** 1.13
Përhapja e Protestantizmit

**Situata e të nxënit:** Uniteti fetar në Evropë u thye. Edhe fisnikët anglezë donin të merrnin në zotërim pronat e kishës katolike. Ata u ndihmuan nga mbreti dhe parlamenti anglez. Zvicra ishte e indinjuar nga veprimet e kishës katolike. Kalvini ishte reformatori kryesor. Protestantizmi gjeti mbështetje në Francë, Vendet e Ulëta, Skoci, Poloni, Çeki dhe Hungari.

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**
x shpjegon veçoritë e reformacionit në Angli dhe në Zvicër;
x analizon Kalvinizmin dhe shkaqet e përhapjes së tij;
x Identifikon shtetet europiane në të cilat u përhap protestantizmi;

**Fjalët kyç**: Ligji i supremacisë, Anglikane, Presbiterianët, Kalvinizëm, Hygenotë.



**Burimet:** teksti Historia 7, Karl Grimberg "Historia Botërore dhe Qytetërimi", materiale nga interneti, fotografi të Martin Luterit, Zhan Kalvinit, Henrikut VIII.

**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare:** Shkencat shoqërore, Gjeografia.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Bashkëbisedim, harta e mendjes, punë individuale me hartën

**Organizimi i orës së mësimit:**
- Mësuesi drejton pyetjen dhe bashkëbisedon me nxënësit pasi ata kanë lexuar tekstin:
- Në cilat vende të tjera të Evropës u perhap protestantizmi? Në Angli, Vendet e Ulëta, Zvicër, Francë, Danimarkë, Vendet Skandinave.
- Cilat ishin veçoritë e protestantizmit në Angli? Parlamenti miratoi "ligjin e supermacisë" ku drejtuesi i kishës anglikane ishte mbreti.
- Cilat ishin veçoritë e protestantizmit në Zvicër? Zhan Kalvini hodhi 3 ide: a. Parapërcaktimi i fatit; b. Familja dhe puna janë të shenjta; c. Kurse për të investuar.
- Po në vendet e tjera të Evropës? Në Francë u bënë luftëra midis katolikëve dhe hygenotëve. Në Vendet e Ulëta protestantizmi u bën nxitje të luftës për liri e pavarësi kundër sundimit të Spanjës Katolike. Në Skoci shikohej si fe demokratike.
- Nxënësit bëjnë punë individuale me hartën e mendjes.




*Kompetencat që përfitojnë: kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, kompetenca e të menduarit, kompetenca e të nxënit, kompetenca personale, kompetenca qytetare.*




**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për bashkëbisedimin dhe krijimin e hartës individuale të mendjes.

**Detyrat dhe puna e pavarur:** Në hartën e Evropës ngjyrosni vendet ku u përhap protestantizmi.

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda Histori</td><td>Shkalla: III</td><td>Klasa: VII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore 1.14 Reformacioni katolik ose kundërreforma</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Besimi te Kisha Katolike dhe Papa i Romës ishte në nivelet historike nga më të ulëtat. Nevojitej reformim dhe vendimet për këtë i mori Koncili i Trentos dhe i zbatoi Urdhëri i Jezuitëve.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:<br>x përcakon motivet që i shtynë drejtuesit e Kishës Katolike të pranonin reformimin e saj;<br>x evidenton rolin e urdhrave fetarë në reformimin e Kishës Katolike;<br>x analizon përmbajtjen e Koncilit të Trentos.</td><td colspan="2">Fjalët kyç:<br>Kundërrefomë, Urdhri i Jezuitëve, Koncili i Trentos, Inkuizicion.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: teksti Historia 7, Karl Grimberg, “Historia Botërore dhe Qytetërimi”, materiale nga interneti, fotografi e Koncilit të Trentos, fotografi ikuizicioni, fotografi të Injac Lojolës.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare:<br>Shkencat shoqërore</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Parashikimi me terma paraprakë, krahasim, shpjegim.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit:<br>
➧ Në fillim mësuesi tregon 2 fotografi të Luterit dhe të hartës së përhapjes së protestantizmit. Ç’lidhje ka midis tyre?<br>
➧ Më pas tregon fotografi të Këshillit të Trentos dhe të një Kishe Katolike. Po tani a ka lidhje midis fotografive? Po midis 2 fotografive të para dhe 2 fotografive të dyta a ka lidhje?<br>
➧ Rikujton tezat e Luterit dhe nxit nxënësit të mendojnë për kundërveprimin e kishës katolike.<br>
➧ Papa ishte autoriteti më i lartë i kishës katolike.<br>
➧ Vetëm kisha mund ta shpjegonte fjalën e Zotit, Biblën.<br>
➧ Të vendosej një disiplinë e rreptë dhe të ndalohej shthurja e klerit.<br>
➧ Peshkopët, priftërinjtë duhet të hiqnin dorë nga luksi dhe pasuria dhe tu shërbenin besimtarëve.<br>
➧ Urdhëri i Jezuitëve riktheu besimin katolik në një pjesë të vendeve që e kishin mohuar atë.<br>
<br>
Injac Lojola merr nga Papa Pali III Urdhërin<br>
<br>
<br>
Kompetencat që përfitojnë: kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, kompetenca e të menduarit dhe kompetenca e të nxënit.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për dallimet dhe ngjajshmëritë midis 2 besimeve fetare dhe pjesëmarrjen në dhënien e mendimeve.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Detyrat dhe puna e pavarur: Krahasoni tezat e Luterit me vendimet e Koncilit të Trentos.</td></tr>
</table>

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori | Shkalla: III | Klasa: VII |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore 1.15**<br>Perandoria Osmane dhe Europa | **Situata e të nxënit:**<br>Sulejmani i Madhërishëm ishte një nga sulltanët më të mëdhenj turq. Sundoi në vitet 1520T1566. Gjatë sundimit të tij Perandoria Osmane arriti kulmin e saj. |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>x përcakton shkaqet e zgjerimit dhe të fuqizimit të Perandorisë Osmane;<br>x evidenton faktorët që sollën fundin e zgjerimit;<br>x rendit shkaqet e krizës në Perandorinë Osmane. | **Fjalët kyç**:<br>Sulejmani I, Xhamia e Sulejmanit, Arkitekt Sinani, Anarki, Kanune. |
| **Burimet:**<br>teksti Historia 7, Karl Grimberg, "Historia Botërore dhe Qytetërimi", materiale nga interneti, you tube, fotografi të Sulejmanit të Madhërishëm, Arkitekt Sinanit. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare:**<br>Shkencat shoqërore, Letërsia, Gjeografia. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Diskutim, lojë me role, krahasim.

**Organizimi i orës së mësimit:**

- Pasi nxënësit kanë lexuar mësimin mësuesi ngre përpara 3 nxënës duke ju caktuar nga një rol dhe duke iu drejtuar disa pyetje:
- Nxënësi 1: Komandant ushtarak i Sulejmanit të Madhërishëm. Në cilët kontinente është shpërndarë ushtria juaj? Cilët kombe bëjnë pjesë në Perandorinë Osmane? Ku përdoren pasuritë që u grabisni popujve? Po skllevërit çfarë punësh bëjnë? A ju pëlqen të jetoni në kryeqytet (Stamboll) apo të drejtoni ushtrinë në vilajetet e Perandorisë?
- Nxënësi 2: Komandant ushtarak i ushtrisë osmane në betejat e Vjenës dhe me Rusinë. Përse humbët në dyert e Vjenës? Përse kundërshtari më i rrezikshëm i osmanëve u bë Rusia? A dha rezultat aleanca me Francën? Po nëse do të kishit bërë aleancë me Gjermaninë, Anglinë do të kishit rezultate më pozitive?
- Nxënësi 3: Perandor i Perandorisë Osmane gjatë shek XVIIITXIX. Ju po drejtoni perandorinë por ne shikojmë tkurrjen e kufijve. Përse po ndodh kjo gjë? Çfarë duhet të ndryshoni sa pa qenë vonë?
- Edhe nxënësit e tjerë marin pjesë në përgjigjet e pyetjeve që bën mësuesi, si dhe korrigjojnë përgjigjet e 3 nxënësve që luajnë rolet.



*Kompetencat që përfitojnë: kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, kompetenca e të menduarit, kompetenca e të nxënit, kompetenca digjitale.*

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për luajtjen e roleve, diskutimet, krahasimet midis zgjerimit, rrudhosjes dhe rënies së Perandorisë Osmane.

**Detyrat dhe puna e pavarur:** Skiconi hartën e Perandorisë Osmane deri në mesin e shek. XVII. You tube: Sulejmani i Madhërishëm.

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori</td><td>Shkalla: III</td><td>Klasa: VII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore 1.16 Shoqëria, arti dhe kultura në shekujt XVI-XVII<br></td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Kostanca u akuzua si shtrigë në fund të shek. XVI në Toskanë. Vajza e një fiorentinasi të pasur dhe një shërbëtoreje. Mblidhte bimë me efekte shëruese dhe i kthente në barna. Por fuqia e saj shëruese u bë e rrezikshme, sepse shumë mendonin që ishte një shtrigë. Pasi u torturua, Kostanca u largua nga qyteti i saj dhe iu ndalua ushtrimi i punës shëruese, gjatë së cilës kishte përfituar përvojë dhe mundësi, të cilat do t'i kishin shërbyer më së miri mjekësisë.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:<br>x përcakton ndryshimet që ndodhën në shoqërinë europiane në shekujt XVI-XVII;<br>x rendit arritjet më të spikatura në shkencë, art dhe kulturë në shekullin XVII.</td><td colspan="2">Fjalët kyç:<br>Revolucioni shkencor<br>"Periudha e artë"<br>Teleskopi<br><br></td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:<br>teksti Historia 7, Karl Grimberg, "Historia Botërore dhe Qytetërimi", materiale nga Interneti, fotografi të Galileo Galileit, Nikolla Kopernikut, Isak Njutonit, Johan Keplerit, Shekspiri, Molieri, Servantesi etj.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare:<br>Shkencat shoqërore, Artet pamore, Gjeografia, Astronomia, Letërsia, Muzika.<br></td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Mësimdhënie e drejtpërdrejtë, lojë me role.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit:<br>▸ Mësuesi, pasi nxënësit kanë lexuar tekstin, u bën një pyetje të tillë: A ndikon zhvillimi ekonomik në zhvillimin e shoqërisë, artit dhe kulturës? Si ndikon ai? Cilët shtete Europiane ishin më shumë të zhvilluar dhe cilët jo?<br>▸ Zhvillimi i Anglisë dhe Holandës, kriza e thellë në Itali, Spanjë, Gjermaninë e Jugut, Poloni.<br>▸ Fuqizimi ekonomik do të ndikonte përkrahjen nga ana e borgjezisë të ideve, teorive dhe shpikjet e reja?<br>▸ Po shpjegimet fetare do të pranoheshin në vazhdimësi?<br>▸ Përse u shqua Galileo Galilei, Nikolla Koperniku, Johan Kepler, Isak Njutoni, Torriçeli, Shekspiri, Molieri, Servantesi, Rembranti etj.<br>▸ A na ndihmojnë akoma dhe sot shpikjet e tyre?<br>▸ Mësuesi parapërgatitet për të realizuar konkretisht me shembuj përfaqësues për pjesën më të madhe të shkencëtarëve, artistëve, muzikantëve si p.sh. molla e Njutonit, teleskopi i Galileit, piktura të Rembrantit. (fotografi)<br>▸ Çdo nxënës përfaqëson një emër artisti, shkrimtari, piktori, astronomi etj dhe flet me 3 fjali për të.<br>Kompetencat që përfitojnë: kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, kompetenca e të menduarit, kompetenca e të nxënit.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për lojën me role duke sintetizuar njohuritë në 3 fjali për çdo emër të madh të artit, kulturës, shkencës.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Detyrat dhe puna e pavarur: Jeta dhe vepra e një përfaqësuesi të artit, kulturës, shkencës në shekujt XVI-XVII.</td></tr>
</table>

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkalla: III** | **Kl sa: VII** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore 1.19 Veprimtari**<br>Toleranca fetare në shoqërinë shqiptare. | **Situata e të nxënit:**<br>Në internet gjenden informacione të shumta për tolerancën fetare në Shqipëri. A munden nxënësit t'i gjejnë ato? A mund të bashkëpunojnë në grup? |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>x përcakton ndryshime fetare në shoqërinë shqiptare.<br>x prezanton raste të tolerancës feta e në Shqipëri. | **Fjalët kyç**:<br>Disa fe, tolerancë fetare institucionale, tolerancë fetare individuale dhe kolektive, kulturë tolerimi. |
| **Burimet:**<br>libri i historisë, Interneti, atalogje, fotografi të ndryshme, udhëzues të ndryshëm, libra historikë etj. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare:**<br>Arti, Kultura, Arsimi, Objektet e kultit, Arkitektura. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxë ësve:** Punë individuale, punë në dyshe, punë në grup.

**Organizimi i orës së mësimit:**

- Me rekomandimin e mësuesit/es, nxënësit më parë kanë përgatitur disa çështje të materialit mësimor që lidhet me temën si p.sh.:
  - Përcaktoni kushtet historike që çuan në ndryshimet në strukturën fetare në Shqipëri.
  - Evidentoni ndryshimet në strukturën fetare të popullit shqiptar.
  - Evidentoni mënyrat e shfaqjes së tolerancës fetare në Shqipëri.
- Ndarja e grupeve dhe e detyrave për secilin grup.
  - Grupi 1T Evidenton kushtet historike që çuan në ndryshimin e strukturës fetare në Shqipëri (Materiale dhe fotografi nga Interneti, albumet, etj).
  - Grupi 2T Evidenton mënyrat e shfaqjes së tolerancës fetare në Shqipëri (Materiale dhe fotografi nga Interneti, albumet, etj).





- Prezantimi i veprimtarisë
- Nxjerrja e përfundimeve
  - Pas përfundimit të punës, nxënësit janë në gjendje të përgatisin albume fotografike, të realizojnë një ese ose tregim të shkurtër për tolerancën fetare si vlerë historike e popullit shqiptar.
- Diskutime dhe vlerësime të veprimtarisë.

*Kompetencat që përfitojnë: kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, kompetenca e të menduarit, kompetenca e të nxënit, kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin, kompetenca qytetare si dhe*

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për punën individuale dhe në grup

**Detyrat dhe puna e pavarur:** Poster shkollor: Toleranca fetare është vlerë kombëtare.

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori</td><td>Shkalla: III</td><td>Klasa: VII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore 1.20 Veprimtari<br>Aspekte të artit, kulturës dhe arsimit në Shqipëri gjatë shekujve XVI<sup></sup>TXVII</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:<br>Në internet gjenden informacione të shumta për artin, kulturën dhe arsimin në Shqipëri gjatë shek. XVITXVII. A munden nxënësit ti gjejnë ato? A mund të bashkëpunojnë në grup?</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:<br>X Përcakton ndryshimet fetare në shoqërinë shqiptare;<br>X prezanton raste të tolerancës fetare në Shqipëri.</td><td colspan="2">Fjalët kyç:<br>Arti, kultura, arsimi, objektet e kultit, arkitektura.<br></td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: historia 7, materiale dhe fotografi nga interneti, katalogje, libra historikë, etj.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare:<br>Tik, Letërsia, Muzika, Vizatimi.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve. Punë individuale, Punë në dyshe, punë në grup.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit:<br>Mësuesi i ka informuar nxënësit më parë për temën e veprimtarisë si dhe për hapat e mëposhtëm:<br>▸ Ndahet klasa në grupe dhe përcaktohen nëntemat për secilin grup.<br>o Zbulo veçoritë e artit në shek. XVI–XVII nëpërmjet veprave të piktorëve Onufri, Shpataraku<br>o Pasqyro karakteristikat kryesore të qyteteve shqiptare gjatë kësaj periudhe.<br>o Pasqyro objektet e kultit kisha, xhami dhe karateristikat e tyre<br>▸ Grupet përzgjedhin materialin e grumbulluar dhe përgatisin posterat për secilën nëntemë<br>▸ Me punët e secilit grup krijohet fotoekspozita ose stenda e trashëgimisë kulturore<br>▸ Nxënësit shënojnë në fletore njohuritë e marra për artin dhe kulturën në shekujt XVI –XVII.<br>Kompetencat që përfitojnë: kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, kompetenca e të menduarit, kompetenca e të nxënit, kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin, kompetenca qytetare si dhe kompetenca digjitale.<br>  </td></tr>
<tr><td colspan="4">Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për stendën më të mirë, punën individuale, në dyshe ose në grup</td></tr>
<tr><td colspan="4">Detyrat dhe puna e pavarur: Cilat janë dallimet midis kishave, xhamive dhe teqeve?</td></tr>
</table>

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori | Shkalla: III | Klasa: VII |
|---|---|---|---|

**Tema mësimore 1.21 Përsëritje II**
Temat 1. 12 – 1.20

**Situata e të nxënit:**
Nxënësi përsërit temat 12 – 20
Fisha dhe kuize. Nxënësit u japin përgjigje pyetjeve dhe dikutojnë rreth tyre.

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**

- zhvillon dhe ndërton kompetencat dhe konceptet historike mbi temat e marra;
- aftësohet për ti përdorur ato në mënyrë që të thellojë, zgjerojë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat në lëndën e Historisë, duke arritur progres.

**Fjalët kyç**:
Protestantizëm, Reformacion, Kalvinizëm, shoqëri tregtare, Perandoria Osmane, Revolucion shkencor, "Periudha e Artë" e letërsisë, islamizim, tolerancë fetare, arkitekturë osmane.

**Burimet:**
teksti Historia 7, Karl Grimberg, "Historia Botërore dhe Qytetërimi", materiale nga Interneti. Përdoren hartat e përhapjes së protestantizmit, Perandorisë Osmane.

**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare:**
Gjuha dhe Komunikimi, Artet pamore, Gjeografia, shkencat shoqerore.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve;** punë individuale.

**Organizimi i orës së mësimit**

- Nxënësve iu shpërndahen fisha të përgatitura nga mësuesi/ja dhe ata punojnë për përgjigjet e sakta dhe më pas diskutojnë në klasë përgjigjet e tyre.
- Në fisha, mësuesi duhet të ketë kujdes që të jenë të përfaqësuara të gjitha fjalët kyç, temat mësimore, përmbushja e kompetencave të fushës sipas temës.
- "Ndryshimet fetare në Europë", "Përhapja e protestantizmit", "Anglia bëhet fuqi e madhe detare", "Reformacioni katolik", "Perandoria Osmane dhe Europa", "Shoqëria, arti dhe kultura në shek. XVI– XVII", "Gjendja fetare e shoqërisë shqiptare gjatë shek. XVI–XVII", "Ndikimi i kulturës osmane në kulturën shqiptare", "Toleranca fetare në shoqërinë shqiptare".

- *Kompetencat që përfitojnë: kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit;kompetenca e të nxënit, kompetenca personale, kompetenca e të menduarit, kompetenca për jetën.*

**Vlerësimi:** vrojtimet e mësuesit, lista e kontrollit.

**Detyrat dhe puna e pavarur:** Ndërtoni një ese përshkruese duke përdorur fjalët: Martin Luter, Gjon Kalvin, Reformacion Katolik, fuqi detare, Perandoria Osmane, feja myslimane, tolerancë fetare.

**TEST (tremujori i parë)**

**Emri e mbiemri_________________________Grupi A**

**1. Pushtoi në Afrikë territore të shumta gjatë periudhës së kolonizimit të saj: 1 pikë**

a. SHBATja
b. Franca
c. Zvicra
d. Greqia

**2. Rilindësit mendonin se jeta e vërtetë ishte ajo: 1 pikë**

a. Qiellore
b. E parajsës
c. E botës së përtejme
d. Tokësore

**3. Nevoja për Zbulimet e Mëdha Gjeografike lindi sepse: 1 pikë**

a. Kristofor Kolombi kishte njohuri për Amerikën
b. Magelani mendonte se Toka qëndronte në kurrizin e disa delfinëve
c. Perandoria Osmane kishte bllokuar rrugët për në Indi
d. Perandoria Osmane i lehtësonte udhëtarët që të shkonin në Indi

**4. Në Betejën e Vjenës (1683), austriakët u ndihmuan nga ushtritë: 1 pikë**

a. polake
b. gjermane
c. turke
d. franceze

**5. E njëjta faltore të premten shërbente për ceremonitë myslimane dhe të dielën për ceremonitë e krishtera. Kjo tregon për shqiptarët se: 1 pikë**

a. Në vendin tonë nuk kishte ndërtesa fetare
b. Në vendin tonë kishte tolerancë fetare
c. Vendi ynë zbatonte këtë urdhër të dhënë nga Perandoria Osmane
d. Njerëzit në këtë mënyrë kursenin duke mos ndërtuar ndërtesë të dytë

**6. "E megjithatë Toka rrotullohet", ishin fjalët e fundit të: 1 pikë**

a. Galileo Galileit
b. Nikolla Kopernikut
c. Isak Njutonit
d. Johan Keplerit

**7. Kontinenti i Australisë u zbulua në fillim nga lundërtarët: 1 pikë**

a. anglezë
b. portugezë
c. holandezë
d. afrikanë

**8. Ligji i supermacisë në Angli nënkuptonte që: 1 pikë**

a. autoriteti më i lartë i Kishës angleze ishte mbreti
b. autoriteti më i lartë i Kishës angleze ishte mbretëresha
c. autoriteti më i lartë i Kishës angleze ishte Papa i Romës
d. Kisha angleze do të mbetej përjetësisht katolike

**9. Jep shpjegimin e fjalëve: 4 pikë**

a. Heretik
……………………………………………………………………………………………………………………………………
b. Rendi feudal
……………………………………………………………………………………………………………………………………
c. Armata e Pathyeshme
……………………………………………………………………………………………………………………………………
d. Procesi i Gardhimit
……………………………………………………………………………………………………………………………………

**10. Shëno e vërtetë (V), e gabuar (G): 5 pikë**

a. Pas Betejës së Vjenës (1683), kundërshtari më i rrezikshëm për Perandorinë Osmane u bë Rusia. (……)
b. Islamizimi i popullsisë u përshpejtua pas vitit 1402 me vendosjen e një detyrimi të veçantë të quajtur "detyrimi në fëmijë". (……)
c. Shitja e indulgjencave rriti më shumë pakënaqësinë ndaj Kishës dhe rëndoi ekonominë e besimtarëve. (……)
d. Kisha Luterane njihet ndryshe si Kisha Protestante. (……)
e. Në Amerikën Qendrore jetonin actekët dhe majat, ndërsa inkët në Amerikën Jugore. (……)

**11. Lidh me shigjetë: 6 pikë**

| | |
|---|---|
| a. Qytetet italiane | Zbulimi i Amerikës (……) |
| b. Filipi II | Qendra të përhapjes së Rilindjes (……) |
| c. Injac Lojola | Amerika Qendrore(……) |
| d. 1492 | Armata e Pathyeshme spanjolle(……) |
| e. Amerika | Rikthente njerëzit e gënjyer në gjirin e Kishës Katolike (……) |
| f. Fiset Maja | Ameriko Vespuçi (……) |

**12.Listo vendimet e Koncilit të Trentos: 4 pikë**

a……………………………………………………………………………………………………………………………………

b……………………………………………………………………………………………………………………………………

c……………………………………………………………………………………………………………………………………

d……………………………………………………………………………………………………………………………………

**13. Cili ishte shkaku i luftërave fetare në Europë? 2 pikë**

a……………………………………………………………………………………………………………………………………

b………………………………………………………………………………………………………………………………………

**14. Listo për zbulimet e mëdha gjeografike nga një shkak: 2 pikë**

a. Ekonomik

………………………………………………………………………………………………………………………………………

b.Teknologjik

………………………………………………………………………………………………………………………………………

| **Notat** | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Pikët** | 0T7 | 8T11 | 12T15 | 16T19 | 20T23 | 24T27 | 28T31 |

**Test (tremujori i parë)**

**Emri e mbiemri______________________** **Grupi B**

**1. Humanistët studiuan kulturën:** **1 pikë**
a. Bullgare
b. Amerikane
c. Ruse dhe japoneze
d.Greke dhe romake

**2. Ishin të parët që hodhën bazat e artit dhe kulturës së Rilindjes:** **1 pikë**
a. Grekët
b. Romakët
c. Italianët
d. Anglezët

**3. Shtetet e para nismëtare të Zbulimeve të Mëdha Gjeografike ishin:** **1 pikë**
a. Spanja dhe Portugalia
b. Franca dhe Gjermania
c. Anglia dhe Italia
d. Rusia dhe Japonia

**4. NUK ishte motiv për pushtimin e Afrikës:** **1 pikë**
a. Përfitimi i lëndëve të para minerare e bujqësore me origjinë tropikale
b. Sigurimi i tregjeve të shitjes
c. Krijimi i hapësiravepër investimin e kapitaleve
d.Krijimi i hapësirave për kthimin e skllevërve në Afrikë

**5. Përpara pushtimit osman, territoret shqiptare i përkisnin besimit fetar:1 pikë**
a.Mysliman e bektashian
b.Katolik e ortodoks
c.Mysliman e katolik
d. Bektashian e ortodoks

**6. Kultura më e vjetër në botë është ajo e:** **1 pikë**
a. Aborigjenëve të Afrikës
b. Aborigjenëve të Australisë
c. Europianëve
d. Amerikanëve

**7. Europiani i parë që zbuloi Indinë me rrugë detare ishte:** **1 pikë**
a. Kristofor Kolombi
b.Vasko de Gama
c. Bartolomeo Dias
d. Ferdinand Magelani

**8. Jep shpjegimin e fjalëve:** **4 pikë**

a. Indulgjenca

…………………………………………………………………………………………………………………………….

b. Rilindje ………………………………………………………………………………………………………………

c. Ferdinand Magelani ……………………………………………………………………………………….……

d. Karavela ………………………………………………………………………………………………………......

**9. Shëno e vërtetë (V), e gabuar (G)** **6 pikë**

a. Feja islame u përhap më shumë në fshatra sesa në qytete. (……)

b. Përhapja e fesë islame në viset shqiptare u shoqërua me përçarjen e popullsisë shqiptare. (……)

c. Periudha e viteve 1450 deri ne vitet 1700 është quajtur si“Periudha e Zbulimeve të Mëdha Gjeografike“(……)

d. Kontinenti amerikan u zbulua për herë të parë nga Ferdinando Magelani. (……)

e. Nga Revolucioni i çmimevehumbën shtresat e ulëta të popullsisë. (……)

f. Procesi i pastrimit të fesë katolike nga anët negative njihet në histori me emrin kalvinizëm. (……)

**10. Lidh me shigjetë:** **6 pikë**

| | |
|---|---|
| a. Marko Polo | Popullsia në shek. XVIII jetonte në fise ose tribu (……) |
| b. Afrika | Grabitën fildishin, metalet e çmuara dhe pasuritë e tjera (……) |
| c. Europianët | Pushtuesit e parë të Afrikës (……) |
| d. Portugezët | I pari që udhëtoi për në “Indi” nga Perëndimi (……) |
| e. Kristofor Kolombi | Kisha e reformuar e Anglisë (……) |
| f. Kisha anglikane | Frymëzues i zbulimeve të “Botës së Re” (……) |

**11. Cilat ishin arsyet e fillimit të rënies së Perandorisë Osmane?** **3 pikë**

a…………………………………………………………………………………………………………………………………

b…………………………………………………………………………………………………………………………………

c…………………………………………………………………………………………………………………………………

**12. Listo të paktën tri gjini të ndryshme të arkitekturës me ndikim osman:** **3 pikë**

a…………………………………………………………………………………………………………………………………

b…………………………………………………………………………………………………………………………………

c…………………………………………………………………………………………………………………………………

**13. Dy idetë kryesore të Kalvinit ishin:** **2 pikë**

a…………………………………………………………………………………………………………………………………

b…………………………………………………………………………………………………………………………………

| **Notat** | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Pikët** | 0T7 | 8T11 | 12T15 | 16T19 | 20T23 | 24T27 | 28T31 |

**Test (tremujori i parë)**

**Emri e mbiemri:________________________** **Grupi C**

**1. Rol të rëndësishëm në përhapjen e ideve të Humanizmit luajti:** **1 pikë**

a. Shpikja e shtypshkronjës së parë
b. Shpikja e stilolapsit, me të cilin murgjit i kopjonin më lehtë librat.
c. Leximi i literaturës grekoTromake
d. Ndikimi i madh në jetën e banorëve të kishës katolike

**2. Vepra kryesore e Marin Barletit është:** **1 pikë**

a. Historia e perandorëve bizantinë
b. Historia e perandorëve romakë
c. Historia e jetës dhe e bëmave të Skënderbeut
d. Historia e jetës dhe e bëmave të Marin Barletit

**3. Princat gjermanë mbështetën protestantët në fillesat e tyre, për të:** **1 pikë**

a. Siguruar pavarësinë nga Perandori Karli V
b.Të merrnin në dorë pasuritë e Kishës Katolike.
c. Drejtuan vetë Kishën Katolike në Romë.
d. Alternativat (a) dhe (b) së bashku janë të sakta

**4.Gjatë sundimit të Sulejmanit të Madhërishëm, Perandoria Osmane u shtri në: 1 pikë**

a. Një kontinent
b. Dy kontinente
c. Tri kontinente
d. Katër kontinente

**5.Pasi e përvetësuan Australinë, anglezët dërguan aty fillimisht:** **1 pikë**

a. Priftërinjtë
b.Tregtarët e arit
c. Mjekët
d. Të burgosurit

**6.Perandoria Osmane e mbajti të pushtuar vendin tonë për:** **1 pikë**

a.100 vjet b.300 vjet c.500 vjet d.700 vjet

**7. Pas thyerjes së "Armatës së Pathyeshme spanjolle", rivali i vetëm i Anglisë në luftën për koloni ngeli:** **1 pikë**

a. Franca
b. Portugalia
c. Spanja
d. Gjermania

**8. Djegia e librave dhe dënimi i heretikëve është:** **1 pikë**

a. Tolerancë

b. Intolerancë
c. Mëshirë
d. Ndihmë për zhvillimin e letërsisë

**9.J ep shpjegimin e fjalëve: 5 pikë**
a. Gjon Kalvini
……………………………………………………………………………………………………………………………………
b. Urdhri i Jezuitëve
……………………………………………………………………………………………………………………………………..
c. Zanat
……………………………………………………………………………………………………………………………………..
d. Jeniçer
……………………………………………………………………………………………………………………………………
e. Boerë
…………………………………………………………………………………………………………………………

**10. Shëno e vërtetë (V), e gabuar (G): 6 pikë**
a. Zhvillimi ekonomik në shekujt XVI – XVII favorizoi fuqizimin e një klase së re: borgjezisë, e cila filloi të shkatërrojë artin dhe kulturën e krijuar deri në atë kohë. (……)
b. Europianët gjetën në Amerikë të njëjtat kultura bujqësore që kishin në Europë. (……)
c. Portugezët pushtuan pjesën lindore të Amerikës (Brazilin). (……)
d. Zbulimet e mëdha gjeografike sollën zhvendojen e rrugëve tregtare nga Mesdheu për në Atlantik dhe Detin e Veriut. (……)
e. Evropianët morën skllevër nga Amerika dhe i sollën në Afrikë që të punonin në miniera. (……)
f. Kisha Katolike lejoi përhapjen e rrymave të reja Luteranizmit, Kalvinizmit, anglikanizmit. (……)

**11. Lidh me shigjetë: 5 pikë**

| | |
|---|---|
| a. Ferdinando Magelani | I pari që kuptoi që kontinenti amerikan ishte një "Botë e Re" |
| b. Amerigo Vespuçi | I pari që vërtetoi që bota është e rrumbullakët |
| c. Johan Gutenberg. | U fuqizua gjyqi i inkuizicionit që dënonte heretikët. |
| d. Elizabeta I Tudor | Shtypshkronja e parë. (……) |

**12.Listo tre humanistë shqiptarë: 3 pikë**

| | | |
|---|---|---|
| a. | b | c |
| ................................ | .................................. | ............................................. |

**13. Rendit të paktën katër nga kërkesat e Luterit: 4 pikë**
a……………………………………………………………………………………………………………………………………………
b……………………………………………………………………………………………………………………………………………
c……………………………………………………………………………………………………………………………………………
d……………………………………………………………………………………………………………………………………………

| **Notat** | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Pikët** | 0T7 | 8T11 | 12T15 | 16T19 | 20T23 | 24T27 | 28T31 |

**Tematika 2**

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

| **Fusha:Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Historì** | **Shkalla: III** | **Klasa: VII** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore 2.2.**<br>Franca gjatë sundimit të Luigjit XIV | | **Situata e të nxënit:**<br>"Çdo mëngjes, kryeshërbëtori zgjonte Luigjin XIV në orën 7.30. Në sallone qëndronin mbi 100 fisnikë të priviligjuar, duke pritur të ndihmonin mbretin të vishej. Vetëm katër prej tyre kishin nderin t'i mbanin atij rrobën dhe pantoflat. Jashtë dhomës, fisnikë të tjerë prisnin korridoreve të Versajës me shpresën se mbreti do t'i vinte re. Një përshëndetje me kokë, një shenjë miratimi, përcaktonte suksesin ose dështimin e tyre. Luigjit XIV i pëlqente ta quanin Mbreti Diell. Ai besonte se, ashtu si dielli, gjithë pushteti rrezatonte prej tij." | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>x emërton konceptin pushtet absolute;<br>x përcakton veçoritë e absolutizmit francez;<br>x vlerëson arritjet në art, në kulturë dhe në shkencë gjatë periudhës së Luigjit XIV. | | **Fjalët kyç**:<br>Luftë fetare**,** absolutizëm, hegjemoni, Luigji XIV, "Mbreti Diell", Mazarini, Kobleri. | |
| **Burimet:**<br>teksti Historia 7, Karl Grimberg, "Historia Botërore dhe Qytetërimi", materiale nga interneti, You tube, fotografi të Luigjit XIV, kardinalit Rishëljë, dokumenta historikë etj. | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare:**<br>TIK, Artet, Letërsia | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** stuhi mendimi**,** punanë grup, lojë me role, diskutim. | | | |
| **Organizimi i orës së mësimit.**<br>- Nxënësit pasi kanë lexuar tekstin,fillimisht përcaktojnë fotografitëe vendosura në klasë. A i keni parë herë tjetër ato? Kujt i përkasin?<br>- Diskutohet rreth Natës së Shën Bartolomeut. A ka ndodhur në Shqipëri një ngjarje e tillë?Përse jo?<br>- Më pas, nxënësit punojnë në grupe. Secilit nga grupet i jepen role të caktuara, p.sh.:<br>o grupi I personifikon Luigjin XIII;<br>o grupi II përsonifikon kardinali Rishëljë dhe Mazarinin;<br>o grupi III personifikon Luigjin XIV;.<br>o grupi IV personifikon Pallatin e Versajës.<br>- Grupet diskutojnë midis tyre dhe nxjerrin përfundime mbi:<br>karakteristika e tyre, dallimet mes tyre, të përbashkëtat, si dhe ecurinë e ekonomisë franceze në periudhat respektive.<br>*Kompetencat që përfitojnë*: kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, e të menduarit, e të nxënit, personale, kompetenca për jetën sipërmarrjen dhe mjedisin, kompetenca digjitale. | | | |
| **Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për punën në grupe, lojën me role, si dhe diskutimet e hapura në klasë. | | | |
| **Detyrat dhe puna e pavarur:** Pallati i Versajës (You tube) | | | |

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori</td><td>Shkalla: III</td><td>Klasa: VII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore 2.3 Iluminizmi</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:<br>Shkrimtarja angleze Meri Estell, duke u mbështetur në të drejtat natyrore të njeriut, thoshte: “Në qoftë se burrat kanë lindur të lirë, atëherë përse gratë kanë lindur skllave?”.<br>Komentoni shprehjen.<br></td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:<br>x përcakton burimet e Iluminizmit;<br>x vlerëson të rejat që sollën në mendimin politik e shoqëror Monteskje, Volteri dhe Rusoi;<br>x përcakton rëndësinë e ndarjes dhe kontrollit të pushteteve.</td><td colspan="2">Fjalët kyç:<br>Xhon Lok, Volteri, Monteskje, Ruso, Maria Uollstonkraft, Meri Estell, Barok, Rokoko, Neoklasicizëm.<br><br></td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:<br>teksti Historia 7, Karl Grimberg, “Historia Botërore dhe Qytetërimi”, materiale nga interneti, You tube, dokumenta historike etj.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare:<br>TIK, Artet, Letërsia</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: punë dyshe, diskutim.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit<br>
- Mësuesi i lejon nxënësit të lexojnë mësimin, duke i ndarë në fillim në grupe dyshe. Një dyshe përgatitet për lidhjen Arsye – Arsimim – Rrëzim i monarkisë absolute, një tjetër për Xhon Lokun, të tjerët për Monteskjenë e në vazhdim për Volterin, Zhan Zhak Rusoin, stilin barok, Neoklasicizmin, Daniel Defoe, Haiden, Moxartin dhe Bethovenin.<br>
- Më pas, mësuesi pyet nxënësit se ç’të përbashkët kanë këta emra dhe nga se dallojnë?<br>
- A jeni dakort me këto gjykime? A bazohet sot sistemi demokratik në këto parime?<br>
- A ndikojnë këto parime në rrëzimin e monarkisë absolute dhe në krijimin e monarkive më të përparuara?<br>
- Po arsimimi masiv (ndriçimi masiv), Iluminizmi janë ende sot ekzistentë:<br>
<br>
<br>
<br>
<br>
<br>
Monteskje Zhan Zhak Ruso Volteri<br>
Kompetencat që përfitojnë: kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, e të menduarit, e të nxënit, kompetenca digjitale.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për punën dyshe, plotësimin e tabelës së koncepteve dhe pjesëmarjen në diskutim.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Detyrat dhe puna e pavarur: Marrje informacioni nga Internet për “Sinfoninë e 9Ttë të Bethovenit”.</td></tr>
</table>

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori</td><td>Shkalla: III</td><td>Klasa: VII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore 2.4 Revolucioni i Parë Industrial</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:<br>Anglia njihet si Atdheu i Revolucionit Industrial. Ajo i plotësonte të gjitha kushtet e Revolucionit Industrial: Tpasuri natyrore, T rrjet i pasur lumor që lehtësonte transportin brenda vendit, T tregti përtej detit, Tjetë e qetë</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:<br>x përcakton rolin që luajti ardhja në pushtet në Angli e fisnikërisë së re dhe borgjezisë.<br>x shpjegon lidhjen e ngushtë të procesit të gardhimit me nevojën për të kaluar në prodhimin e madh me makina.<br>x analizon kushtet kryesore që mundësuan fillimin e kthesës industriale në Angli.</td><td colspan="2">Fjalët kyç: qarkullimi bujqësor, revolucioni industrial fabrika, urbanizim, klasë e mesme.<br><br></td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:<br>teksti Historia 7, Karl Grimberg, “Historia Botërore dhe Qytetërimi”, materiale nga interneti, You tube, dokumente historikë etj.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare:<br>TIK, Artet, Letërsia, Gjeografia.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve. Stuhi mendimi, të vijmë përreth, punë dyshe.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit<br><br><br>- Mësuesi shkruan togfjalëshin në dërrasë: Revolucioni Industrial, dhe pret nga nxënësit të shprehin mendimet e tyre. Më pas, mësuesi ndërhyn nëpërmjet rrugëtimit nga artizanati te Revolucioni Industrial:<br>- Për secilën nga hapat e rrugëtimit, mësuesi cakton dyshet e nxënësve që do të punojnë me tekstin dhe do të japin përgjigjet për kuptimin e çdo hapi dhe të pyetjeve të mësuesit:<br><br>Treni zëvendëson karrocën<br>– Përse ardhja në pushtet e fisnikërisë së re dhe borgjezisë u pasua me Revolucionin Industrial?<br>TPërse u quajt Revolucion? Përse u quajt industrial?<br>TA ndikoi procesi i gardhimit në prodhimin e madh me makina?<br>TCilat ishin kushtet kryesore që mundësuan kthesën në Angli?<br>– Përse Revolucioni ndodhi në Angli?<br>TSi iu arrit kalimi nga puna me dorë në prodhimin me makina?<br>Kompetencat që përfitojnë: kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, e të menduarit, e të nxënit.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për përgjigjet e dhëna, punën dyshe dhe pjesëmarrjen në diskutime dhe debate.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Detyrat dhe puna e pavarur: Ese. “Nga procesi i gardhimit te Revolucioni Industrial”.</td></tr>
</table>

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkalla: III** | **Klasa: VII** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore 2.5.** Rrjedhojat e Revolucionit të Parë Industrial | **Situata e të nxënit:**<br>Përpiquni të përfytyroni mënyrën e jetesës së punëtorëve, pasi të keni lexuar pjesën e mëposhtme: "Shtëpitë, që nga bodrumet deri në çati janë të mbushura plot e përplot me qiraxhinj dhe janë aq të pista nga jashtë e nga brenda saqë askush, do të mendonte njeriu, nuk do të pranonte të banonte në to". |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>x përshkruan kushtet e punës dhe të jetës së punëtorëve anglezë në shekullin XVIII;<br>x diskuton në klasë për rrjedhojat sociale të revolucionit Industrial;<br>x vlerëson rolin e kthesës industriale në raport midis shtresave të shoqërisë angleze. | **Fjalët kyç**:<br>klasë e mesme,<br>urbanizim,<br>punëtorë me mëditje.<br> |
| **Burimet:** teksti Historia 7, Karl Grimberg, "Historia Botërore dhe Qytetërimi", materiale nga interneti, You tube, dokumente historike etj. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:**<br>TIK, Artet, Letërsia, Gjeografia. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** punë dyshe, pyetje Ŧ përgjigje, harta e të pyeturit.

**Organizimi i orës së mësimit.**

- Pasi mësuesi u prezanton temën e re të mësimit, i ndan nxënësit në grupe dyshe që të lexojnë mësimin, duke i paracaktuar që t'u përgjigjen pyetjet si më poshtë:
- Përse u rrit numri i banorëve në qytete? Përse popullsia angleze u dyfishua?
- Ç'është urbanizimi?
- Përse aristokracia filloi të shkrihej me borgjezinë? Cili është ndryshimi midis tyre?
- Si ishin kushtet e punës dhe të jetesës së punëtorëve anglezë në shek. XVIII?
- Ç'rrjedhoja sociale pati Revolucioni Industrial? Mund të ndodhte ndryshe?
- A vazhdonte të quhej i pasur ai që kishte sipërfaqe të mëdha toke?
- Apo mendoni që pasuria nuk po lidhej më me tokën?
- Atëherë të pasurit e rinj, a e lidhnin sigurimin e një kapitali të madh me industrinë: Ŧ lindja e sistemit kapitalist, lindja e sektorit të dytë të ekonomisë = industrisë, lindja e qyteteve industriale, premisat për lindjen e sektorit të tretë të ekonomise, premisat për lindjen e shtetit të mirëqenies sociale.




- Cilat janë dy shtresat e mëdha që u krijuan nga Revolucioni i Parë Industrial?

*Kompetencat që përfitojnë*: kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, e të menduarit, e të nxënit.

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në përgjigje, debate, diskutime, krijimin e hartës së të pyeturit.

**Detyrat dhe puna e pavarur:** Ndërtoni hartën e të pyeturit Ŧ Revolucioni i Dytë Industrial.

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori</td><td>Shkalla: III</td><td>Klasa: VII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore 2.6 Revolucioni anglez i shekullit XVII</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:<br>Mbret Karli I Stjuart<br>Në vitin 1649, pas gjyqit, nën akuzën e tradhëtisë, u dënua me vdekje. Mbretit iu pre koka. Deri në këtë kohë mbretërit ishin rrëzuar nga froni, ishin vrarë në beteja, por asnjëherë nuk kishte pasur ekzekutim në publik.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:<br>x përcakton meritat e Oliver Kromuellit në fatet e mëvonshme të zhvillimit të Anglisë<br>x evidenton shkaqet e tensionimit të situatës politike në Angli me ardhjen në fron të mbretit Karli I.<br>x krahason periudhën e luftërave qytetare me “Revolucionin e lavdishëm” të vitit 1688.</td><td colspan="2">Fjalët kyç:<br>parlamentarizëm, Monarki kushtetuese, Xhejmsi I, Peticioni mbi të drejtat, Karli I, Kromuell, Revolucioni i lavdishëm.<br><br></td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: teksti Historia 7, Karl Grimberg, “Historia Botërore dhe Qytetërimi”, materiale nga Interneti, You tube, dokumente historikë.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare:<br>TIK, Artet, Letërsia, Gjeografia.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Lojë me role, diskutim.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit:<br><br><br>- Pasi mësuesi tregon temën e re u jep disa nxënësvë nga një rol lidhur me figurat historike të këtij mësimi, cakton nga dy apo më shumë nxënës plotësues rolesh si dhe u lë kohë të lexojnë tekstin dhe më pas të përgatiten për rolet e tyre:<br><br><br>- Elizabeta I,<br>- Xhejmsi I<br>- Karlit I<br>- Oliver Kromuelli<br>- Riçardi<br>- Karlin II Stjuart<br>- Vilhelm Oronzhi<br>- Më pas nxënësit fillojnë dhe luajnë rolet e tyre, mësuesi drejton, nxënësit etjerë plotësojnë.<br>- Theksohet dhe nga ana e mësuesit merita e Oliver Kromuellit.<br>- Evidentohen shkaqet e tensionimit të situatës politike në Angli me ardhjen në frontë Karlit I.<br>- Bëhet krrahasimi i luftërave qytetare me “Revolucionin e lavdishëm” të vitit 1688.<br><br>Kompetencat që përfitojnë: kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, e të menduarit, e të nxënit, kompetenca digjitale.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për lojën me role, plotësimin e ngjarjeve dhe diskutimet në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Detyrat dhe puna e pavarur: Informacione në Internet 𝕋 Deklarata e të Drejtave (Bill of Rights)</td></tr>
</table>

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori</td><td>Shkalla: III</td><td>Klasa: VII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore 2.8 Revolucioni amerikan i shekullit XVIII</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:<br>“Ne konsiderojmë të rëndësishme të vërtetat e mëposhtme: të gjithë njerëzit janë krijuar të barabartë dhe krijuesi i tyre u ka dhënë disa të drejta të patjetërsueshme: jeta, liria dhe dëshira për lumturi. Për sigurimin e këtyre të drejtave është krijuar qeveria, e cila nëse nuk i përmbush këto qëllime, atëherë populli ka të drejtë ta ndryshojë ose ta përmbysë, dhe të krijojë një qeveri të re që mund t’i sigurojë atij jetën dhe lumturinë”.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:<br>x evidenton rolin dhe rëndësinë e Deklaratës së Pavarësisë;<br>x argumenton ligjshmërinë e shkëputjes së SHBA-së nga sundimi anglez;<br>x krahasonraportet midis kolonistëve dhe metropolit anglez para dhe pas Luftës 7-vjeçare.</td><td colspan="2">Fjalët kyç:<br>metropol, Deklarata e Pavarësisë, Tomas Xhefersoni, Kushtetutë, shtet-federal.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: teksti Historia 7, Karl Grimberg, “Historia Botërore dhe Qytetërimi”, materiale nga Interneti, You tube, dokumenta historike etj.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare:<br>TIK, Qytetarinë, Letërsinë, gjeografinë.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Stuhi mendimesh, parashikim me terma paraprakë.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit:<br>Nxënësit lexojnë mësimin në mënyrë individuale. Mësuesi pyet:<br>SHBA-ja është shteti më i fuqishëm i botës. Por si janë krijuar ato?<br>Mësuesi pret përgjigjet e nxënësve dhe më pas ju tregon temën e re, si dhe shkruan në tabelë:<br>Mësuesi pret që nxënësit të bëjnë lidhjen me mësimin e ditës. Ai i ndihmonë me pyetjet:<br>- Cila ishte prejardhja e popullsisë së 13 kolonive?<br>- Ç’marëdhënie ekzistonte midis 13 kolonive dhe Francezëve?<br>- Ç’ndryshoi pas Luftës 7-vjeçare Angli-Francë?<br>- Përse Anglia vendosi Taksën e Pullës?<br>- Si reaguan amerikanët ? A ishte i ligjshëm ky reagim? Ç’kuptim kishte Deklarata e Pavarësisë?<br>- Si reaguan anglezët? Përse u miratua Kushtetuta amerikane?<br><br><br>Kompetencat që përfitojnë: kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, e të menduarit, e të nxënit, kompetenca digjitale.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen përpërgjigjet e dhëna gjatë orës së mësimit.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Detyrat dhe puna e pavarur: Hulumtim në Internet: - Deklarata e Pavarësisë së SHBA-së.</td></tr>
</table>

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori</td><td>Shkalla: III</td><td>Klasa: VII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore 2.10 Lufta Civile në SHBA</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Abraham Linkoln:<br>“T Një shtëpi, ku dy pjesët janë kundër njëraTtjetrës, nuk mund të mbijetojë. Unë nuk besoj se ky popull dëshiron të qëndrojë i ndarë, në shtete të lira dhe shtete që i përkasin skllavërisë.”</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:<br>x evidenton territoret që hynë në përbërje të SHBATsë.<br>x përcakton nëse kompromisi i vitit 1820 ishte zgjidhja e duhur midis borgjezisë dhe plantatorëve amerikanë<br>x analizon kushtet historike që ndihmuan në zgjerimin territorial të SHBATsë.</td><td colspan="2">Fjalët kyç:<br>ekonomi plantatore, sistemi politik i dy partive, Ligji i Homstedit, Abraham Linkoln, janki.<br><br></td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: teksti Historia 7, Karl Grimberg, “Historia Botërore dhe Qytetërimi”, materiale nga Interneti, You tube, dokumenta historike etj.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare:<br>TIK, Artet, Gjeografia.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Parashikim me terma paraprakë, punë dyshe, diskutim.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit:<br>Pasi mësuesi tregon temën e re dhe bën lidhjen e saj me temat e fundit, cakton punën dyshe duke ju dhënë nga një fishë me fjalët e mëposhtme të cilat do ti gjejnë në tekst. (një për çdo dyshe, ose në varësi të numrit të nxënësve në klasë):<br>a. Blerjet nga Franca<br>b. Aneksimi i Floridës<br>c. Shkëputja e Teksasit dhe e Kalifornisë<br>d. Vërshimi i miliona amerikanëvë<br>e. Rritja e numrit të popullsisë<br>f. Shkaqet e luftës civile<br>g. Ashpërsimi i kontradiktave VeriTJug<br>h. Preteksti i Luftës Civile<br>i. Konfederata e Shteteve Amerikane.<br>j. Ligji mbi Homstedin<br>k. Heqja e skllavërisë<br><br><br>Pasi nxënësit janë gati, mësuesi këto fjalë i kthen në pyetje dhe ia drejton klasës, si dhe nxënësit që i kishte dhënë fishën. Mësuesi plotëson dhe sqaron aty ku mendon që nxënësit dalin jashtë kontekstit mësimor apo kanë diçka të paqartë.<br>Kompetencat që përfitojnë: kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, e të menduarit, e të nxënit.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për përgjigjet e dhëna, si dhe pjesëmarrjen në diskutim.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Detyrat dhe puna e pavarur: Pavarësisht fitores së Veriut kapitalist, ju do të mbështesnit Veriun kapitalist apo jugun skllavopronar në Luftën Civile amerikane? Argumentoni mendimin tuajin.</td></tr>
</table>

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori | Shkalla: III | Klasa: VII |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore 2.12** Fillimi i Revolucionit francez të shek.XVIII | **Situata e të nxënit:**... *Populli u armatos me shkopinj, thika dhe heshta, dhe i frymëzuar nga qëllime të ndryshme, sulmoi çdo gjë që gjente përpara. Turma mori topat e gardës franceze dhe flamurët e qytetit. Çdo qytetar e shpalli veten ushtar të atdheut. Qelitë e burgjeve u hapën dhe të gjithë* të dënuarit, *me përjashtim të kriminelëve, u liruan.* |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>x përshkruan gjendjen e Francës në prag të revolucionit;<br>x evidenton veprimtarinë reformatore të Nekerit;<br>x analizon ngjarjet e 11 – 14 Korrikut 1789në Paris deri në rrëzimin e monarkisë absolute. | **Fjalët kyç**:<br>Asamble Legjislative, Konventa Kombëtare, gijotinë, legale.<br> |
| **Burimet:** teksti Historia 7, Karl Grimberg "Historia Botërore dhe Qytetërimi", materiale nga interneti, You tube, dokumenta historikë etj | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare:**<br>TIK, Letërsia. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Punë me grupe Ͳ Di/Dua të di /Mësova.

**Organizimi i orës së mësimit:**
Pasi është krijuar nga nxënësit ashtu sikurse ata e mendojnë, mësuesi/ja ndërton një tabelë në dërrasën e zezë. Ajo plotësohet nga nxënësit pas ndarjes së detyrave të orientuara nga mësuesi/ja.

| *Di* | *Dua të di* | *Mësova* |
|---|---|---|
| Në këtë kolonë listohen mendimet e nxënësve për atë që ata dinë për formën e qeverisjes.<br> | Në këtë kolonë shkruhen pyetjet,që nxënësit hartojnë për të mësuar rreth Revolucionit francez. Për këtë nxënësit orientohen të punojnë në grupe dhe ndërkohë mësues/ja i udhëzon duke zbatuar: *Veprimtari me lexim të drejtuar.*<br>Fisnikët, kleri, borgjezia,fshatarësia dhe të varfërit e qyteteve. | Në këtë kolonë, nxënësit përmbledhin njohuritë dhe i përforcojnë ato në trajtën e një skeme ose,të një renditjeje të koncepteve kryesore që përfituan nga tema në fjalë. Një sugjerim:<br>1.Luigji XVI<br>2.Neker<br>3.Përfaqësia e përgjithshme<br>4.Rënia e Bastijës<br>5.11Ͳ14 korrik 1789<br>6.Rrëzimi i monarkisë absolute |

*Kompetencat që përfitojnë*: kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, e të menduarit, e të nxënit.

**Vlerësimi:** vrojtimet e mësuesit, lista e kontrollit.

**Detyrat dhe puna e pavarur:** Përshkruani Revolucionin francez me dhjetë fjali.

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori | Shkalla: III | Klasa: VII |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore 2.13**<br>Revolucioni francez. Shpallja e Republikës | | **Situata e të nxënit:**<br>Më 26 gusht 1789, në Francë u miratua Deklarata e të Drejtave të Njeriut dhe Qytetarit. Deklarata shpalli se pushteti buron nga populli dhe i takon popullit. Kjo tregon se monarkisë absolute po i vinte fundi. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>x përcakton masat e marra nga Asambleja Kushtetuese për forcimin e regjimit të borgjezisë;<br>x përshkruan rrethanat e shpalljes së Republikës;<br>x analizon shkaqet e kalimit në Regjimin e Terrorit. | | **Fjalët kyç**:<br>Deklarata e të Drejtave,Asambleja Legjislative,Konventa Kombëtare.<br>  | |
| **Burimet:** teksti Historia 7, Karl Grimberg, "Historia Botërore dhe Qytetërimi", materiale nga interneti, You tube, dokumenta historikë etj. | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare:**<br>TIK, Letërsia. | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** të nxënët në bashkëpunim, fjalë të njëpasnjëshme.

**Organizimi i orës së mësimit:**

- Nxënësve iu bëhet e qartë tema e mësimit dhe më pas mësuesi i le të lexojnë mësimin për pak minuta duke shënuar në libër fjalët më kryesore të mësimit. Më pas fillon sipas një renditje, (sipas emrave në rregjistër), nga ku çdo nxënës do të thotë nga një fjalë dhe të tjerët do e pasojnë me vazhdimin e fjalisë. Mësuesi lejon që nxënësit të thonë edhe fjali të plota: Mësuesi ndërhyn në rastet e bllokimit apo në rastet kur nxënësit japin informacione jo të sakta.
- P.sh. Pas shpërthimit të revolucionit në të gjithë Francën u krijua një gjendje anarkie. Më 26 gusht 1789 u miratua Deklarata e të Drejtave të Njeriut dhe Qytetarit. Deklarata shpalli se pushteti buron nga populli dhe i takon popullit etj
- Mësuesi mban një radhë të caktuar, dhe kur një nxënës nuk ka apo nuk di diçka për të thënë, mësuesi nuk heziton të kalojë radhën te nxënësit e tjerë. Mësuesi duhet të ketë kujdes në stimulimin e përgjigjeve të sakta, por dhe në formën se si do të kundërshtojë përgjigjet e gabuara.



*Kompetencat që përfitojnë*: kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, e të menduarit, e të nxënit, kompetenca digjitale.

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për përgjigjet e dhëna, si dhe për plotësimet e shokëve.

**Detyrat dhe puna e pavarur:** Hulumto në Internet: Reformat e Nekerit.

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkalla: III** | **Klasa: VII** |
|---|---|---|---|

**Tema mësimore 2.14** Periudha e sundimit të Napoleon Bonapartit.

**Situata e të nxënit:** A keni dëgjuar ndonjëherë për Napoleon Bonapartin? Ai sundoi në Francë dhe dominoi historinë Europiane nga viti 1799 – 1815. Motoja e tij ishte: Fjala "e pamundur" nuk ekziston në fjalorin tim.

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**

- x përcakton arsyet e paaftësisë së Direktoratit për të përballuar problemet e brendshme dhe të jashtme të Francës;
- x analizon masat që mori Napoleoni për të përqendruar pushtetin në duart e tij;
- x diskuton në klasë për jetën dhe veprën e Bonapartit.

**Fjalët kyç**:
Direktorat, Brymer, Kod.




**Burimet:** teksti Historia 7, Karl Grimberg, "Historia Botërore dhe Qytetërimi", materiale nga Interneti, You tube, dokumenta historikë etj

**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare:**
TIK, Artet, Letërsia.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** diskutim, stuhi mendimesh, pyetjeͲpërgjigje.

**Organizimi i orës së mësimit:**

- Mësuesi i pyet nxënësit se çfarë kanë dëgjuar për Napoleon Bonapartin dhe, pasi merr mendimet e tyre, ju bën disa pyetje dhe diskuton me ta për jetën dhe karrierën e N. Bonapartit.
- Në vazhdim nxënësit lexojnë tekstin dhe mësuesi iu drejton pyetjet e mëposhtme:
- Përse Direktorati dështoi në përballimin e problemeve të brendshme dhe të jashtme në Francë?
- Cilët ndihmuan N.Bonapartin të vinte në pushtet?
- Cilat ishin masat kryesore që ndërmori Napoleoni me ardhjen në pushtet?
- Ç'regjim u vendos në Francë?
- Cilat shtresa gjetën mbështetje te Napoleoni?
- Ç'masa mori ai në politikën e brendshme dhe të jashtme?





*Kompetencat që përfitojnë*: kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, e të menduarit, e të nxënit, kompetenca digjitale.

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për diskutimet dhe përgjigjet e pyetjeve nga mësuesi.

**Detyrat dhe puna e pavarur:** Hulumtim në Internet: Ͳ Direktorati dhe Napoleoni.

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Historī | Shkalla: III | Klasa: VII |
|---|---|---|---|

**Tema mësimore 2.15**
Krijimi i Perandorisë franceze të Napoleonit dhe rënia e saj

**Situata e të nxënit:**
Në shekullin XX filloi zbatimi i ideve të Napoleonit. Mbetën profetike shprehjet e tij: "Do të vijë një ditë që fitoret do të korren pa topa dhe bajoneta. Kush turbullon paqen e Evropës, kërkon luftë civile".

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**

- përcakton veçoritë e Perandorisë së Napoleon Bonapartit;
- përshkruan luftrat e Napoleonit për të vendosur sundimin në Evropë;
- evidenton ecurinë e ngjarjeve që çuan në rrëzimin e perandorisë së Napoleonit.

**Fjalët kyç**: bllokadë kontinentale, luftë guerile, Borodino , Vaterlo, abdikim.




**Burimet:** teksti Historia 7, Karl Grimberg, "Historia Botërore dhe Qytetërimi", materiale nga Interneti, You tube, dokumenta historikë etj.

**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare:**
TIK, Artet, Letërsia.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** të nxënët në bashkëpunim, fjalë të njëpasnjëshme.

**Organizimi i orës së mësimit:**

- Nxënësve iu bëhet e qartë tema e mësimit dhe më pas mësuesi i le të lexojnë mësimin për pak minuta, duke shënuar në libër fjalët më kryesore të mësimit. Më pas fillon sipas një renditjeje (sipas emrave në regjistër), nga ku çdo nxënës do të thotë nga një fjalë dhe të tjerët do e pasojnë më vazhdimin e fjalisë. Mësuesi lejon që nxënësit të thonë edhe fjali të plota:
- Mësuesi ndërhyn në rastet e bllokimit apo në rastet kur nxënësit japin informacione jo të sakta.
- P.sh. Sukseset e Napoleonit brenda dhe jashtë Francës e rritën autoritetin e tij. Në vitin 1802, Napoleoni e shpalli veten Konsull i përjetshëm. Franca u fuqizua dhe arriti të përballonte luftëra të shumta. Rritja e forcës ekonomike dhe ushtarake e Francës napoleoniane shqetësoi mbarë Evropën.etj
- Mësuesi mban një radhë të caktuar, dhe kur një nxënës nuk ka apo nuk di diçka për të thënë, mësuesi nuk heziton të kalojë radhën te nxënësit e tjerë. Mësuesi duhet të ketë kujdes në stimulimin e përgjigjeve të sakta, por dhe në formën se si do të kundërshtojë përgjigjet e gabuara.

*Kompetencat që përfitojnë*: kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, e të menduarit, e të nxënit, kompetenca digjitale.




**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për përgjigjet e dhëna, si dhe për plotësimet e shokëve.

**Detyrat dhe puna e pavarur:** Hulumtim në Internet me temë: Nga toger ushtarak në perandor të fuqishëm.

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori | Shkalla: III | Klasa: VII |
|---|---|---|---|

**Tema mësimore 2.17** Kongresi i Vjenës

**Situata e të nxënit:** Madhëritë e tyre, perandori austriak, mbreti i Prusisë dhe perandori i gjithë Rusisë shpallin solemnisht: Neni 1 ... Tre monarkët pjesëmarrës në traktat do të jenë të bashkuar me lidhje vëllazërore me të vërtetë të sinqerta dhe, të pazgjidhura dhe duke e konsideruar veten si banorë të një toke, ata do t'i japin njëri‑tjetrit në çdo rast e në çdo vend çdo ndihmë dhe përkrahje ...

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**
- gjykon mbi rrethanat historike që i detyruan Fuqitë e Mëdha të mblidheshin në Kongresin e Vjenës;
- përcakton vendimet e Kongresit të Vjenës;
- përcakton rëndësinë e vendimeve të Kongresit të Vjenës për krijimin e hartës së re politike të Europës.

**Fjalët kyç**:
restaurim, legjitimitet, Lidhja e Shenjtë, Meternik, ekuilibër ndërkombëtar,kabinet, ratifikim.


ACTE DU CONGRÈS DE VIENNE DU 9 JUIN 1815, AVEC SES ANNEXES.
VIENNE, DE L'IMPRIMERIE IMPÉRIALE ET ROYALE.

**Burimet:** teksti Historia 7, Karl Grimberg "Historia Botërore dhe Qytetërimi", materiale nga interneti, You tube, dokumenta historike etj.

**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare:** TIK, Letërsia.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Pyetje‑përgjigje, diskutim i hapur

**Organizimi i orës së mësimit:**



- Mësuesi mendon që këtë orë mësimi ta organizojë bashkë me nxënësit me anë të pyetje‑përgjigjeve si dhe diskutimeve midis nxënësve dhe mësuesit.
- Në fillim, nxënësit lexojnë mësimin dhe më pas mësuesi i drejton pyetjet e mëposhtme:
- Përse u mbajt Kongresii Vjenës?
- Cilat shtete morën pjesë në të?
- Kur u mbajt ai?
- Nga ndryshon ai nga takimet e mëparshme të shteteve?
- Po Turqia mori pjesë?
- Cilat ishin vendimet e këtij kongresi lidhur me: Anglinë, Rusinë, Prusinë, Austrinë, Gjermaninë, Italinë.
- Po me sistemet qeverisëse?
- A i zgjidhi problemet kombëtare ky Kongres?
- Ç'ishte lidhja e Shenjtë dhe përse shërbeu ajo?

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për përgjigjet e dhëna, si dhe në diskutimet e ndryshme

**Detyrat dhe puna e pavarur:** Ese: Europa e bashkuar – Europa e copëtuar – Kongresi i Vjenës.

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori | Shkalla: III | Klasa: VII |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore 2.18** Jeta dhe nacionalizminë Evropën e shekullit XIX | **Situata e të nxënit:**<br>*Po të pyesësh një njeri se çfarë është, ai përmend kombësinë e tij dhe përgjigjet: jam shqiptar, grek, turk, amerikan etj.*<br>*Kombi është një popull që ka origjinë, gjuhë dhe tradita të njëjta. Kombi organizohet dhe krijon shtetin kombëtar.* |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>x përcakto shkaqet e lindjes dhe pë hapjes së Nacionaliz it;<br>x krahason Realizmin me Romantizmin dhe Impresionizmin në art e kulturë;<br>x evidento pasqyrimin e ideve nacionaliste në art e kulturë. | **Fjalët kyç**:<br>Nacionalizëm, Realizë , Impresioni ëm Balzak, Zola, Dikens. |
| **Burimet:** Teksti, materiale nga Interneti. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare:** Letërsia, artet. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxë ësve.**Parashikim me terma paraprake, leximi i orie tuar, punë dyshe, harta e koncepteve.

**Organizimi i orës së mësimit.**

- Mësuesi/ja shkruan në dërrasë termat: **Nacionalizëm**, R**ealizëm**, I**mpresionizëm,**dhe pyet nxënësit se çfarë kupton me to. Bazuar në përgjigjet e nxënësve bën shpjegimin e plotëtë tyre.
- Udhëzon nxënësit se si do të lexojnë çështjet mësimore, ku për secilën çështje mësuesi/ja ka përgatitur disa pyetje:a)ƬCilat ishin shkaqet e lindjes së Nacionalizmit? –Në cilat shtete u përhapën më shumë idetë Nacionaliste dhe pse?b) Çfarë shprehnin përfaqësuesit e realizmit në veprat e tyre? ƬÇfarë ishte impresionizmi? c) Cilët ishin përfaqësuesit kryesorë të Realizmit në letërsi? – Çfarë shprehnin në veprat e tyre shkrimtarët realistë?
- Nxënësit punojnë dyshe për të krijuar hartën e koncepteve

**Harta e koncepteve:**




**Vlerësimi:** Nxënësit vlerë ohen për m ndimet që japin,për përgjigjet e pyetjeve të dhëna nga mësuesi ja, bashkëpuni in ndarjen e ideve me njëriƬtjetrin dhe plotësimin e hartës së koncepteve.

**Detyrat dhe puna e pavarur:** Grumbulloni të dhëna për jetën dhe veprat kryesore të Eduart Manesë, Emil Zolasë, Çarls Dikensit dhe Balzakut.

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori | Shkalla: III | Klasa: VII |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore 2.20**<br>Bashkimi i Gjermanisë | | **Situata e të nxënit:**<br>Një bashkëkohës për efektet negative të copëtimit politik të Gjermanisë shprehet:<br>*... Gjermanët e ndiejnë veten gjithnjë e më shumë të kufizuar nga kufijtë doganorë. Kufinjtë paralizojnë marrëdhëniet e brendshme dhe luajnë po atë rol sikur çdo pjesë e trupit të njeriut të ishte shtrënguar me litar për të penguar kalimin e gjakut nga një organ në tjetrin.* | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>x evidenton gjendjen e Prusisë pas vitit 1849;<br>x rendit arsyet që sollën në postin e kancelarit Oto fon Bismarkun në Prusi;<br>x përcakton politikën e brendshmedhe të jashtme të Bismarkut. | | **Fjalët kyç**: junkerë, kancelar, Oto Von Bismark, Rajhu i Dytë, | |
| **Burimet:** teksti i Historisë, Internet, fotografi | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare:**<br>*Përzgjedh të dhëna nga burimet të ndryshme dhe i klasifikon ato sipas rëndësisë që kanë.*<br>*Analizon dhe komunikon informacionin historik.*<br>*Ndërton dhe interpreton grafikë për paraqitjen e të dhënave historike.* | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Leximi i orientuar, metoda e akuariumit, bashkëbisedim: pyetje – përgjigje.

**Organizimi i orës së mësimit:**

- Mësuesi/ja vendos në tabelë një fotografi të Bismarkut dhe e lë enigmë shpjegimin, në mënyrë që nxënësit ta zbulojnë vetë nëpërmjet leximit të mësimit se kush ishte Oto von Bismark.
- Orienton nxënësit të lexojnë mësimin dhe kërkonnga secili në mënyrë idividuale të përgatisë një pyetje.
- Vendoset në tavolinën e mësuesit një akuarium (ose një kuti kartoni). Pasi nxënësit të kenë lexuar mësimin dhe të kenë përgatitur pyetjen e udhëzohen qëta shkruajnë pyetjen në një fishë letre bashkë me emrin e tyre. Të gjitha fishat hidhen në akuarium. (Çdo nxënës duhet të përgatisë patjetër një pyetje). Pasi tëkenë mbaruar të gjithë, mësuesi/ja fillon hap një e nga një fishat dhe lexon pyetjen bashkë meemrine nxënësit që e ka bërë pyetjen. Përgjigjen mund ta japin vetë nxënësit ose mësuesi/ja.
- Nëpërmjet bashkëbisedimit pyetje – përgjigje, nxënësit kuptojnë thelbin e mësimit. Mësuesi/ja në fund përzgjedh pyetjet më thelbësore dhe më të rëndësishme,dhe vlerëson nxënësit që i kanë bërë.

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për mënyrën se si analizojnë dhe komunikojnë informacionin historik, përqendrimin dhe pjesëmarrjen në orën e mësimit.

**Detyrat dhe puna e pavarur:** Analizoni rëndësinë e bashkimit të Gjermanisë.

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori | Shkalla: III | Klasa: VII |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore 2.21**<br>Lëvizjet nacionale në Itali | **Situata e të nxënit:** Garibaldi për betejën e Kalatafimit në Siçili, maj 1860 shprehet:<br>"… Si mund ta harroj trimërinë e të rinjve, të cilët i vunë përpara ushtarët napolitanë. Duke pasur frikë se mos plagosesha me rrethuan mua, u afruan ngushtë pranë njëri-tjetrit dhe formuan një gardh të padepërtueshëm…. më në fund, ne kaluam në sulmin e fundit. U mbushën me frymë dhe si luanë u hodhën përpara, të bindur në fitoren e çështjes së madhe për të cilën luftonin." |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>x përshkruan gjendjen e Italisë pas Revolucionit të vitit 1848;<br>x analizon luftën italo – franko – austriake të vitit 1859 dhe rrjedhojat e saj;<br>x analizon faktorët që çuan në bashkimin e Italisë. | **Fjalët kyç**: Kamilo Kavur, Xhuzepe Garibaldi, këmishëkuqtë |
| **Burimet:** teksti, Interneti | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare:**<br>*Ndërton njohuritë historike për të analizuar konceptet dhe idetë.*<br>*Përzgjedh të dhëna nga burimet të ndryshme dhe i klasifikon ato sipas rëndësisë që kanë.*<br>*Vlerëson kontributin e patriotëve në të shkuarën, në mbrojtjen dhe identitetin kombëtar.* |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve.** Leximi i orientuar, ditari dypjesësh, diagrami i Venit

**Organizimi i orës së mësimit:**

- Mësuesi/ja orienton nxënësit për të lexuar mësimin, ku gjatë leximit duhet të kuptojnë disa çështje, si:
  - gjendja e Italisë para bashkimit;
  - detyrat kryesore që u dilnin patriotëve italianë për bashkimin e vendit;
  - figurat kryesore që kontribuan në bashkimin e Italisë;
  - mënyrat me të cilat u arrit bashkimi i Italisë.
- Pasi nxënësit kanë mbaruar së lexuari, vazhdojnë me veprimtarinë e dytë, ditarin dypjesësh.

Mësuesi/ja në tabelën e klasës dhe nxënësit në fletoret e tyre ndërtojnë ditarin dypjesësh.

| KONCEPTI | SHPJEGIMI |
|---|---|
| **Gjendja e Italisë para bashkimit** | - E pushtuar nga austriakët e në veri dhe nga burbonët në Jug<br>- E copëtuar në shumë shtete që ruanin regjimin e vjetër |

| | |
|---|---|
| **Detyrat që u dilnin patriotëve italianë** | - Çlirimi i Veriut nga Austria<br>- Çlirimi i Jugut nga burbonët francezë<br>- Përmbysja e regjimeve të vjetra<br>- Bashkimi iItalisë |
| **Kamili Kavur** | Kryeministër i mbretërisë së Piemontit<br>– Për të larguar austriakët nga Italia Veriore i kërkoi ndihmë Francës.<br>Franca pranon aleancëndhe zhvillohet lufta italo –franko – austriake. |
| **Xhuzepe Maxini** | Krijoi organizatën “Italia e re”<br>– Mendonte se çlirimi dhe bashkimi i vendit mund të realizohej nga poshtë nëpërmjet luftës së armatosur |
| **Xhuzepe Garibaldi** | Udhëheqës i lëvizje së armatosur në jug të Italisë<br>- Në krye të një ushtrie prej 1000 vullnetarësh të quajtur “Këmishëkuqtë” shkon në jug të Italisë<br>- Radhët e ushtrisë së tij u shtuan nga banorët vendës<br>- Çliron pjesën jugore dhe pjesën qendrore të Italisë. |
| **Bashkimi i Italisë** | 1861  Mbretëria e Napolit bashkohet me mbretërinë e Piemontit.<br>1870 – Çlirohet Roma, krijohet shteti i bashkuar italian. |

- Diagrami i Venit. Pasi nxënësit kanë plotësuar ditarin dypjesësh, mësuesi/ja u kërkonqë nëpërmjet diagramit të Venit të krahasojnë mënyrën e bashkimit të Gjermanisë dhe Italisë, të përbashkëtat dhe të veçantat.

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen dhe përqendrimin në orën e mësimt,rindërtimin e njohurive duke analizuar njohuritë e dhëna, përzgjedhjen dhe klasifikimin e materialeve të marra nga Interneti.

**Detyrat dhe puna e pavarur:** Mbledhin të dhëna dhe fotografi nga Interneti për jetën edhe veprën e Garibaldit, Kamilo Kavurit.

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** Dt.___/____/__

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori | Shkalla: III | Klasa: VII |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore 2.22** Perandoria Osmane dhe tkurrja e saj | | **Situata e të nxënit:** ***KUJTONI!*** *Në fund të shekullit XIX, Perandoria Osmane ishte dobësuar aq shumë sa thirrej "i sëmuri i Bosforit".* | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>x përshkruan gjendjen e Perandorisë osmane në fillim të shekullit XIX;<br>x evidenton veprimtarinë reformatore të sulltan Mahmutit II;<br>x analizon reformat e realizuara nga Abdyl Mexhidi, të quajtura Tanzimat. | | **Fjalët kyç**: Jeniçer, Selimi III, Hati Sherif i Gjylhanesë, Tanzimati, Elajeti, Xhonturqit. | |
| **Burimet:** teksti i Historisë, materiale nga Interneti. | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare:**<br>*Përdor fjali komplekse për spjegimin e marrëdhënieve shkakTpasojë.*<br>*Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike e shoqërore*. | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve.** Stuhi mendimesh, leximi i orientuar, harta e koncepteve

**Organizimi i orës së mësimit:**

- Mësuesi/ja shkruan në tabelë puetjen:*Çfarë dini për Perandorinë Osmane? Çfarë iu kujton emri Sulejmani i Madhërishëm?* Pasi nxënësit fillojnë të përgjigjën, mësuesi/ja shënon në tabelë përgjigjet. (Kujdes duhet të shënohen të gjitha përgjigjet, edhe në qoftë se janë të gabuara, me qëllim që nxënësit të inkurajohen dhe të bëhën pjesëmarrës)
- Mësuesi/ja jep detyrën: leximin e mësimit. Në të njëjtën kohë liston në tabelë çështjet ku do të përqendrohen nxënësit:
  a. Cilat janë figurat historike të Perandorisë Osmane që ndihmuan në reformim?
  b. Cilat ishin reformat e Tanzimatit në etapën e parë dhe etapën e dytë?
- Pasi kanë lexuar dhe përpunuar mësimin, nxënësit:

- Së bashku me mësuesin/en listojnë në tabelë figurat historike që ndihmuan në reformim

Plotësojnëhartën e koncepteve për reformat e Tanzimatit.

- Analizojnë dhe diskutojnë: A patën sukses reformat e Tanzimatit dhe pse?

- Sulltan Selimi III
- Sulltan Mahmuti II
- Sulltan Abdyl Mexhidi
- Sulltan Abdyl Hamiti II




**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për: aktivizimin gjatë orës së mësimit, mënyrën e demonstrimit të të dhënave në hartën konceptuale, analizimin e informacionit historik, duke u bazuar në argumente.

**Detyrat dhe puna e pavarur:** Shkarkoni nga Interneti fotografi të sulltanëve reformatorë

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori</td><td>Shkalla: III</td><td>Klasa: VII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore 2.24<br>Revolucioni i Dytë Industrial</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:<br>Sot, në jetën e përditshme, lëvizja me makina, përdorimi i telefonit, bërja e fotografigrafive, ndriçimi elektrik etj., na duken gjëra shumë normale. Madje nuk mund ta imagjinojmë dot jetën pa to. Por, para shekullit XIX, ato nuk ekzistonin. U shpikën në fund të shekullit, dhe kanë qënë shpikjet më të mëdha tëkohës.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:<br>x përshkruan arritjet në fushat e shkencës dhe të dijes;<br>x rendit arritjet në fushën e komunikimit:<br>x krahason raportin punëtor T veglat e punës para e pas Revolucionit të Dytë Industrial.</td><td colspan="2">Fjalët kyç: Motori diesel, linja zinxhir.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: teksti i Historisë, materiale nga Interneti, fotografi, Enciklopedi.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare:<br>• Zhvillon mendimin kritikpër të interpretuar të shkuarën nëpërmjetinformacionit.<br>• Përdor aftësitë e komunikimit për të prezantuar idetë etij.<br>• Parashtron pyetje kërkimore, duke u bazuarnë argument.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Parashikim me terma paraprakë. Ditari dy pjesësh, përpunim i njohurive.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit:<br>➤ Mësuesi/ja bën disa pyetje për të rikujtuar Revolucionin e Parë Industrial dhe për të bërë lidhjen enjohurive të marra me temën e re.<br>- Ç'kuptoni me revolucion Industrial?<br>- Kur u zhvillua Revolucioni i Parë Industrial?<br>- Cilat ishin shpikjet kryesore?<br>Përgjigjet, mësuesi/ja i shënon në një cep të tabelës me qëllim që pas shpjegimit të mësimit të ri, nxënësit të bëjnë krahasimet midis dy revolucioneve.<br>➤ Pasi nxënësit të kenë lexuar mësimin, mësuesi/ja u kërkon që të ndërtojnë ditarin dypjesësh me zhvillimet kryesore të Revolucionit të Dytë industrial. Jepet vetëm pjesa e parë e ditarit dhe pjesën tjetër nxënësit e plotësojnë në mënyrë individuale.<br><br>INDUSTRI<br>- Industria eçelikut<br>- Industria kimike<br>- Industria elektrike<br>- Motorri elektrik<br>- Motori me djegie të brendshme<br><br>SHKENCË<br>- Llampa e Edisonit<br>- Telefoni<br>- Radioja<br>- Aparati fotografik<br>- Mikrofoni<br>- Gramafoni<br>- Makina qepëse<br>- Rrezet X<br><br>MJEKËSI<br>- Vaksina e tuberkulozit<br>- Vaksina e tërbimit</td></tr>
</table>

| |
|---|
| ◗ Në pjesën përmbyllëse të orës së mësimit punohet me metodën, përpunim i njohurive.<br>Për të ndihmuar nxënësit në argumentim, mësuesi/ja shkruan në tabelë disa pyetje:<br>- Cilat ishin ndryshimet që sollën shpikjet e reja nëshkencë?<br>Ţ A ndryshoi raporti i punëtorit në lidhje me veglën e punës? Ţ Cilat ishin arritjet kryesore në fushën e komunikimit?<br>- Krahasoni revolucionin e parë dhe të dytë Industrial. |
| **Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për rindërtimin e njohurive, mënyrën se si përpunojnëdhe analizojnë informacionin historik. |
| **Detyrat dhe puna e pavarur:** Grumbulloni materiale nga interneti, literaturë historike për jetën dhe veprën e shkencëtarëve Belle e Markon. |

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori</td><td>Shkalla: III</td><td>Klasa: VII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore 2.25<br>Industrializimi dhe qytetërimi botëror</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:<br>Jepet tabela me rritjen e numrit të popullsisë në disa qytete europiane nga viti 1700 deri në vitin 1900. Nxënësit duhet të diskutojnë për arsyet e rritjes së numrit të popullsisë pas Revolucionit të Dytë Industrial. Cili ishte shkaku?A u rrit njësoj popullsisa në të gjitha qytetet?<br>viti 1700 – viti 1900<br>Birmingam 10.000 1.2 milionë<br>Berlin 60.000 2.4 milionë<br>Paris 500 000 3.3 milionë<br>Vjenë 110 000 1.6 milionë</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:<br>x diskuton mbi planet rregulluese të qyteteve europiane të fundit e shekullit XIX;<br>x argumenton strukturën sociale në vendet e zhvilluara;<br>x analizon lidhjen e ngushtë industri T bujqësi me procesin e urbanizmit.</td><td colspan="2">Fjalët kyç: treg botëror, periudha e bukur, urbanizim.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: teksti i historisë, materiale nga interneti, fotografi, Enciklopedi.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare:<br>• Shqyrton në mënyrë kritike veprimet e njerëzve në tëshkuarën.<br>• Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike e shoqërore.<br>• Parashtron pyetje kërkimore, duke u bazuar në argumente.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Lexim i orientuar, interpretim grafik (punë në grupe), turi i galerisë.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit:<br>▸ Në fillim të orës së mësimit, mësuesi/ja u kërkon nxënësve që të analizojnë tabelën mbi rritjen e numrit të popullsisë në qytetet europiane në vitet 1700 – 1900 (5 minuta).<br>▸ Leximi i orientuar: U kërkon nxënësve të lexojnë mësimin duke i orientuar të kuptojnë se cilat ishin fushat që pësuan ndryshime nga Revolucioni i Dytë Industrial.<br>▸ Interpretimi grafik: Pasi nxënësit kanë lexuar mësimin, mësuesi/ja bën ndarjen e klasës në grupe me nga 4 persona. Secili grup pajiset me fletë A3 (ose kartona), lapustila, për zhvillimin e detyrës. (Mësuesi/ja duhet t'i sigurojë më përpara mjetet e punës ose t'ua kërkojë nxënësve që t'i sjellin një orë më përpara, me qëllim që të mos krijohen vonesa gjatë orës së mësimit). Nxënësit duhet të punojnë për katërçështje, të cilat do t'i interpretojnë në mënyrë grafike në fletët A3 sipas modelit të dhënë në skemë.<br>– Cilët ishin elementet kryesore të urbanizmit? Cilat ishin shtresat e shoqërisë pas Revolucionit?</td></tr>
</table>







– **Cilët ishin faktorët që ndikuan në krijimin e tregut botëror?**







**Turi i galerisë:** Turi i galerisë është një teknikë, gjatë së cilës nxënësit ekspozojnë punimet e tyre në muret e klasës. Më pasvëzhgojnë punën e njëri – tjetrit dhe diskutojnë. Për t'i bërë sa më shumë pjesëmarrës, vihen edhe në garë që të gjejnë mangësi (në rast se ka) në punën e bërë nga secili grup.

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për interpretimin grafik të njohurive, diskutimet dhe raportet e punës në grup, përgjigjet individuale etj.

**Detyrat dhe puna e pavarur:** Analizoni shprehjen: "Periudhë e bukur". Si do ta mendonit ju "Periudhën e bukur" për vendin tuaj në fillim të shekullit XXI?

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkalla: III** | **Klasa: VII** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore 2.26 VEPRIMTARI PRAKTIKE**<br>Arritjet e Revolucionit të Dytë Industrial | | **Situata e të nxënit:**<br>Nxënësit rikujtojnë njohuritë e marra për Revolucionin e Dytë Industrial: zhvillimet e industrive kryesore, shpikjet në shkencë, mjekësi,emrat e shkencëtarëve të mëdhenj. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>x përcakton arritjet në shkencë dhe teknikë;<br>x analizon rrjedhojat e këtyre arritjeve;<br>x përgatit informacionin e nevojshëm mbi Revolucionin e Dytë Industrial;<br>x përdor mjetet e reja të informacionit dhe materialet e mbledhura në funksion të qëllimit të temës;<br>x demonstron aftësi për të punuar në grup;<br>x përgatit albume, postera, fletëpalosje sensibilizuese. | | **Fjalët kyç**: Bell, Markon, Edison, llampa elektrike, motori me djegie të brendshme, motori elektrik, makina e shtypit, vaksina e tuberkulozit. | |
| **Burimet:** teksti i Historisë, materiale nga Interneti, fotografi, Enciklopedi. | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare:**<br>• Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme, duke i klasifikuar ato sipas rëndësisë që kanë për temën.<br>• Zhvillon një kërkim individual ose në grup për kryerjen e një veprimtarie në histori.<br>• Siguron një sërë burimesh digjitale të informacionit dhe i analizon në mënyrë kritike këto burime historike. | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Punë me grupe, punë me gjithë klasën | | | |

**Organizimi i orës së mësimit:**

**Zhvillimi i veprimtarisë kalon në disahapa:**

I. Përsëritje e materialit mësimor
II. Ndarja enxënësve në grupe dhe përcaktimi i punës për secilin grup.
III. Grumbullimi dhe përzgjedhja e materialit mbi Revolucionin e Dytë Industrial, krijimi i një fotomontazhi ose posterave.
IV. Prezantimi i punës. Pasqyrimi i shpikjeve kryesore, fotografive të shkencëtarëve dhe të dhënave të tjera të gjetura nga nxënësit.

**Hapi I** (përgatitor)

Me rekomandimin e mësuesit/es, nxënësit përsëritin disa çështje të materialit mësimor që lidhen me temën, si për shembull:

- rikujto informacionet për jetën dhe veprën e shkencëtarëve Bell, Markon, Edison;
- përcakto rrjedhojat e shpikjes së motorit me djegie të brendshme;
- evidento figurat kryesore të shpikësve të Revolucionit të DytëIndustrial.

**Hapi II:** Ndarja e nxënësve në grupe dhe përcaktimi i punës për secilin grup. (Në varësi të numrit të nxënësve mësuesi/ja mund ta ndajë klasën në më shumë se tri grupe).

**Hapi III:** Grumbullimi dhe përzgjedhja e materialit mbi Revolucionin e Dytë Industrial.
Nxënësit pasi kanë grumbulluar materialin, bëjnë përzgjedhjen dhe punojnë për krijimin e fotografimontazhit ose posterave me arritjet e Revolucionit të Dytë Industrial.




**Hapi IV:** Prezantimi i punimeve të secilit grup, nxjerrja e përfundimeve e konkluzioneve dhe vlerësimi i veprimtarisë
Secili grup prezanton punën e tij. Nxirren konkluzionet, të cilat nxënësit i shënojnë në fletore.

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për gjetjen dhe përzgjedhjen e materialit (përdorimin e teknologjisë), punën në grup, përgjigjet individuale

**Detyrat dhe puna e pavarur:** Bëni një përshkrim të shkurtër: Si do të ishte bota pa Revolucionin e Dytë Industrial?

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori</td><td>Shkalla: III</td><td>Klasa: VII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore 2.27 Fillesa të demokracisë liberale në Britaninë e Madhe</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:<br>Një historian për Epokën Viktoriane shprehet: "Qetësia mbretëronte në skenën politike. Pranimi i ndërmarrjeve të lira ishte fakt, ekonomia ishte më e lulëzuar se kurrë. Tensionet midis klasave të ndryshme dhe kontradiktatishinzbutur".</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:<br>x evidenton veçoritë e zhvillimit të Britanisë së Madhe në fund të shek. XIX;<br>x përshkruan ndryshimet ekonomike dhe politike në Angli;<br>x vlerëson rolin e sistemit politik të dy partive për demokratizimin e Anglisë.</td><td colspan="2">Fjalët kyç: konservator, liberal, Viktoria, Gladston.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:teksti i Historisë, materiale nga Interneti, fotografi, Enciklopedi.</td><td colspan="2">• Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare:<br>• Parashtron pyetje kërkimore duke u bazuar në argumente.<br>• Identifikon burimet e nevojshme përinterpretimin e ngjarjevehistorike.<br>• Shfrytëzon të dhënat përtë demonstruar tëkuptuarite koncepteve historike dhe shoqërore.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Stuhi mendimesh, leximi i orientuar, metoda e akuariumit, bashkëbsedim: pyetje – përgjigje.</td></tr>
</table>

**Organizimi i orës së mësimit:**

- **Stuhi mendimesh**: Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalën "Anglia" dhe pyet nxënësit se çfarë kanë mësuar për Anglinë.




**Leximi i orientuar:** Orienton nxënësit të lexojnë mësimin dhe kërkonnga secili, në mënyrë individuale të përgatisë një pyetje dhe ta shënojë në një fishë prej letre. Në fishë, bashkë me pyetjen nxënësi shënon edhe emrin.

- **Akuariumi:** Vendoset në tavolinën e mësuesit një glob/akuarium (ose një kuti kartoni). Pasi nxënësit të kenë lexuar mësimin dhe të kenë përgatitur pyetjen, udhëzohen,që t'i hedhin të gjitha fishat në akuarium. (Çdo nxënës duhet të përgatisë patjetër një pyetje). Pasi tëkenë mbaruar të gjithë, mësuesi/ja fillon hap një e nga një fishat dhe lexon pyetjen bashkë meemrine nxënësit që e ka bërë pyetjen. Përgjigjen mund ta japin vetë nxënësit ose mësuesi/ja. (Sugjerim: Mësuesi/ja duhet të llogarisë kohën që të lexohen të gjitha pyetjet, me qëllim që çdo nxënës të ndihet i përfshirë. Kjo teknikë shoqërohet me një interes të madh nga nxënësit.)

| |
|---|
| ◗ **Bashkëbisedim pyetje – përgjigje:** Nëpërmjet bashkëbisedimit pyetje – përgjigje, nxënësit kuptojnë thelbin e mësimit. Mësuesi/ja në fund, përzgjedh pyetjet më thelbësore dhe më të rëndësishmedhe vlerëson nxënësit që i kanë bërë. |
| **Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për mënyrën se si analizojnë dhe komunikon informacionin historik, përqendrimin dhe pjesëmarrjen në orën e mësimit. |
| **Detyrat dhe puna e pavarur:** Grumbulloni të dhëna për jetën dhe veprimtarinë e Gladstonit dhe Dizraelit dhe i referoni ato në klasë. Kërkoni ndihmën e mësuesit dhe të prindërve. |

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori | Shkalla: III | Klasa: VII |
|---|---|---|---|

**Tema mësimore 2.28**
**Fillesat e demokracisë liberale në Francë**

**Situata e të nxënit:**
Nxënësve u kërkohet të rikujtojnëluftën frankoͲprusiane të viteve 1870 – 1871. Përse u zhvillua?

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**
- evidenton veçoritë kryesore të zhvillimit të Francës në fund të shek. XIX;
- përshkruan ngjarjet e Komunës së Parisit të vitit 1871;
- analizon arsyet që kushtëzuan fitoren e rendit republikan.

**Fjalët kyç**: radikal, Antisemitizëm, Revanshizëm.

**Burimet:** teksti i Historisë, materiale nga Interneti, fotografi, Enciklopedi.

- **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare:**
- Parashtron pyetje kërkimore, duke ubazuar nëargumente.
- Identifikonburimet e nevojshme për interpretimin e ngjarjeve historike.
- Shfrytëzon të dhënat përtë demonstruar tëkuptuarite koncepteve historike dhe shoqërore.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Parashikim me terma paraprakë, punë dyshe, harta e koncepteve.

**Organizimi i orës së mësimit:**
- **Parashikim me terma paraprakë (punë individuale):** Mësuesi/ja shkruan në tabelë termat*: **lufta franko – prusiane, Komuna e Parisit, krahina e Alcas – Lorenës, shtet huadhënës, Adolf Tier, Republika e Tretë, kontroll i forcave monarkiste, tronditje politike etj**. Pasi nxënësit të kenë lexuar mësimin, duhet të formojnë nga një fjali që shpjegon termat e mësipërm.*
- **Punë dyshe**: Pasi nxënësit kanë shkruar në fletoren e tyre shpjegimin e termave, vihen të punojnë në dyshe dhe të krahasojnë përgjigjet me njëri – tjetrin. Njëri nga nxënësit shkruan përgjigjen e saktë që e kanë vendosur së bashku. Mësuesi/ja shkruan në tabelë përgjigjet përfundimtare.
- **Harta e koncepteve**: Informacionin e marrë nga tema mësimore, nxënësit e paraqesin në hartën e koncepteve.




**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për përpunimin dhe paraqitjen e informacionit, bashkëpunimin me njëri – tjetrin.

**Detyrat dhe puna e pavarur: Gjeni informacione nga Interneti për ngjarjet e Komunës së Parisit të vitit 1871.**

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** Dt.___/___/__

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** Dt.___/___/__

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkalla: III** | **Klasa: VII** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore 2.29**<br>**Fillesat e demokracisë liberale nëGjermani** | | **Situata e të nxënit:**<br>Jepet fotografi ku tregohet ceremonia e bashkimit të Gjermanisë. Nxënësit komentojnë fotografinë. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>x diskuton në klasë për arsyet e zhvillimit të shpejtë ekonomik të Gjermanisë;<br>x vlerëson rolin e faktorit "disiplinë gjermane";<br>x përcakton drejtimet kryesore të politikës së brendshme dhe të jashtme të Bismarkut. | | **Fjalët kyç**:<br>Ligji i jashtëzakonshëm, Rruga prusiane e bujqësisë, shtet i lirë popullor. | |
| **Burimet:** teksti i Historisë, materiale nga Interneti, fotografi, Enciklopedi. | | • **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare:**<br>• Identifikon burimet e nevojshme përinterpretimin e ngjarjevehistorike.<br>• Shfrytëzon të dhënat përtë demonstruar tëkuptuarite koncepteve historike dhe shoqërore.<br>• Zhvillon mendimin kritikpër të interpretuar të shkuarën nëpërmjetinformacionit. | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Di, Dua të di, Mësova, Rishikim në dyshe.

**Organizimi i orës së mësimit:**

**Di**. Mësuesi/ja vizaton në tabelë organizmin grafik prej tri kolonash, ndërsa nxënësit e vizatojnë atë në fletoren e punës. U kërkohet nxënësve të thonëçfarë dinë apo mendojnë për temën e re dhe ata i shënojnë në kolonën e parë: Di – çfarë di?

**Dua të di.** Ndërkohë që nxënësit lexojnë informacionin e ri, iu kërkohet të formulojnë pyetjet duke i shkruar në kolonën e dytë: Dua të di – çfarë dua të di?

**Mësova.** Pasi kanë përfunduar leximin e temës, përqëndrohen te kolona e tretë. Pyeten nxënësit për informacionin e ri, duke iu përgjigjur pyetjeve që ndodhen në kolonën e dytë: "Dua të di". Nxënësit në mënyrë të pavarur plotësojnë kolonën e tretë "Mësova" në fletoren e punës.

| Di | Dua të di | Mësova |
|---|---|---|
| – Gjermania u bashkua në 18 janar 1871.<br>– Bashkimi i saj u arrit nëpërmjet luftës<br>– Bismarku mbahet si arkitekt i krijimit të Gjermanisë së bashkuar etj. | – Cila ishte situata në Gjermani pas bashkimit?<br>– Cilat ishte gjendja e saj ekonomike?<br>– Cilat ishin zhvillimet e reja politike?<br>– Cila ishte politika e saj e jashtme?<br>– Cilat ishin arsyet e dorëheqjes së Bismarkut?<br>– Çfarë ndodhi në Gjermani pas dorëheqjes së Bismarkut?<br>– Cilat ishin arsyet që Gjermania hyri në rrugën e armatimit etj . | – Pas bashkimit ndodhën ndryshime të mëdha ekonomike dhe politike.<br>– Në fund të shekullit XIX, Gjermania doli në vendin e dytë në botë për prodhimin e përgjithshëm.<br>– Perandori kishte kompetenca shumë të gjera.<br>– Bismarku ishte kancelari i Gjermanisë.<br>– Në politikën e jashtme, Gjermania donte të rriste influencën e saj në Europë duke ulur ndikimin anglez dhe francez etj. |

**Rishikim në grupe**. Nxënësit krahasojnë më njëri – tjetrin pyetjet dhe përgjigjet që kanë ngitur rreth mësimit, duke gjetur çfarë kanë të përbashkët dhe të veçantë në pyetje – përgjigjet që kanë formuluar.

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për përqendrimin gjatë punës, përvetësimin e njohurive, të menduarit dhe të shprehurit, mënyrën e të argumentuarit rreth pyetjeve.

**Detyrat dhe puna e pavarur:** Vlerësoni rolin e faktorit "disiplinë gjermane". Çfarë mësimi nxjerr për vete dhe shokët e tu nga përvojagjermane?

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkalla: III** | **Klasa: VII** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore 2.30 Fillesat e demokracisë liberale në SHBA** | | **Situata e të nxënit:** *Amerika u bë vendi i një populli me energji të mëdha, tek i cili shpirti i iniciativës nuk njihte masë. Amerikanët patën për hyjni Biblën, Kushtetutën amerikane dhe dollarin. "Ëndrra Amerikane" kishte si hero njeriun që e kishte filluar nga asgjëja, por që arrinte të bëhej milioner.*  | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:** x evidenton gjendjen e SHBA pas Luftes Civile; x përcakton rolin e sistemit politik te dy partive; x analizon drejtimet kryesore të politikes së jashtme të SHBAT së. | | **Fjalët kyç:** truste, Ligji Sherman, Panamerikanizëm. | |
| **Burimet:** teksti i Historisë, materiale nga Interneti, fotografi, Enciklopedi | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:** • Parashtron pyetje kërkimore për realizimin e studimit historik. • Identifikon burimet e nevojshme për interpretimin e ngjarjeve historike. • Shfrytëzon të dhënat për të analizuar informacionin historik. | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Bisedë e lirë, leximi kuiz, harta e koncepteve. | | | |

**Organizimi i orës së mësimit:**

- **Bisedë e lirë.** Mësuesi/ja shkruan në tabelë: "SHBATja është vendi më demokratik në botë" dhe u drejton nxënësve disa pyetje:
  – *Si e kuptoni këtë shprehje? T A jeni dakort? T Nëse po, pse mendoni se është kështu?*
- **Leximi Kuiz:** E vërtetë apo e gabuar. Pas mbarimit të bashkëbisedimit, mësuesi/ja ukërkon nxënësve të lexojnë mësimin. Ndërkohë shkruan në tabelë fjali të ndryshme të marra nga mësimi,të cilat, i shkruan ashtu siç janë në libër ose në formë të gabuar.
  P.sh.*: Në vitin 1893, SHBATja doli në* ***vendin e tretë*** *në botë përsa i përket prodhimit të përgjithshëm industrial,* (versioni i gabuar i fjalisë).
  *Në vitin 1893, SHBATja doli në* ***vendin e parë*** *në botë përsa i përket prodhimit të përgjithshëm industrial. (versioni i saktëi fjalisë)*
  Në këtë fjali togfjalëshi ku është bërë ndryshimi është "vendin e parë".
  Ose: *Në jetën politike amerikane rol përcaktues vazhduan të luanin* ***Partia Komuniste*** *dhe ajo* ***Konservatore*** *(versioni i gabuar).*
  *Në jetën politike amerikane rol përcaktues vazhduan të luanin* ***Partia Republikane*** *dhe ajo* ***Demokratike*** *(version i saktë).*

  Pasi mësuesi/jaka shkruar të gjitha fjalitë në tabelë dhe nxënësit kanë mbaruar së lexuari mësimin u kërkon që të gjejnë se cila nga fjalitë është e saktë dhe cila është e gabuar. Kujdes! Mësuesi/ja duhet të shkruajë fjali që japin përmbajtjen kryesore të mësimit. Kjo metodë e bën shumë interesante orën e mësimit, nxënësit përfshihen dhe vihen në garë për gjetjen e përgjigjeve.
- **Harta e koncepteve.** Pas mbarimit të analizimit të pyetjeve, ndërtohet dhe harta e koncepteve.




**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për mënyrën se si analizojnë dhe komunikojnë informacionin historik, përqendrimin dhe pjesëmarrjen në orën e mësimit.

**Detyrat dhe puna e pavarur: Shprehni mendimin tuaj Pro dhe Kundër**
Duke analizuar formën e qeverisjes në SHBA, shprehni opinionin tuaj duke e krahasuar më formën e qeverisjes nëShqipëri. A ka të përbashkëta midis tyre? (Pyesni prindërit ose më të rriturit).

# Test (tremujori II)

**Emri, mbiemri: ______________________** **Grupi A**

**1. "Peticioni mbi të drejtat" në Angli kufizonte pushtetin e:** **1 pikë**
a. Parlamentit
b. Mbretit
c. Ushtrisë
d. Borgjezisë

**2. 13 kolonitë e Amerikës e shpallën pavarësinë e tyre nga Anglia në:** **1 pikë**
a. Shtator 1765
b. Janar 1770
c. Korrik 1776
d. Qershor 1680

**3. Goditjen përfundimtare, Napoleon Bonaparti e mori në:** **1 pikë**
a. Betejën e Lajpcigut
b. Betejën e Vaterlosë
c. Betejën e Austrisë
d. Luftën me Rusinë

**4. Shteti që udhëhoqi bashkimin e Gjermanisë ishte** **1 pikë**
a. Austria
b. Polonia
c. Prusia
d. Spanja

**5.Reformat me emrin Tanzimat në Perandorinë Osmane i ndërmori:** **1 pikë**
a. Sulltan Selimi III
b. Sulltan Abdyl Mexhiti
c. Sulltan Murati II
d. Sulejmani I

**6. Sistemi politik i dy partive nëAngli:** **1 pikë**
a. I siguroi vendit qetësinë e domosdoshmepolitike
b. Krijoi pasiguri nëvend
c. Tëdyja
d. Asnjëra

**7. Shpjego termat:** **4 pikë**
a. Monarki Parlamentare

______________________________________________________________

b. Treg botëror

___

c. Luftë civile

___

d. Nacionalizëm………………………………………………………………………………………………………………

**8. Shëno e vërtetë (V), e gabuar (G)** **5 pikë**

a. Lidhja e Shenjtë e krijua për të mbrojtur regjimet monarkiste në Evropë. (……)
b. Partitë kryesore në Angli në fund të shekullit XIX ishin Partia Liberale dhe Konservatore (……)
c.Revolucioni i Dytë Industrial NUK solli ndryshime në shkencë (.....)
d. Revolucioni francez i vitit 1789 rrëzoi parlamentarizmin në Francë (.....)
e. "Deklaratën e Pavarësisë" në SHBA e hartoi Tomas Xheferson(……)

**9.Lidh me shigjetë:** **6 pikë**

| | |
|---|---|
| a. Napoleon Bonaparti | Rritja dhe zhvillimi i qyteteve |
| b. Honore de Balzak | Drejtues i Partisë Liberale në Angli |
| c. Urbanizim | Internohet në ishullin Shën Helenenga anglezët |
| d. Bell | Bashkime të industrive kapitaliste |
| e. Uilliam Gladston | Përfaqësues i letërsisë realiste |
| f. Truste | Shpiku telefonin në vitin 1876 |

**10. Rendit shtresat e shoqërisë që u krijuan pas Revolucionit të Dytë Industrial 4 pikë**

1.
2.
3.
4.

**11.Vendos në mënyrë kronologjike 1, 2,3, duke u bazuar në periudhën qëështë zhvilluar secila nga ngjarjet e mëposhtme:** **3 pikë**

- Shpallja e Pavarësisë së SHBA-së _____
- Dita kombëtare e Francës ______
- "Revolucioni i lavdishëm" në Angli _____

**12. Arsyeto: Pse kushtetuta amerikane e vitit 1878 ishte kushtetuta e parë më demokratike në botë?** **3 pikë**

___
___
___
___
___

| **Notat** | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Pikët** | 0T7 | 8T11 | 12T15 | 16T19 | 20T23 | 24T27 | 28T31 |

## **Test** (tremujori II)

**Emri, mbiemri____________________** **Grupi B**

**1. Monarkia Kushtetuese në Angli u vendos nëpërmjet:** **1 pikë**
a. Revolucionit të lavdishëm
b. Revolucionit të armatosur
c. Kryengritjes së borgjezisë
d. Asnjëra nga të tria

**2. Kushtetuta e vitit 1787 në SHBA mbështetej në:** **1 pikë**
a. Qeverisjen absolute të mbretit
b. Qeverisjen e mbretit dhe të parlamentit
c. Pushtetin absolut të presidentit
d. Parimin e ndarjes së pushteteve

**3. Revolucioni francez u zhvillua më** **1 pikë**
a. 15 maj 1760
b. 21 dhjetor 1800
c. 14 korrik 1789
d. 4 qershor 1810

**4. Luftën e armatosur për bashkimin e Italisë e udhëhoqi:** **1 pikë**
a. Kamilo Kavui
b. Xhuzepe Garibaldi
c. Xhuzepe Maxini
d. Karli I

**5. Reformat e Tanzimatit kishin si qëllim:** **1 pikë**
a. Ndërtimin e një shteti osman sipas modelit europian
b. Ndërtimin e një shteti europian sipas modelit osman
c. Ndërtimin e një shteti osman sipas modelit rus
d. Ndërtimin e një shteti rus sipas modelit osman

**6. Republika e Tretë në Francë u formua nga:** **1 pikë**
a. Bashkëpunimi i forcave politike
b. Rritja e rolit të mbretit
c. Krijimi i Komunës së Parisit
d. Përçarja e forcave monarkiste

**7. Jep shpjegimin e fjalëve:** **4 pikë**
a. Monarki Absolute

______________________________________________

b. Revolucion Industrial

______________________________________________

c. Periudha e Restaurimit

______________________________________________________________

d. Realizëm ______________________________________________________

**8. Shëno e vërtetë (V), e gabuar (G): 6 pikë**

a. Lufta civile në SHBA u zhvillua midis Jugut skllavopronar dhe Veriut të industrializuar (……)
b. Bismarku ishte kancelari i Gjermanisë së bashkuar. (……)
c. Bashkimi i Italisë u arrit nëpërmjet bisedimeve dhe marrëveshjeve me austriakët.(……)
d. Llambën elektrike e shpiku Tomas Edison. (……)
e. Mbretëresha Viktoria kishte vendosur Monarkinë Absolute në Angli. (……)
f. "Sistemi politik i dy partive" solli qëndrueshmëri politike në SHBA (……)

**9. Lidh me shigjetë: 6 pikë**

a. Xhorxh WashingtonDekret i sulltanit që shpalli reforma te reja në Perandorinë Osmane
b. Hati – Sherifi i GjylhanesëIniciatori i Lidhjes së Shenjtë (……)
c. Çarl Dikens Presidenti i parë i SHBATsë (……)
d. CarAleksandri I Regjim që u vendos në Francë për të mposhtur armiqtë e revolucionit (……)
e. Regjim i Terrorit Nxori ligjin për heqjen e skllavërisë
f. Abraham LinkolnShkrimtar i letërsisë realiste (……)

**10. Rendit shtesat e shoqërisë në Francë në prag të Revolucionit të vitit 1789 3 pikë**

1. ……………………………………………………………….
2. ……………………………………………………………….
3. ……………………………………………………………..

**11.Rendit në mënyrë kronologjike 1,2,3, sipas përdorimit kohor, forcat që ndikuan në zhvillimet e ekonomisë: 3 pikë**

Forca e avullit______ Forca e krahut______ Forca e ujit______

**12. Krahaso Monarkinë Absolute me Monarkinë Parlamentare?: 3 pikë**

______________________________________________________________
______________________________________________________________
______________________________________________________________
______________________________________________________________
______________________________________________________________
______________________________________________________________
______________________________________________________________
______________________________________________________________
______________________________________________________________
________________________________

| **Notat** | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Pikët** | 0T7 | 8T11 | 12T15 | 16T19 | 20T23 | 24T27 | 28T31 |

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE**

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori</td><td>Shkalla: III</td><td>Klasa: VII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore 2.31<br>Përsëritje (4)Temat 2.17 – 2.30</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Nxënësi përsërit temat 2.17T2.30 Fisha dhe kuize. Nxënësit u japin përgjigje pyetjeve dhe dikutojnë rreth tyre.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:<br>x kupton, zhvillon dhe ndërton kompetencat dhe konceptet historike mbi temat 2.17T2.30;<br>x aftësohet për t'i përdorur ato në analizën e ngjarjeve;<br>x zgjeron njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat e tij në lëndën e Historisë, duke arritur progres.</td><td colspan="2">Fjalët kyç:<br>Revolucioni II Industrial, urbanizim, tregu botëror, Anglia, Franca, Gjermania, SHBA, Rusia.<br></td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: teksti Historia 7, materiale nga Interneti.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare: Gjeografia, Ekonomia, Artet.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:Punë individuale, zgjidhja e problemit.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit:<br>Mësuesi në orën e fundit i ka informuar nxënësit që gjatë kësaj ore mësimore do të zhvillojnë përsëritjen e temave 2.17T2.30. E nis mësimin duke i pyetur për ndonjë gjë të paqartë që kanë hasur gjatë përsëritjes.<br>Më pas u shpërndan fishat me nga dy deri në tri pyetje gjithsecilit.<br>Disa nga pyetjet po i rendisim më poshtë:<br>1 Cilat ishin rrethanat e mbajtjes së Kongresit të Vjenës?<br>2 Ç'kuptoni me Nacionalizëm?<br>2. Cilat ishin shkaqet e lindjes dhe përhapjes së Nacionalizmit?<br>3. Si ku krijua Perandoria austro – hungareze?<br>4. Në cilat fusha u ndje ndikimi i Revolucionit II Industrial?<br>5. Përse motori me djegie të brendshme e zëvendësoi motorin me avull?<br>6. A u përdor dhe në komunikim motori me djegie të brendshme? Nëse po, ku?<br>7. Cilat ishin arsyet e rritjes së numrit të popullsisë nëpër qytete pas Revolucionit të Dytë Industrial?<br>8. Nga u gjetën këta banorë që shtuan numrin e qyteteve?<br>9. Numri i të punësuarve në fshat u shtua apo u pakësua? Përse mendoni kështu?<br>10. Ç'kuptoni me urbanizim?<br>11. Përse ndryshoi struktura e shoqërisë në fund të shekullit XIX?<br>12. Si ndikoi Revolucioni II Industrial në krijimin e tregut botëror?<br>13. Përse Anglia humbi pozitën sunduese në ekonominë botërore?<br>14. Ç'politika ndoqën partitë kryesore në Angli: Partia liberale e drejtuar nga Uilliam Gladston dhe konservatorët nga Benzhamin Dizraeli.<br>15. Ç'formë regjimi u mundua të vendoste Komuna e Parisit?<br>16. Përse u vendos Republika III në Francë?<br>17. Cilët ishin faktorët e zhvillimit ekonomik të Gjermanisë?<br>18. Cilat ishin politikat e brendshme dhe të jashtme të Bismarkut?<br>19. Dorëheqja e Bismarkut përmirësoi apo keqësoi gjendjen politike në Europë?<br>20. Cilët ishin faktorët e zhvillimit ekonomik të SHBATsë pas Luftës Civile?<br>21. Cili ishte roli i sistemit dypartiak në SHBA?<br>Kompetencat që përfitojnë: kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, e të menduarit, e të nxënit.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Vlerësimi: Vrojtimet e mësuesit, lista e kontrollit.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Detyrat dhe puna e pavarur: Diagrami i Venit: SHBA –ja dhe Rusia, dy superfuqitë e ardhshme.</td></tr>
</table>

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkalla: III** | **Klasa: VII** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore** 2.32<br>Veprimtari(6). "Monarkët e ndriçuar. Roli i Pjetrit të Madh në europianizimin e Rusisë" . | **Situata e të nxënit:** Në internet gjenden informacione të shumta për Pjetrin e Madh të Rusisë. A munden nxënësit t' gjejnë ato? A mund të bashkëpunojnë në grup? |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>x përgatit informacionin e nevojshëm mbirolin e Pjetrit të Madh në europianizimin e Rusisë;<br>x përdor mjetet e reja të informacionit dhe materialet e mbledhura në funksion të qëllimit tëtemës;<br>x demonstron aftësipër të punuar në grup. | **Fjalët kyç**: Pjetri i Madh, Europa, Rusia, reforma, kulturë, gastronomi, jeta shoqërore, europianizim.<br> |
| **Burimet:** Interneti, katalogë, fotografi të ndryshme, udhëzues, libra historikë etj. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:** artet, letërsia, informatika. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** punë individuale, punë në grupe dyshe.

**Organizimi i orës së mësimit:**
Mësuesi e ndan temën në katër nëntema:
a. Sistemimi i njohurive të marra nëhistori
b. Përdorimi i Internetit dhe sistemimi imaterialeve sipas kohës.
c. Grumbullimi dhe pasqyrimi i rolit të Pjetrit të Madh në europianizimin e Rusisë.
d. Krijimi i posterave, fletëpalosjeve, punimeve për temën.
Më pas ndahen detyrat:
a. Ndahen nxënësit në grupe dhe përcaktojnë punën.
b. Zgjidhen liderët e grupeve dhe hidhen idetë për punën.
Zhvillimi i veprimtarisë kalon në disa hapa:
Hapi 1: Me rekomandimin e mësuesit/es, nxënësit përsëritin disa çështje të materialit mësimor që lidhen me temën, si për shembull:
a. Evidentoni figurën kryesore, atë të Pjetrit tëMadh.
b. Cilat ishin reformat që ndërmoriai?
c. Evidentoni rrjedhojat e masave të Pjetrit të Madh në europianizimin eRusisë.
Hapi 2: Ndarja e grupeve dhe e detyrave për secilin grup.
Grupi 1: Kontributet në arsim.
Grupi 2: Kontributet në art.
Grupi 3: Kontributet në jetën shoqërore.
Hapi 3: Nxjerrja e përfundimeve, prezantimi ipunimeve të secilitgrup. Konkluzione dhe vlerësime.
*Kompetencat që përfitojnë*: kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, e të menduarit, e të nxënit, personale, kompetenca digjitale.

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për punën individuale dhe në grup.

**Detyrat dhe puna e pavarur:** Hulumtim i pavarur në Internet. Faqe sugjeruese:
http://www.forumishqiptar.com/threads/21173-Pjetri-i-Madh-Njeriu-qe-modernizoi-Rusine

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori | Shkalla: III | Klasa: VII |
|---|---|---|---|

**Tema mësimore** 2.33
Veprimtari (7) “Demokracia liberale në ambientin tonë shkollor”.

**Situata e të nxënit:** Në Internet gjenden informacione të shumta për demokracinë liberale. A funksionon ajo në shkollën tonë? Si? A është e dukshme? Mund ta paraqesim atë me anë të një fotomontazhi apo videoje?

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**

x përgatit informacionin e nevojshëm mbi domosdoshmërinë e demokracisë në shkollë e kudo;
x përdor mjetet e reja të informacionit dhe materialet e mbledhura në funksion të qëllimit të temës;
x demonstron aftësi për të punuar në grup;
x përgatit albume, postera, fletëpalosje sensibilizuese.

**Fjalët kyç**:
demokraci, demokraci liberale, album, sensibilizim.




**Burimet:** Interneti, katalogë, fotografi të ndryshme, udhëzues, libra historikë etj.

**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:** Letërsia, Informatika.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Punë individuale, punë dyshe, punë në grup.

**Organizimi i orës së mësimit:**
Mësuesi e ndan temën në katër nëntema:
a. Sistemimi i njohurive të marra nëhistori.
b. Përdorimi i Internetit dhe sistemimi imaterialeve sipas kohës.
c. Grumbullimi i materialeve për të pasqyruar marrëdhëniet korrekte, pa dallime gjinie, besimi, kulture.
d. Krijimiiposterave, fletëpalosjeve, punimevepërtemën.
Më pas ndahen detyrat:
a. Ndahennxënësitnëgrupedhepërcaktojnëpunën.
b. Zgjidhen liderët e grupeve dhe hidhen idetë për punën.
Zhvillimi i veprimtarisë kalon në disahapa:

**Hapi 1:** Me rekomandimin e mësuesit/es, nxënësit përsëritin disa çështje të materialit mësimor që lidhen me temën, si për shembull:
a. Ç’kupton me “Demokraci liberale”?
b. Cilat janë marrëdhëniet mes grupimeve të ndryshme në ambientet e shkollës?
c. Evidento raste pozitive në këto marrëdhënie.

**Hapi 2:** Ndarja e grupeve dhe e detyrave për secilin grup.
Grupi 1: Grupi i djemve. Grupi 2: Grupi i vajzave.
Përgatitja e një albumi (ose poster apo fletëpalosjeje) për mënyrën se si funksionon demokracia liberale në mjedisin shkollor.
**Hapi 3:** Nxjerrja e përfundimeve, prezantimi ipunimeve të secilit grup. Konkluzione dhe vlerësime.
*Kompetencat që përfitojnë*: kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, kompetenca digjitale.

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për punën individuale dhe në grup.

**Detyrat dhe puna e pavarur:** Hulumtim në Internet. Faqe të sugjeruara:
http://www.forumishqiptar.com/threads/43897-Çfarë-është-demokracia

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** Dt.___/____/__

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori</td><td>Shkalla: III</td><td>Klasa: VII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore 2.34 Imperializmidhe Nacionalizmi i skajshëm në fund të shekullit XIX</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Që nga Kongresi i Berlinit 1878 deri në vitin 1900, më shumë se 100 milionë njerëz në mbarë botën janë "kolonizuar". Kolonializmi ishte dukuria kryesore e shek XIX. Nga një përvojë tregtare kthehet në një pushtim ushtarak, territorial, skllavërim dhe shfrytëzim.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:<br>x përcakton faktorët e lëvizjes së popullsisë drejt Amerikës;<br>x evidenton faktorët që kushtëzuan shtimin e rivalitetit midis shteteve të mëdha;<br>x diskuton në klasë lidhur me imperializmin dhe militarizmin.</td><td colspan="2">Fjalët kyç: tregu botëror, kolonizim, Imperializëm, Militarizim</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: Karl Grimberg ,“Historia Botërore dhe Qytetërimi”, materiale nga Interneti, You tube, dokumenta historikë etj</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare:<br>Letërsia, Informatika.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Stuhi mendimesh, harta e mendimeve, punë individuale.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit:<br>Mësuesi e organizon këtë orë mësimi duke lidhur njohuritë e mëparshme me ato përfundime që kërkohen për t’u arritur gjatë kësaj ore me anë të teknikës së stuhisë së mendimeve.<br>1.Cilat qenë pasojat e Revolucionit IIIndustrial lidhur me lëvizjen e popullsisë dhe urbanizimin?<br>2.Si ndikoi modernizimi i transportit hekurudhor dhe detar në zhvendosjen e popullsisë?<br>3.Në cilat vende u përqendrua ky migrim i popullsisë?<br>Për çështjen e dytë dhe të tretë, mësuesi ndan nxënësit në dy pjesë që ta lexojnë atë dhe ti përgjigjen hartës së mendimeve:<br><br><br>Kompetencat që përfitojnë: kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, e të menduarit, e të nxënit.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për punën individuale në plotësimin e hartës së të pyeturit, aktivizimin gjatë orës së mësimit.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Detyrat dhe puna e pavarur: Ese “Rruga nga Revolucioni II Industrial deri te Imperializmi direkt”.</td></tr>
</table>

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori</td><td>Shkalla: III</td><td>Klasa: VII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore 2.35 Veprimtari<br>Marrëdhëniet e Europës me botën koloniale(Ndërtimi i një fotomontazhi “Jeta në kolonitë e Azisë, Afrikës dhe të Amerikës Latine”)</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Në Internet gjenden informacione të shumta për marrëdhëniet e Europës me kolonitë e saj. Mund ta paraqesim atë me anë të një fotomontazhi apo videoje?</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:<br>x përgatit informacionin e nevojshëm mbi jetën në kolonitë e Azisë dhe Afrikës;<br>x përdor mjetet e reja të informacionit dhe materialet e mbledhura në funksion të qëllimit të temës;<br>x demonstron aftësi për të punuar në grup;<br>x përgatit një fotografimontazh, postera: Jeta në kolonitë e Azisë, Afrikës dhe Amerikës Latine.</td><td colspan="2">Fjalët kyç: Azia, Afrika, Amerika Latine, kolonizatorë, koloni.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: Fotografi nga Interneti dhe revista historike e gjeografike për kolonizimin e Afrikës, Azisë dhe Amerikës Latine.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare: Gjeografia, letërsia, Informatika.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:Punë në grup, metodë hulumtim Tkërkimit.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit:<br>Mësuesi e ndan temën në katër nëntema:<br>a. Sistemimi i njohurive të marra nëhistori.<br>b. Përdorimi i Internetit dhe sistemimi imaterialeve sipas kohës.<br>c. Grumbullimi i materialeve mbi jetën në kolonitë e Azisë dhe Afrikës.<br>d. Krijimiiposterave,fletëpalosjeve,punimevepër temën.<br>Më pas ndahen detyrat:<br>a.Ndahennxënësitnëgrupedhepërcaktojnëpunën.<br>b. Zgjidhen liderët e grupeve dhe hidhen idetë për punën.<br>Zhvillimi i veprimtarisë kalon në disahapa:<br>Hapi 1: Me rekomandimin e mësuesit/es, nxënësit përsëritin disa çështje të materialit mësimor që lidhen me temën, si për shembull:<br>a. Si paraqitej gjendja e Azisë dhe e Afrikës para kolonizimit tëtyre?<br>b. Si paraqitej gjendja e Azisë dhe e Afrikës pas kolonizimit tëtyre?<br>c. Ç’politikë ndoqën shtetet europiane për të realizuar qëllimet etyre?<br>Hapi 2: Ndarja e grupeve dhe e detyrave për secilingrup.<br>Grupi 1:Gjendja e Azisë dhe Afrikës para kolonizimit.<br>Grupi 2: Gjendja e Azisë dhe Afrikës pas kolonizimit.<br>Grupi 3: Politikat e shteteve europiane.<br>Hapi 3: Nxjerrja e përfundimeve, prezantimi ipunimeve të secilitgrup. Konkluzione dhe vlerësime.<br>Kompetencat që përfitojnë: kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, e të menduarit, e të nxënit,personale, kompetenca digjitale.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për punën individuale dhe në grup dhe për gjetjen dhe përzgjedhjen e informacionit.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Detyrat dhe puna e pavarur: Plotësoni hartën skicë koloniale të botës.</td></tr>
</table>

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkalla: III** | **Klasa: VII** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore 2.36**<br>Pashallëqet shqiptare. Zgjimi i ndërgjegjes kombëtare në Shqipëri gjatë shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX | **Situata e të nxënit:** Fuqizimi i lëvizjes çlirimtare gjatë shekullit XIX përgatiti kushtet për krijimin e shtetit të pavarur shqiptar. Rritja e ndjenjës kombëtare i ndihmoi shqiptarët të kapërcenin përçarjet e brendshme dhe të bashkoheshin për një qëllim të përbashkët; mbrojten e kombit dhe atdheut. |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>x përshkruan gjendjen e Shqipërisë pas fillimit të shekullit XIX;<br>x evidenton rëndësinë e Rilindjes Kombëtare Shqiptare;<br>x argumenton procesin e kalimit nga kërkesa për një Shqipëri autonome në atë për formimin e shtetit të pavarur shqiptar. | **Fjalët kyç**: Perandoria Osmane, Pashallëqet, Rilindja Kombëtare, Traktati i Shën Stefanit, Kuvendi i Prizrenit, Mësonjëtorja shqipe.<br>  |
| **Burimet:** Historia 7, Historia e Popullit Shqiptar, materiale nga Interneti, fotografi të pashallëqeve, Rilindësve, Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare:** Gjeografia, letërsia. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Stuhi mendimi, tabela e koncepteve

**Organizimi i orës së mësimit**



Mësuesi u tregon nxënësve temën mësimore dhe më pas i ndan në tri grupe për të lexuar çdo grup nga një çështje mësimi. Më pas ai i drejton pyetjet e mëposhtme:

a. Cila ishte gjendja e shqiptarëve nën Perandorinë Osmane?
b. Ku u mbështet sulltani në administrimin e trojeve shqiptare?
c. Ç'ishin pashallëqet?
ç. Ç'ishte Rilindja Kombëtare Shqiptare dhe cilët ishin Rilindësit shqiptarë?
d. Ç'vendime mori Traktati i Shën Stefanit i 3 marsit 1878 lidhur me trojet shqiptare?
dh. Përse u mbajt Kuvendi i Prizrenit? Ç'vendime mori ai?
e. Ç'kuptoni me "zgjim i ndërgjegjes kombëtare"? A ishte i nevojshëm ky zgjim?
ë. Kur u hap Mësonjëtorja e parë shqipe në Korçë? Cilat ishin vlerat e saj?
Në fund nxënësit plotësojnë tabelën e koncepteve:






*Kompetencat që përfitojnë*: kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, e të menduarit, e të nxënit.

**Vlerësimi:** Vlerësim për detyrat individuale.

**Detyrat dhe puna e pavarur:** Komentoni rolin që pati Rilindja Kombëtare Shqiptare në zgjimin e ndërgjegjes kombëtare dhe në Shpalljen e Pavarësisë.

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori</td><td>Shkalla: III</td><td>Klasa: VII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore 2.37<br>Ese argumentuese: “Kontributi i Rilindjes Kombëtare në mbrojtje të çështjes shqiptare”</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Rilindësit ishin frymëzimi i çdo patrioti shqiptar në mbrojtje të çështjes shqiptare.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:<br>x vlerëson kontributin e Rilindjes Kombëtare në mbrojtje të çështjes shqiptare;<br>x evidenton figura të rëndësishme të Rilindjes Kombëtare;<br>x shfaq krenari për vendin e tij;<br>komunikon lirshëm mendimet e tij.</td><td colspan="2">Fjalët kyç: Rilindje Kombëtare, Naum Veqilharxhi, Konstandin Kristoforidhi, Naim Frashëri, Sami Frashëri, Çerçiz Topulli, Bajo Topulli, Mihal Grameno<br><br></td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: Historia 7, Historia e Popullit Shqiptar, materiale nga interneti, fotografi të Rilindësve, Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare:Letërsia, artet.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve.Punë individuale, hulumtim.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit:<br>Orientohen nxënësit për trajtimin e temës duke u mbështetur te kompetencat.<br>Struktura e esesë<br>Nxënësit duhet të përfshijnë në punimin e esesë të paktën 3 argumente që nxjerrin në pah kontributin e Rilindjes Kombëtare në mbrojtje të çështjes shqiptare.<br><br>Pashko Vasa<br>Ndër argumentet që ata mund të përdorin janë:<br>a. Kontributi diplomatik – shoqëritë e parabrenda dhe jashtë vendit etj.<br>b. Kontributi letrar – shkrimet e figurave të rëndësishme, si: Naum Veqilharxhi, Kostandin Kristoforidhi, Naim e Sami Frashërietj.<br>c. Kontributi në frymën e revoltës – veprimet e komitëve, si: Çerçiz e Bajo Topulli, Mihal Grameno etj.<br><br><br><br>Nxënësit shkruajnë esenë, duke shpjeguar në hyrje të punimit dhe kontributin e Rilindjes Kombëtare në mbrojtje të çështjes shqiptare.<br>Nxënësit shkruajnë mbylljen e esesë, duke shprehur dhe mendimin e tyre në lidhje me temën.<br>Tema mund të realizohet duke u nisurnga:<br>- kërkimet në Internet mbi krijimin dhe veprimtarinë e shoqërive të para brenda dhe jashtë vendit;<br>- mbledhja e materialeve mbi veprimtarinë e rilindësve humanistë në vendin tonë;<br>- shfrytëzimi i literaturës dhe i albumeve mbi veprimet e komitëve etj.<br>Kompetencat që përfitojnë: kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, e të menduarit.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Vlerësimi: Vlerësim për detyrën individuale dhe hulumtimet.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Detyrat dhe puna e pavarur: Eseja argumentuese</td></tr>
</table>

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori</td><td>Shkalla: III</td><td>Klasa: VII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore 2.38<br>Shpërbërja e Perandorisë Osmane. Krijimi i shtetit të pavarur grek</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Në luftën e popullit grek kundër pushtimit osman, kanë luftuar edhe shqiptarët. Si e shpjegoni ju këtë? Grekët u ndihmuan nga evropianët dhe rusët, dy armiqtë më të mëdhenj të Perandorisë Osmane.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:<br>x përcakton faktorët që kushtëzuan fillimin e Revolucionit grek;<br>x diskuton në klasë mbi kontributin e shqiptarëve dhe arvanitasve në Revolucionin grek;<br>x analizon projektin e “Megali idesë”.</td><td colspan="2">Fjalët kyç:<br>Arvanitas, Megali Idea, superioritet.<br><br><br><br></td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: Karl Grimberg, “Historia Botërore dhe Qytetërimi”, materiale nga Interneti, You tube, dokumenta historikë etj.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare:<br>Shkencat shoqërore, gjeografia</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Punë në grupe, stuhi mendimesh, diskutim i lirë.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit:<br>Mësuesi ndan nxënësit nëtri grupe dhe u jep si detyrë të lexojnë tekstin. Më pas dëgjon paqartësitë e tyre, si dhe diskutojnë për ngjarje, heronj, faktorë etj që ndikuan në shpërbërjen e Perandorisë Osmane dhe në krijimin e shtetit të pavarur grek. Pas përfundimit të ngjarjeve kryesore, nxënësit iu përgjigjen pyetjeve si më poshtë:<br>a. Cila ishte gjendja e Greqisë në fillim të shek XIX?<br>b. Çfarë ndikoi në fillimin e revolucionit serb?<br>c. Cilët ishin drejtuesit e revolucionit grek?<br>ç. Ç’situatë shfrytëzuan grekët për fillimin e revolucionit?<br>d. Cilët ishin shqiptarët që ndihmuan në fitoren e Revolucionit grek?<br>d. A ndihmuan Fuqitë e Mëdha në fitimin e lirisë dhe pavarësisë?<br>dh.Cili ishte mbreti që Fuqitë e Mëdha i caktuan Greqisë? Ç’kuptim kishte Megali Idea?<br>Në fund diskutohet për mënyrën se si u përpoqën grekët të zbatonin teorinë e tyre Megali Idea në dëm të kombit shqiptar.<br>A vazhdon të ketë ndikim kjo teori edhe në ditët e sotme në qarqet greke?<br>Cilat territore të kombit tonë janë zhvatur për të arritur krijimin e shtetit të sotëm grek?<br><br>Kompetencat që përfitojnë: kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, e të menduarit, e të nxënit, personale, kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin, kompetenca digjitale.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Vlerësimi: Vlerësim nga diskutimi i punës në grupe dhe i dosjes së nxënësit.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Detyrat dhe puna e pavarur: Ese “Greqia antike dhe ajo e kohëve moderne”.</td></tr>
</table>

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi.** | **Lënda: Histori.** | **Shkalla: III** | **Klasa: VII** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore 2.38**. Shpërbërja e Perandorisë Osmane. Krijimi i shtetit serb | | **Situata e të nxënit:** Millosh Obrenoviç ishte një ndër figurat kryesore që kontribuoi në shpalljen e pavarësisë së shtetit serb. Periudha e sundimit të tij karakterizohet nga më të suksesshmet në të gjitha drejtimet. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>x përshkruan veçoritë e zhvillimit të Serbisë në fillim të shekullit XIX;<br>x evidenton punën që bënë intelektualët serbë për të ngjallur ndjenjat kombëtare;<br>x analizon projektin "Naçertania" dhe e krahason atë me "*Megali Idenë*". | | **Fjalët kyç**: tregti e jashtme, ide iluministe, Karagjergjovic, Rusia, Millosh Obrenoviç, Naçertania, Traktati i Shën Stefanit, Kongresi i Berlinit, monarki parlamentare. | |
| **Burimet:** Karl Grimberg, "Historia Botërore dhe Qytetërimi", materiale nga interneti, You tube, dokumente historike etj | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:** Letërsia, Artet, Gjeografia. | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Diskutim, Di/Dua të di/Mësova, shkrim i lirë. | | | |

**Organizimi i orës së mësimit:**
Mësuesi, pasi u tregon nxënësve temën e mësimit, i pyet se si duhet të ndiheshin serbët nën Perandorinë Osmane. Diskutohet për përgjigjet e nxënësve dhe mësuesi u thotë që të lexojnë tekstin dhe të shënojnë në fletoren e klasës tabelën "Di/Dua të di/Mësova". Nxënësit shënojnë se çfarë dinë për temën, se çfarë duan të dinë për temën. Diskutohet dhe sqarohen në klasë të gjitha paqartësitë, si dhe çfarë nxënësit duan të dinë. Në fund shënojnë se çfarë mësuan.

| Di | Dua të di | Mësova |
|---|---|---|
| Serbët ishin nën Perandorinë Osmane.<br>Taksat e larta doganore dhembeturinat feudale në ekonominë bujqësore dëmtonin ekonominë e vendit. | Si e fituan pavarësinë serbët?<br>Cilët ishin udhëheqësit politikë?<br>A u ndihmuan nga Fuqitë e mëdha? | Shtimi i prodhimit vendës favorizoi lulëzimin e tregtisë së jashtme……<br>Traktati i Shën Stefanit ….<br>Kongresi i Berlinit………<br>Shteti serb u bë monarki …. |

Në fund, mësuesi bën pyetjet përmbledhëse të mësimit të ri:
a.Cila ishte gjendja e Serbisë në fillim të shek. XIX?
b.Çfarë ndikoi në fillimin e Revolucionit serb?
c.Cilët ishin drejtuesit e revolucioneve serbe?
ç.Ç'situatë shfrytëzuan serbët për fillimin e revolucionit?
d. A ndihmuan Fuqitë e Mëdha në fitimin e lirisë dhe pavarësisë?
dh.Cila ishte forma e regjimit që u vendos në Kushtetutën e vitit 1888?
*Kompetencat që përfitojnë: kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, e të menduarit, e të nxënit.*

**Vlerësimi:** Vlerësim nga diskutimi, lista e kontrollit.

**Detyrat dhe puna e pavarur:** A mendoni se Naçertania ishte një ide paqësore? Ç'ndikim kishte kjo politikë te shtetet fqinje dhe te Shqipëria? Ju si do të vepronit si shqiptar ndaj këtij projekti?
Ese: "Serbia dhe shqiptarët".

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkalla: III** | **Klasa: VII** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore 2.40** Shpërbërja e Perandorisë Osmane. Krijimi i shtetit të pavarur në Bullgari | **Situata e të nxënit:** Vasil Leski dhe Kristo Botev:<br>Dy figurat kryesorenë shpalljen e pavarësisë së Bullgarisë.<br>Ata hodhën idenë se vetëm nëpërmjet luftës së armatosur do të mundësohej çlirimi i vendit.<br>Si e komentoni ju idenë e tyre? |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>përshkruan gjendjen e Bullgarisë në fillim të shekullit XIX;<br>përcakton rëndësinë e veprimtarisë së elementëve revolucionarë në Bullgari;<br>diskuton mbi vendimet e Traktatit të Shën Stefanit dhe të Kongresit të Berlinit lidhur me Bullgarinë. | **Fjalët kyç:** Kisha autoqefale bullgare, Georgi Rakovski, Vasil Levski dhe Kristo Botevi, Traktati I Shën Stefanit, princi Aleksandër Batenberg, princi Boris, reforma agrare. |
| **Burimet:** Karl Grimberg, "Historia Botërore dhe Qytetërimi", materiale nga interneti, You tube. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare:**<br>**L**etërsia, Artet, Gjeografia. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**Diskutim, Di/Dua të di/Mësova

**Organizimi i orës së mësimit:**
Mësuesi pasi u tregon nxënësve temën e mësimit, i pyet se si ishte gjendja e bullgarëve nën Perandorinë Osmane. Diskutohet për përgjigjet e nxënësve dhe mësuesi u thotë që të lexojnë tekstin dhe të shënojnë në fletoren e klasës tabelën "Di/Dua të di/Mësova". Nxënësit shënojnë se çfarë dinë për temën, se çfarë duan të dinë për temën. Diskutohet dhe sqarohen në klasë të gjitha paqartësitë, si dhe çfarë nxënësit duan të dinë. Në fund shënojnë se çfarë mësuan.

| Di | Dua të di | Mësova |
|---|---|---|
| Bullgarët ishin nën Perandorinë Osmane.<br>Vetëm lufta e armatosur mund ti çlironte nga zgjedha osmane.<br>Rusia kishte interes në krijimin e nje shteti të stërmadh bullgar. | Si e fituan pavarësinë bullgarët?<br>Cilët ishin udhëheqësit politikë?<br>A u ndihmuan nga Fuqitë e Mëdha? | Fitorja e Rusisë në luftën ruso-turke, në vitet 1877 - 1878, detyroi Turqinë të pranonte krijimin e shtetit…….<br>Traktati i Shën Stefanit ….<br>Kongresi i Berlinit……… |

Në fund, mësuesi bën pyetjet përmbledhëse të mësimit të ri:
a.Cila ishte gjendja e Bullgarisë në fillim të shek XIX?
b.Çfarë ndikoi në fillimin e Revolucionit bullgar?
c.Cilët ishin drejtuesit e Revolucionit bullgar?
ç.Ç'situatë shfrytëzuan bullgarët për fillimin e Revolucionit?
d.A ndihmuan Fuqitë e Mëdha në fitimin e lirisë dhe pavarësisë?
dh.Cila ishte forma e regjimit që u vendos në Bullgari?
*Kompetencat që përfitojnë: kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, e të menduarit, e të nxënit.*

**Vlerësimi:** Vlerësim nga diskutimi, vlerësim i detyrave të dhëna.

**Detyrat dhe puna e pavarur:** Nxënësit ndërtojnë hartën e personazheve të Revolucionit bullgar.

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori | Shkalla: III | Klasa: VII |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore2.41**<br>Shpërbërja e Perandorisë Osmane. Krijimi i shtetit të pavarur rumun. | **Situata e të nxënit:** Tudor Vladimiresku dheAleksandër Ipsilanti udhëhoqën luftën e popullit rumun për pavarësi. Tudor Vladimiresku udhëhoqi kryengritjen në principatën e Vllahisë, ndërsa Aleksandër Ipsilanti udhëhoqi kryengritjen në Moldavi. Të dy udhëheqësit nuk i koordinuan veprimet e tyre dhe të bashkoheshin. |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>x diskuton në klasë për gjendjen e principatave rumune në fillim të shekullit XIX;<br>x evidenton faktorët që e favorizuan luftën çlirimtare në Vllahi e Moldavi;<br>x analizon masat që mori qeveria e Jon Kuzës për zhvillimin e gjithanshëm të vendit. | **Fjalët kyç**:<br>Vllahia, Moldavia, fanariotët grekë, Rusia, Turqia, Aleksandër JonKuza, reforma, kodet civile dhe penale, Kisha rumune, Kongresi Berlinit 1878. |
| **Burimet:** Karl Grimberg,"Historia Botërore dhe Qytetërimi", materiale nga interneti, You tube, dokumenta historikë etj. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare:**<br>Letërsia, Artet, Gjeografia. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Stuhi mendimesh, Di/Dua të di/Mësova, diskutim.

**Organizimi i orës së mësimit:**

Mësuesi, pasi u tregon nxënësve temën e mësimit i pyet se si ishte gjendja e Rumanisë nën Perandorinë Osmane. Diskutohet për përgjigjet e nxënësve dhe mësuesi u kërkon që të lexojnë tekstin dhe të shënojnë në fletoren e klasës tabelën "Di/Dua të di/Mësova". Nxënësit shënojnë se çfarë dinë për temën, se çfarë duan të dinë për temën. Diskutohet dhe sqarohen në klasë të gjitha paqartësitë si dhe çfarë nxënësit duan të dinë. Në fund shënojnë se çfarë mësuan.

| Di | Dua të di | Mësova |
|---|---|---|
| Vllahia dhe Moldavia ishin nën Perandorinë Osmane.<br>Vetëm lufta e armatosur mund t'i çlironte nga zgjedha osmane.<br>Rumunët do të shfrytëzonin dobësimin e Perandorisë Osmane për të ngritur krye. | Ç'ishin fanariotët grekë?<br>Si e fituan pavarësinë rumunët?<br>Cilët ishin udhëheqësit politikë?<br>A u ndihmuan nga Rusia?<br>Po nga Fuqitë e Mëdha? | Ushtritë ruse në vitin 1829 pushtuan Vllahinë dhe Moldavinë........<br>Rusia dhe Turqia shtypën revoltat në tokat rumune.....<br>Pas Luftës së Krimesë, Fuqitë e Mëdha njohën pavarësinë e Vllahisë dhe të Moldavisë........ |

Në fund, mësuesi bën pyetjet përmbledhëse të mësimit të ri:

a.Cila ishte gjendja e Vllahisë dhe Moldavisë në fillim të shek. XIX?
b.Çfarë ndikoi në fillimin e revolucionit në Vllahi dhe Moldavi?
c.Cilët ishin drejtuesit e Revolucionit në Vllahi e Moldavi?
ç.Ç'situatë shfrytëzuan vllahët për fillimin e Revolucionit?
d.A ndihmuan Fuqitë e Mëdha në fitimin e lirisë dhe pavarësisë? Po Rusia?

*Kompetencat që përfitojnë*: kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, e të menduarit, e të nxënit.

**Vlerësimi:** Vlerësim nga diskutimi, vlerësim i detyrave të dhëna.

**Detyrat dhe puna e pavarur:** Nxënësit ndërtojnë hartën e personazheve të Revolucionit rumun.

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE** **Dt.___/____/__**

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkalla: III** | **Klasa: VII** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore 2.42**.<br>Shpërbërja e Perandorisë Osmane. Krijimi i shteteve nacionale në Maqedoni, BosnjeT Hercegovine, Malin e Zi. | **Situata e të nxënit:** Maqedonia, Bosnjë THercegovina dhe Mali Zi ishin territore të prapambetura. Për rrjedhojë, dhe procesi i formimit të shteteve kombëtare do të ishte i mëvonshëm dhe i vështirë. Maqedonia nuk arriti ta krijonte shtetin e pavarur.<br>Bosnjë THercegovina u vu nën kontrollin e |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>x përcakton rolin e intelektualëve maqedonas në nxitjen e ndjenjës kombëtare;<br>x indentifikon anët negative dhe pozitive të aneksimit të territoreve të BosnjëT Hercegovinës;<br>x analizon veçoritë e zhvillimit ekonomik dhe social të BosnjëT Hercegovinës. | **Fjalët kyç**:<br>Bejlerë, Vlladikë, ORM, Perandoria Habsburgse, Perandoria Osmane, Kongresi i Berlinit, Fuqitë e Mëdha. |
| **Burimet:** Karl Grimberg, "Historia Botërore dhe Qytetërimi", materiale nga interneti, You tube, dokumenta historikë etj | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër kurikulare:** Letërsia, Artet, Gjeografia. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**punë në grupe, Diagramii Venit.

**Organizimi i orës së mësimit:** Mësuesi u tregon nxënësve temën e mësimit dhe kërkon nga ata që ta lexojnë atë dhe më pas të plotësojnë Diagramën e Venit për Maqedoninë dhe Bosnjë T Hercegovinën grupi i parë, për Maqedoninë dhe Malin e Zi grupi i dytë, për Bosnjë THercegovinën dhe Malin e Zi grupi i tretë. Nxënësit punojnë në grup dhe në fund mësuesi ndërton në dërrasën e zezë një tabelë, ku të përmbledhë veçoritë e përbashkëta dhe dalluese, tashmë të tri shteteve.

| Maqedonia | Bosnjë THercegovina | Mali i Zi |
|---|---|---|
| Të tre shtetet bënin pjesë përpara Kongresit të Berlinit nën Perandorinë Osmane.<br>Të tre shtetet bënë perpjekje për t'u çliruar nga zgjedha e huaj.<br>Kaluan nga sistemi feudal në sistemin kapitalist.<br>Kishin edhe popullsi sllave ortodokse. | | |
| Fshatarët u dyndën drejt qyteteve.<br>Patriakana e Stambollit pengoi krijimin e Kishës vendase.<br>U krijua Organizata Revolucionare Maqedonase.<br>U mbështetën nga Rusia dhe AustroT Hungaria… | Përbëhej nga tri besime fetare.<br>Ekzistonin tensione e konflikte.<br>Kongresi i Berlinit i vendosi nën Perandorinë Habsburgse.<br>Pati zhvillim të gjithanshëm të vendit.<br>Ortodoksët kërkuan të bashkoheshin me Serbinë... | Karakterimalorivenditdheqëndresaevazhdueshme epopullsisë siguruan gjatë disa shekujve ruajtjen e autonomisë së Malit të Zi.<br>Nuk kishte dalje në det.<br>Ndihmohej ekonomikisht nga Rusia……. |

*Kompetencat që përfitojnë*: kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, e të menduarit, e të nxënit, kompetenca digjitale.

**Vlerësimi:** Vlerësim nga puna në grupe dhe plotësimi i Diagramit të Venit.

**Detyrat dhe puna e pavarur:** Hulumtoni në Internet për shpërbërjen e Perandorisë Osmane.